REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr 5756/2

Lushnje me, 29/06/2026

VENDIM

NR. 57 Datë 25/06/2026

MBI MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BASHKISË LUSHNJË 2026–2031

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës 25/ 06/ 2026 , në mbështetje të nenit 16, pika "1", nenit 23, pika "4", nenit 28, pika "1" dhe nenit 54 shkronja " k" të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, VKM nr.88 datë 22.02.2023 " Për miratimin e strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Europian 2022-2030" Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar, Ligjin nr.9817/2017 "Për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit , Politikave Sociale dhe Informimit, për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje për periudhën 2026–2031,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin "Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnje 2026–2031".
2. Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnje 2026–2031 të shërbejë si dokument kryesor strategjik orientues për planifikimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe projekteve zhvillimore të Bashkisë Lushnjë gjatë periudhës 2026–2031.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë e Bashkisë Lushnje.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
Erjet Dhima

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia.lushnje@yahoo.com

BASHKIA LUSHNJË

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË BASHKISË LUSHNJË

2026 – 2031



www.bashkialushnje.gov.al

TABELA E LËNDËS

TABELA E LËNDËS 3
LISTA E FIGURAVE 5
LISTA E GRAFIKËVE 6
LISTA E TABELAVE 7
AKRONIME 8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 9
I. KORNIZA STRATEGJIKE DHE LIGJORE 10
I.1. Kuadri ligjor 10
I.2. Kuadri Strategjik kombëtare dhe lokale. 10
I.2.1. Planet dhe Strategjitë Kombëtare 10
I.2.2. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje 12
I.3. Partneritetet ndër-institucionale dhe ndërkombëtare 13
I.4. Metodologjia për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje 14
II. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE 15
II.1. Profili i përgjithshëm 15
II.2. Ndarja Administrative territoriale 16
II.3. Morfologjia dhe hidrografia 17
II.4. Analiza Demografike dhe Sociale 19
II.4.1. Demografia e Bashkisë Lushnje 19
II.4.2. Përbërja Demografike 20
II.4.3. Arsimi, shëndetësia, kultura, barazia gjinore 32
II.5. Ekonomia Lokale 37
II.5.1. Aktiviteti ekonomik në Bashkisë Lushnje 37
II.5.2. Sektori bujqësor 44
II.5.3. Sektorët me potencial zhvillimi 51
II.5.4. Tregu i punës dhe punësimi 54
II.6. Mjedisi dhe Qëndrueshmëria 55
II.6.1. Burimet natyrore dhe menaxhimi i tyre 55
II.6.2. Menaxhimi i mbetjeve 56
II.6.3. Energjia dhe eficenca energjetike 57
II.6.4. Rreziqet natyrore dhe ndryshimet klimatike 58
II.7. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike 60
II.7.1. Transporti dhe rrjeti rrugor 60

II.7.2. Sistemin e Ujësjellës-Kanalizimeve 62
II.7.3. Strehimi dhe hapësirat publike 63
II.8. Qeverisja Lokale dhe Kapacitetet Institucionale 64
II.8.1. Strukturat administrative 64
II.8.2. Financat lokale 66
III. Analiza e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT) 68
IV. VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE 70
IV.1. Parimet e Zhvillimit 70
IV.2. Vizioni i Zhvillimit për Bashkinë Lushnje 70
IV.3. Prioritetet Strategjike 71
IV.3.1. Objektivat strategjik 71
IV.3.2. Programet strategjike 72
IV.3.3. Rezultatet e Pritshme 73
V. PLANI I VEPRIMIT 74
V.1. Metodologjia e prioritizimit të planit të veprimit 74
V.2. Plani i Veprimit 77
VI. PLANIFIKIMI FINANCIAR, MONITORIMI DHE VLERËSIMI 141
VI.1. Analiza a burimeve institucionale 141
VI.2. Analiza e burimeve të mundshme financiare në zbatim të planit të veprimit. 141
VI.3. Mekanizmi i monitorimit 142
Aneksi 1 - Dinamikat Demografike Sipas Njësive Administrative Vendore 143
Aneksi 2 – Grup-moshat Sipas Njësive Administrative Vendore 146
Aneksi 3 – Rezultate Census 2023 - INSTAT 148
Aneksi 4 – Bizneset aktive sipas sektorit dhe njësisë administrative 150
Aneksi 5 – Shpërndarja e Bizneseve aktive sipas llojit dhe njësisë administrative 152
Aneksi 6 - Pemë frutore 155
Aneksi 7 - Blegtoria - Numri i krerëve 157
Aneksi 8 - Prodhimi blegtoral 160
Aneksi 9 - Financat e Bashkisë 163
Aneksi 10 – Fishat e projekteve 164

LISTA E FIGURAVE

Figura 1- Pozita gjeografike e Bashkisë Lushnje 15
Figura 2- Harta e morfologjisë dhe hidrografisë 18
Figura 3- Harta e Arsimimit të Popullsisë 34
Figura 4- Kopshte në Bashkinë Lushnje 35
Figura 5- Shkolla 9 vjeçare në Bashkinë Lushnje 35
Figura 6- Shkolla të mesme në Bashkinë Lushnje 36
Figura 7- Mbullimi territorial i Shkollava të mesme në Bashkinë Lushnje 36
Figura 8- Shpërndarja Territoriale e bizneseve aktive sipas njësisë administrative 41
Figura 9. Monumente kulture 53
Figura 10. Monumente të natyrës 53
Figura 11. Harta turistike Bashkia Lushnje 54
Figura 12. Harta e rrezatimit djellor direkt (Global Solar Atlas) 57
Figura 13- Rrjeti Rrugor kryesor Bashkia Lushnje. 60
Figura 14- Organika Bashkia Lushnje. 65

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1- Popullsia rezidente Census 2023 dhe Popullsie a regjistruar në gjendje Civile 2025. 20
Grafiku 2- Përbërja Demografike - Census 2023 21
Grafiku 3 - Përbërja Demografike e Bashkisë Lushnje 2011 dhe 2023 22
Grafiku 4 - Piramida e moshës 23
Grafiku 5- Tendencat demografike në shkalle Bashkie, Qarku dhe Kombëtare. 24
Grafiku 6 - Bilanci natyror i Bashkisw Lushnje 2011-2023 25
Grafiku 7 - Koeficientit të Varësisë 2011 26
Grafiku 8 - Koeficientit të Varësisë 2023 26
Grafiku 9- Njësitë Ekonomike Familjare. 27
Grafiku 10- Raporti Gjinor sipas njësive administrative. 28
Grafiku 10- Dinamikat Demografike të Bashkisë Lushnje 29
Grafiku 11- Dinamikat Demografike të Njësive Administrative 2011-2023 30
Grafiku 12- Arsimimi i popullsisë së Bashkisë Lushnje 33
Grafiku 13- Ndërmarrje aktive Bashkia Lushnje 2010-2024 38
Grafiku 14- Ndërmarrje aktive prodhuese e të mirave dhe shërbimeve 2010-2024 39
Grafiku 15- Ndërmarrje aktive sipas numrit të të punësuarve Bashkia Lushnje 2010-2024 39
Grafiku 16- Ndërmarrje aktive sipas regjistrimit Bashkia Lushnje 2010-2024 39
Grafiku 17- Ndërmarrje aktive sipas gjinisë së administratorit Bashkia Lushnje 2010-2024 40
Grafiku 18- Bizneset aktive sipas Njësisë administrative të Bashkia Lushnje 2024 42
Grafiku 19- Fermerët e regjistruar në Bashkinë Lushnje 2014-2024 42
Grafiku 20- Numri i mjeteve të mekanikës bujqësore sipas Viti Bashkia Lushnje 2019-2024 44
Grafiku 21- Numri i mjeteve të mekanikës bujqësore sipas llojit dhe Vitit Bashkia Lushnje 2019-2024 .. 45
Grafiku 22- Sipërfaqja e drithërave, perimeve dhe foragjereve në arë 2018-2024 (në Hektar) 46
Grafiku 23- Prodhimi i drithërave, perimeve dhe foragjereve në arë 2019-2024 (në TON) 46
Grafiku 24- Rendimenti i drithërave, perimeve dhe foragjereve në arë 2019-2024 (në TON) 46
Grafiku 25- Sipërfaqja e tokës e përdorur për prodhimin e perimeve në fusha dhe serra 2019-2024 47
Grafiku 26- Prodhimi i perimeve në fusha dhe serra 2019-2024 47
Grafiku 27- Prodhimi i perimeve në fusha dhe serra sipas llojit Bashkia Lushnje 2019-2024 48
Grafiku 28- Prodhimi i perimeve të njoma në fusha dhe serra sipas llojit Bashkia Lushnje 2019-2024 48
Grafiku 29- Prodhimi i bostanore në fusha dhe serra sipas llojit Bashkia Lushnje 2019-2024 48
Grafiku 30- Prodhimi peme frutor Bashkia Lushnje 2019-2024 49
Grafiku 31- Sipërfaqe peme frutor gjithsej dhe në prodhim Bashkia Lushnje 2019-2024 49
Grafiku 32- Numri i krerëve Bashkia Lushnje 2019-2024 50

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Ndarja Administrative 16
Tabela 2 Popullsia e Bashkisë Lushnje 19

AKRONIME

PPV – Planii përgjithshëm Vendor

PINS – Plani i integruar Ndërsektorial

PINS Bregdeti – Plani i integruar Ndërsektorial i Bregdetit

NJEF - Njësitë Ekonomike Familjare

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnje përfaqëson dokumentin kryesor orientues për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të territorit në një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë. Ajo bazohet në analizën e potencialeve vendore, sfidave strukturore dhe nevojave të komunitetit, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe rritjen e konkurueshmërisë së bashkisë.

Bashkia Lushnja pozicionohet si një qendër me rëndësi strategjike në zhvillimin bujqësor të vendit, me potencial të lartë në agro-industri, përpunim ushqimor dhe zhvillim rural. Strategjia synon të shfrytëzojë këtë potencial përmes modernizimit të bujqësisë, rritjes së zinxhirit të vlerës dhe mbështetjes së sipërmarrjes lokale. Në të njëjtën kohë, ajo adreson nevojën për diversifikim ekonomik përmes zhvillimit të sektorëve si turizmi rural, shërbimet dhe inovacioni.

Një shtyllë e rëndësishme e strategjisë është përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike, duke përfshirë investime në ujësjellës-kanalizime, menaxhimin e mbetjeve, rrjetin rrugor dhe shërbimet sociale. Në këtë kuadër, një fokus i veçantë i kushtohet digjitalizimit të administratës dhe rritjes së efikasitetit institucional, me qëllim ofrimin e shërbimeve më cilësore, transparente dhe më pranë qytetarëve.

Strategjia i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes sociale dhe barazisë, duke synuar fuqizimin ekonomik të grave dhe të rinjve, mbështetjen e familjeve në nevojë, integrimin e grupeve vulnerabël dhe përmirësimin e aksesit në arsim dhe shëndetësi. Gjithashtu, ajo promovon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e kohezionit social.

Në aspektin mjedisor dhe klimatik, strategjia parashikon masa për mbrojtjen e burimeve natyrore, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe ujit, rehabilitimin e zonave të degraduara dhe rritjen e reziliencës ndaj ndryshimeve klimatike. Investimet në energji të rinovueshme dhe eficiencë energjetike përbëjnë një komponent kyç për një zhvillim të gjelbër dhe të qëndrueshëm.

Një element thelbësor i strategjisë është forcimi i kapaciteteve institucionale të bashkisë, përmes trajnimeve të stafit, krijimit të strukturave për menaxhimin e projekteve dhe përmirësimit të sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të performancës. Kjo synon rritjen e aftësisë së bashkisë për të tërhequr fonde të jashtme dhe për të menaxhuar me sukses projektet zhvillimore.

Zbatimi i strategjisë do të realizohet përmes një plani veprimi të detajuar, të strukturuar në prioritete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të mbështetur nga burime të ndryshme financimi, përfshirë buxhetin vendor, fondet e Bashkimit Evropian dhe donatorët ndërkombëtarë.

Në përfundim, Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Lushnje synon të transformojë bashkinë në një territor të zhvilluar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, ku qytetarët përfitojnë nga shërbime cilësore, mundësi ekonomike dhe një mjedis i shëndetshëm.

I. KORNIZA STRATEGJIKE DHE LIGJORE

I.1. Kuadri ligjor

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje bazohet në një kuadër të gjerë ligjor dhe rregullator që përkufizon kompetencat, detyrimet dhe drejtimet për zhvillimin e qëndrueshëm lokal.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i cili përcakton kompetencat e bashkisë në fushat e zhvillimit ekonomik lokal, planifikimit territorial, infrastrukturës, mjedisit dhe shërbimeve sociale, detyron çdo bashki të hartojë dokumente të planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë, duke hedhur kështu bazën për përgatitjen e Strategjisë për Zhvillimin Vendor, si dokument planifikues kryesor për zhvillimin socio-ekonomik.

Gjithashtu, Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i cili rregullon hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV), orienton bashkërendimin e PPV me dokumentet strategjike sektoriale si dhe me Strategjitë e Zhvillimit Vendor, kërkon që strategjitë dhe projektet e përfshira në to, të jenë në përputhje me PPV dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Ndërsa, Ligji nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore" përcakton se strategjitë zhvillimore duhet të lidhen me buxhetin afatmesëm dhe planifikimin e investimeve publike.

I.2. Kuadri Strategjik kombëtare dhe lokale.

Në një këndvështrim më të gjerë, Strategjitë Vendore të Zhvillimit duhet të jene të harmonizuar me prioritetet kombëtare të parashikuara në dokumente kombëtare të zhvillimit, strategjitë dhe planet kombëtare sektoriale etj.

I.2.1. Planet dhe Strategjitë Kombëtare

Plani i Përgjithshëm Kombëtar - PPK

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, i mbështetur në strategjitë kombëtare sektoriale[1], përcakton kornizën strategjike orientuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit gjatë 15 viteve të ardhshme, duke synuar një zhvillim të balancuar ekonomik e social, një menaxhim të kujdesshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e përdorimit të arsyeshëm e të qëndrueshëm të tokës.

Vizioni PPK, e përfytyron Shqipërinë si një vend tërësisht të integruar në rrjetin ekonomik dhe infrastrukturor evropian, me një ekonomi të larmishme dhe konkurruese në rajonin ballkanik. Ai synon të garantojë barazi në akses ndaj infrastrukturës, ekonomisë dhe dijes, ndërsa njëkohësisht mbron trashëgiminë natyrore, historike dhe kulturore, me synimin për ta kthyer vendin në një destinacion tërheqës dhe autentik. Objektivat strategjikë të planit përfshijnë ruajtjen e integritetit fizik dhe territorial të

[1] Plani i Përgjithshëm Kombëtar ka përfshirë dhe është mbështetur në strategjitë kombëtare sektoriale, si: Strategjia Kombëtare e Transportit; Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020; Strategjia Kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve; Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020; Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030; Strategjia Kombëtare e Ujit (Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027); Strategjia e strehimit Social; Studimi i adaptimit për bujqësinë; Strategjia Kombëtare e Turizmit 2017- 2020; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020; Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë" 2015-2020; Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 etj.

peizazheve natyrore, kulturore, historike dhe urbane në të gjithë vendin. PPK-ja synon një riorganizim funksional të territorit përmes strukturimit të vendbanimeve në qendra urbane primare, sekondare dhe terciare, forcimit të lidhjeve brenda dhe jashtë vendit përmes korridoreve evropiane dhe ballkanike, si dhe krijimit të rajoneve të fuqishme ekonomike me marrëdhënie plotësuese ndërmjet tyre.

Për s ai përket "sistemin urban" PPK orienton drejtë një zhvillimi hapësinor policentrik, duke promovuar marrëdhënien e zonave urbane me ato rurale. Një ndër prioritetet është kontrolli i zgjerimit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara, përmes inkurajimit të densifikimit në vend të shpërndarjes urbane, çka ndihmon në kursimin e hapësirave dhe burimeve natyrore. Gjithashtu, nënvizohet rëndësia e ruajtjes dhe aktivizimit të pasurive natyrore, historike dhe kulturore si pjesë e jetës urbane.

Në vizionin për sistemin natyror, PPK mbështetet në dy koncepte thelbësore: promovimi dhe aksesimi. PPK-ja parashikon rritjen e sipërfaqeve natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe krijimit të korridoreve natyrore përgjatë luginave të lumenjve, të cilat vlerësohen si hapësira të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve dhe infrastrukturës së butë dhe miqësore me mjedisin.

Për sa i përket sektorit bujqësor, PPK mbështet tre drejtime kryesore: ruajtjen, konsolidimin dhe modernizimin e bujqësisë, si një bazë për zhvillim të qëndrueshëm rural dhe ekonomik.

Më konkretisht, PPK'ja renditet qytetin e Lushnjes si 1 ndër 6 polet bujqësore kryesore në vend. E përcaktuar si qendër sekondare "*Hub Bujqësor*", PPK parashikon se zhvillimi i qytetit dhe për rrjedhojë i Bashkisë Lushnje do te orientohet drejtë Sektorit Bujqësor. Konkretisht, PPK parashikon ngritjen dhe konsolidimin e: Qendrave kërkimore bujqësore; Pika grumbullimin dhe përpunimin të produkteve bujqësore; Tregjeve për tregtimin dhe promovimin e produkteve lokale; Poleve bujqësore inovuese të agro-përpunimit etj.

Dokumente kombëtare me ndikim në territorin e bashkisë Lushnje

Krahas Planit të Përgjithshëm Kombëtarë, në vijim, pushteti qëndror ka ndërmarr dhe hartimi e një numri të gjerë strategjishe dhe dokumente politikash, ndër të cilat vlen te përmenden:

"Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit (PINS Bregdetit)": Pavarësisht se PINS Bregdeti, nuk ndikon në drejtë për drejtë në zhvillimin e Bashkisë Lushnje, ky plan mbështetet në rolin bujqësor të bashkisë dhe qyteti të Lushnjes, duke evidentuar këtë të fundit si "qendër terciare bujqësore".

"Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2019–2021": Ky plan përcakton objektiva kombëtare për rritjen e përdorimit të energjisë së pastër dhe reduktimin e varësisë nga burimet fosile. Falë klimës dhe numrit të madh të ditëve me rrezatim të favorshëm, Bashkia Lushnje ka një potencial të lartë për instalimin e paneleve diellore për ngrohje uji dhe për prodhimin e energjisë elektrike (PV) në banesa, biznese, ferma dhe ndërtesa publike. Lehtësirat procedurale dhe mbështja me instrumentet financiare për instalimin e këtyre sistemeve, lehtëson:

- Investimet në zhvillimin e parqeve fotovoltaike,
- Investime në përmirësimi i efiçencës energjetike të banesave, institucioneve publike dhe shërbimet publike,
- Investime në sektorin bujqësor dhe agro-përpunues, ku mund të zhvillohen investime lidhur me përdorimin e biomasës dhe mbetjeve bujqësore për prodhim energjie; Instalimin e pompa termike dhe sistemeve diellore në serra; zhvillimin e kooperativave energjetike për komunitetet rurale, zhvillimin e bioenergjisë, shfrytëzimin e fushat bujqësore jo-produktive për parqe fotovoltaike etj.

"Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore" dhe planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe të Rrezikut nga Përmbytjet, ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Lushnje. Strategjia dhe planet synon përmirësimin e administrimit të ujit për bujqësi, furnizim me ujë të pijshëm dhe mbrojtje nga përmbytjet. Në këtë kontekst, Bashkia Lushnje duhet të synoj të përmirësojë përdorimin, mbrojtjen dhe administrimin e ujit si një burim jetik për zhvillimin e qëndrueshëm, duke ndërmarr masa për:

- Modernizimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, për një menaxhim të qëndrueshëm të ujërave për bujqësinë;
- Mbrojtjes së tokave nga përmbytjet dhe erozioni
- Mbrojtjes së burimeve ujore nga ndotja bujqësore dhe urbane;
- Menaxhimin e integruar të ujit në nivel basenesh ujëmbledhëse (ku Bashkia Lushnje bën pjesë në pellgun e Shkumbinit dhe Semanit);
- Reduktimin e humbjeve në rrjetet ujësjellës-kanalizime etj.

Integrimi i këtyre masave në dokumentet zhvillimore lokale, synon jo vetëm përmirësimin e rrjetit ujësjellës-kanalizime, por ka për qëllim të përmirësoj menaxhim e ujërave për bujqësinë, të reduktoj riskun e sektorit bujqësor nga erozioni dhe përmbytjet, dhe për rrjedhojë të garantoj qëndrueshmërinë ekologjike dhe sociale të territorit në një plan afatgjatë.

"Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023" synon diversifikimin e ofertës turistike përtej zonave bregdetare, duke i dhënë përparësi zhvillimit të turizmit në brendësi të territorit, përmes mbështetjes së iniciativave vendore, përmirësimit të infrastrukturës dhe promovimit të produkteve autentike lokale. Në këtë kuadër, Bashkia Lushnje, me trashëgiminë e saj kulturore, peizazhin bujqësor dhe burimet natyrore me potencial rekreativ dhe historik, përfshihet në hartën e destinacioneve alternative që ofrojnë përvoja të veçanta për vizitorët. Strategjia inkurajon krijimin e rrjeteve të agroturizmit, ruajtjen e trashëgimisë lokale dhe integrimin e turizmit me sektorin e bujqësisë, duke krijuar mundësi të reja për zhvillim ekonomik, punësim dhe gjenerim të të ardhurave për komunitetet rurale në Bashkinë Lushnje.

Këto strategji dhe dokumente politikash të hartuar pas miratimit të PPK'së dhe Hartimit të Plani i Përgjithshëm Vendor, vendosin theksin mbi nevojën për te integruar orientimet kombëtare mbi energjinë e rinovueshme, burimet ujore dhe turizmin, në dokumente e ardhshme Strategjike të zhvillimit të Bashkisë Lushnje.

I.2.2. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje

Në këtë drejtim shkon dhe Vizioni i Planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Lushnje:

"Bashkia e Lushnjes do ta orientojë të ardhmen e saj mbi konceptet e rritjes së ekuilibruar dhe të qëndrueshme. Bashkia do të synojë forcimin e rolit ekonomik të saj në rajon, si qendra e zhvillimit bujqësor dhe blegtoral. Zhvillimi i këtij sektori do të bëhet përmes promovimit të teknikave të prodhimit të produkteve organike dhe cilësore, etiketimit dhe marketimit të tyre, duke synuar rritjen e prezencës së tyre në tregjet vendase dhe ato të huaja. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore do të bëhet në mënyrë të qëndrueshme, duke u kujdesur për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe burimet e tjera natyrore me qëllim garantimin e mirëqenies sociale të qytetarëve ekzistues dhe brezave të ardhshëm. Profili ekonomik i bashkisë do të plotësohet me promovimin e ekoturizmit si potencial i pashfrytëzuar në territoret me

peizazhe të bashkisë së madhe të Lushnjes. Në vizionin e kësaj bashkie, rëndësi të veçantë ka mirëqenia sociale dhe rritja intelektuale si shtylla kryesore që garanton zhvillim të qëndrueshëm. Për këtë arsye, zbutja e pabarazive sociale dhe përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve publike në të gjithë territorin e bashkisë do të jetë prioritet."[2]

Vizioni i PPV'së të Bashkisë Lushnje, shpreh qartë se zhvillimi i territorit për një periudhë 15 vjeçare, duhet të fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm të Sektorit bujqësor dhe blegtoral, për të përforcuar pozicionin ekonomik rajonal, përmes teknikave inovuese, prodhimit cilësor, promovimit dhe synimit të shtrirjes në tregjet vendase dhe ato të huaja. Vlen të theksohet se Vizioni, vendos theksin mbi parimin e qëndrueshmërisë, ku synohet një ekuilibër i qëndrueshëm midis zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe mirëqenies sociale, pa cënuar nevojat e brezave të ardhshëm. Ky parim që udhëheq planifikimin e territorit, orienton dhe politikat zhvillimore/strategjitë/projektet lokale drejte qëndrueshmërisë. Më konkretisht, zhvillimi i potencialit bujqësor të bashkisë, duhet të integroj dhe sfidat mjedisore, si : menaxhimi efikas i tokës, përdorimin racional i ujërave, nxitjen e energjive të rinovueshme, zhvillimin e infrastrukturës që respekton mjedisin etj.

Vizioni PPV'së Bashkia Lushnje synon të arrihet përmes 4 objektiva strategjike:

- O1: mbështetja e zhvillimi të qëndrueshëm te bujqësisë /blegtorisë the agro-përpunimit, si sektor kryesor të ekonomisë dhe punësimit.
- O2: Mbështetje e sektorit të eko-turizmit si sektor mbështetës dhe plotësues i bujqësisë
- O3: Kontrolli i zhvillimit të territorit nëpërmjet harmonizimit të nevojave të banorëve ekzistues dhe të planifikuar.
- O4: Mbrojtja e Burimeve natyrore si baza për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenies të qytetarëve.

Këto objektiva strategjike përkthehen në programe strategjike dhe në një liste të gjere projektesh dhe ndërhyrjesh që parashikohen të realizohen në një hapësirë kohore 15 vjeçare (2016-2031).

I.3. Partneritetet ndër-institucionale dhe ndërkombëtare

Partneritetet ndër-institucionale dhe ndërkombëtare luajnë një rol kyç në zbatimin e Strategjive the dokumenteve të Zhvillimit të Bashkisë Lushnje. Në nivel kombëtar, bashkia bashkëpunon me ministritë linjë si ajo e Bujqësisë, Mjedisit, Infrastrukturës dhe Ekonomisë, si dhe me Agjencinë për Zhvillimin Rajonal (AZHR Fier) për të siguruar koherencë me politikat dhe prioritetet kombëtare e rajonale. Në nivel ndërkombëtar, partneritete me organizata si Delegacioni i BE-së, UNDP, GIZ, FAO, apo BERZH, ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për zhvillim të qëndrueshëm, fuqizim institucional dhe rritje të kapaciteteve vendore. Këto bashkëpunime janë thelbësore për tërheqjen e fondeve të huaja, përmirësimin e planifikimit lokal dhe zbatimin e projekteve transformuese në fushat e bujqësisë, infrastrukturës, mjedisit dhe qeverisjes vendore.

[2] PPV Bashkia Lushnje Miratuar nga KKT, më 29/12/2016

I.4. Metodologjia për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit është një proces që synon të japë drejtim zhvillimit afatgjatë të territorit të Bashkisë Lushnje, përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, të bazuar në të dhëna, evidenca dhe pjesëmarrje të aktorëve lokalë. Më poshtë janë të përshkruara hapat metodologjikë të ndjekur për përgatitjen e këtij dokumenti:

1. Krijimi i Grupit të Punës:

   Në fillim të procesit do të krijohet një grup pune, me përfaqësues nga drejtori të ndryshme të bashkisë. Në këtë grup pune do të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar, dhe do të përcaktohet kalendari i punës për fazat e hartimit.

2. Analiza diagnostikuese dhe profilizimi i bashkisë

   Në këtë fazë do të realizohet një analizë e thelluar e situatës aktuale në të gjitha fushat kyçe: demografi, ekonomi, infrastrukturë, mjedis, kapital njerëzor, kulturë, qeverisje, etj. Bazuar në gjetjet e analizës hartohet konsiderata dhe rekomandime për të identifikuar tendencat, problematikat dhe potencialet e territorit.

3. Hartimi i Analizës SWOT

   Në këtë fazë realizohet analiza e pikave e forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve në secilën fushë prioritare të zhvillimit. Analiza SWOT do të bazohet jo vetëm në të dhënat objektive, por edhe në perceptimet e aktorëve lokalë.

4. Formulimi i Vizionit dhe Objektivave Strategjike

   Në bazë të analizave dhe konsultimeve me publikun, do të hartohet një vizion i përbashkët zhvillimi dhe objektiva strategjikë.

5. Hartimi i Programeve Strategjike dhe Objektivave Specifikë

   Për secilin objektiv strategjik do të identifikohen programet strategjike, për të vijuar më objektiva specifikë të matshëm, të lidhur me rezultate konkrete.

6. Përgatitja e planit veprimi

   Me përcaktimin e objektivave dhe programeve strategjike, do të përpilohet një plan veprimi i detajuar, që përfshin projekte dhe masa të zbatueshme, të ndara sipas afateve (afatshkurtra, afatmesme, afatgjata), me kostot e përafërta, burimet e financimit, indikatorët e matjes dhe njësitë përgjegjëse.

7. Prioritizimi i masave dhe veprimeve

   Për të përcaktuar prioritetet u veprimeve, do të përdorën kritere si ndikimi socio-ekonomik, urgjenca, kosto-efektiviteti, kapaciteti ekzistues për zbatim, përputhshmëria me prioritetet kombëtare dhe mundësia për financim.

8. Monitorimi

   Një njësi përgjegjëse brenda bashkisë do të monitorojë progresin dhe do të raportojë për ecurinë e objektivave në mënyrë periodike.

II. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

II.1. Profili i përgjithshëm

Bashkia Lushnje ndodhet në pjesën jugore të ultësirës perëndimore të Shqipërisë, në zemër të fushës pjellore të Myzeqesë, një nga zonat më pjellore dhe të rëndësishme për prodhimin bujqësor në Shqipëri.

Ajo kufizohet me Bashkitë Fier dhe Roskovec në jug, me Bashkinë Divjakë në perëndim, me Bashkinë Rrogozhinë dhe Peqin në veri, dhe me Bashkinë Belsh dhe Kuçovë në lindje. Pozicionimi gjeografik dhe rrjeti rrugore, pozicionojnë Bashkinë Lushnje si një nyje ndërlidhëse me bashkitë kufitare, të cilat shfaqin një zhvillim të konsiderueshëm të sektorit bujqësor. Në këtë kuadër, Bashkisë Lushnje nuk gëzon vetëm një territor të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, por mund të zhvilloj dhe më tej rolin e një nyje ndërlidhëse rajonale bujqësore dhe agro-përpunuese.




Figura 1- Pozita gjeografike e Bashkisë Lushnje

Klima mesdhetare, me verë të nxehte dhe të thatë dhe me dimër të lagësht dhe të butë, temperaturat mesatare që luhatin nga 15-16°C, ku regjistrohen më shumë se 2800 orë diell në vit dhe reshjet bien kryesisht gjatë muajve të ftohtë, në sasi 900-1200mm/vit, përbëjnë një avantazh tjetër për sa i përket sektorit bujqësor. Në të vërtetë, klima i mundëson fermerëve të nxjerrin më herët në treg produktet e tyre bujqësore, çfarë përbën një avantazh për sa i përket përfitimeve dhe konkurrueshmërisë në treg.

Pozicionimi gjeografik, morfologjia, burimet ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe klima, kane favorizuar ndër vite zhvillimin e sektorit bujqësor, duke e pozicionuar në një ndër territoret me të rëndësishme për prodhimin bujqësor dhe blegtoral në vend.

<u>Konsiderata dhe rekomandime lidhur me profilin e Bashkisë Lushnje</u>

Falë pozicionit gjeografik, klimës dhe pasurive natyrore, sektori bujqësor në Bashkinë Lushnje përbën një avantazhet konkurruese jo vetëm nga pikëpamja e prodhimit, por dhe nga ndërlidhja me tregun lokal dhe atë ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje duhet të mbështes zhvillimin e saj :

- Në zhvillimin e qëndrueshëm të avantazhit konkurrues, sektorin bujqësor.

- Të shfrytëzoj avantazhin gjeografik si nyje ndërlidhëse me ndikim rajonal, duke përqendruar dhe flukset bujqësore të zonave pjellore fqinje.

II.2. Ndarja Administrative territoriale




Figura 4- Ndarja Administrative territoriale

Me reformën territorial të 2015, Bashkia Lushnje pjesë e Qarkut Fier, përbehet nga 11 njësi administrative në të cilat përfshihen qyteti i Lushnjes dhe 85 Fshatra.

Me qëllim përmirësimin e eficiencës se ofrimit të shërbimeve, reforma territoriale grupoi komunat rreth qendrës administrative Lushnje, çfarë pati për efekt reduktimin e strukturave ekzistuese të komunave dhe reduktimin e shërbimeve të ofruara prej tyre. Përqendrimi i një game të gjerë shërbimesh në njësinë qendrore Lushnje, ndikon negativisht në garantimin e aksesit të barabartë ndaj shërbimeve, për banorët e zonave rurale.

Me një sipërfaqe prej rreth 372.72 km², territori i Bashkisë Lushnje përfshin zona urbane, rurale dhe bujqësore me rëndësi strategjike për ekonominë në nivel Qarku dhe Kombëtar. Qendra administrative e Bashkisë Lushnje është qyteti i Lushnjes i evidentuar nga PPK si një qendër sekondare bujqësore, e cila pritet të shërbej si "Hub" për zhvillimin bujqësor dhe Blegtoral në rajon e më gjerë. Ndërsa njësitë e tjera përfaqësojnë një territor me karakter kryesisht rural, me ekonomi të mbështetur fuqimisht në bujqësi dhe blegtori.

Shpërndarje territoriale e fshatrave dhe ndërtimet që kanë vijuar pas viteve 90 përgjatë akseve rrugore, përballin aktualisht bashkinë Lushnje me sfida të shumta lidhur me ofrimin e shërbimeve, kostos së tyre, cilësisë, dhe garantimit të principit të barazisë në aksesin në shërbime bazë.

Tabela 1 Ndarja Administrative

Bashkia	Njësitë administrative	Sipërfaqe Km²	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Lushnje	Lushnjë	24,18	Qyteti Lushnje Fshatrat: Karbunarë, Saver
	Allkaj	25,59	Fshatrat: Toshkës, Zhelizhan, Delisufaj, Biçakaj i vjetër, Allkaj, Lifaj i Ri, Çukas i Ri, Mazhaj
	Bubullimë	36,31	Fshatrat: Bubullimë, Eskaj, Gjonas, Halilaj, Pirrë, Kamçishtë, Imsht

	Hysgjokaj	43,14	Fshatrat: Hysgjokaj, Kurtin, Çanakaj, Kupaj, Lekaj
	Golem	36,99	Fshatrat: Golem i Madh, Allprenaj, Shegas, Hajdaraj, Plug, Golemi i Vogël
	Dushk	31,48	Fshatrat; Gramsh, Dushk Peqin, Konjat, Zham Fshat, Dushk i Madh, Zham Sektor, Thanasaj
	Karbunarë	22,08	Fshatrat: Karbunarë e Sipërme, Mollas, Kasharaj, Kashtëbardhë, Stankarbunarë, Zgjanë, Balaj, Skilaj, Murizë Peqin , Biçakaj
	Ballagat	33,13	Fshatrat; Ballagat, Gjuzaj, Garunjas, Gjyshaj, Jazexhi, Manasufaj, Xibrakë
	Fier Shegan	36,08	Fshatrat: Jeta e Re, Kosovë e Vogël, Fier Shegan, Koçaj, Barbullinjë, Çinar, Sejmenas, Thanë, Çukas i Vjetër, Murriz Kozare, Qerret i Vjetër, Qerret i ri, Biçakaj i Ri
	Kolonjë	43,00	Fshatrat: Kolonjë, Gorre, Bishqethëm, Lumth, Rrapës Fshat, Shakuj, Ardenicë, Bitaj, Rrapës Sektor
	Krutje	40,94	Fshatrat:Krutje e Sipërme, Krutje e Poshtme, Fier i Ri, Zhym, Rrupaj, Lifaj i Vjetër, Kadiaj, Ngurrës i Madh, Ngurrës i Vogël, Arrës, Gjaz
Burimi : Ligj Nr. 115/2014 - Për Ndarjen Administrativoterritoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë			

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me ndarjen administrative

Pas reformës territoriale të vitit 2015, Bashkia Lushnje, pjesë e Qarkut Fier, përfshin 11 njësi administrative me qytetin e Lushnjes dhe 85 fshatra, në një sipërfaqe prej 372.72 km² që përfshin zona urbane, rurale dhe bujqësore me rëndësi strategjike. Shpërndarja territoriale e fshatrave dhe zonave të banuara përbëjnë sot një sfidë të madhe për ofrimin, cilësinë, koston, dhe për garantimin e aksesit të barabartë për të gjithë banorët në shërbimeve publike.

Në këtë kuadër Bashkia Lushnje, duhet të ndërmarri hapa lidhure me:

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike në zonat rurale, parmes hartimit të një plani të decentralizuar ofrimi shërbimesh, i cili përfshin analizën e nevojave, mundësin e zhvillimit të pikave të integruara dhe decentralizuara të shërbimit, vlerësimin e zhvillimit të infrastrukturës dixhitale në ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimit të informacionit etj.

- Zhvillimi i mëtejshëm i qytetit të Lushnjes si një qendër bujqësore dhe si nyje ndërlidhëse rajonal për zhvillimin bujqësor dhe blegtoral, duke mbështetur investimet në agro-përpunim dhe logjistikë, krijimin e zonave ekonomike bujqësore, inkubator rural, sipërmarrjes bujqësore inovuese, bashkëpunimi universitetet qendrat kërkimore/ fermerë etj.

II.3. Morfologjia dhe hidrografia

Si vërehet dhe në hartën e morfologjisë dhe hidrografisë, territori i bashkisë Lushnje përbehet nga fusha në pjesën Jug-perëndimore dhe një natyre kodrinore në pjesën veri-lindore, dhe gëzon një pasuri ujore, me lumenj, rrjete vaditëse, rezervuar etj.

Territori i bashkisë përshkohet në jug të saj nga lumi Seman, ndërsa pjesa veriore e bashkisë ndodhet fare pran Lumit Shkumbin. Sistemet ujitëse dhe të kullimit përbëhet nga kanale të hapura dhe struktura sekondare që mbulojnë pjesë të konsiderueshme të zonave bujqësore. Gjithashtu, në territor vërehet një numër i konsiderueshëm rezervuarësh të cilët përqëndrohen në pjesën veri lindore të territorit të bashksië, ndër të cilët vlen të përmenden rezervuari i Murrizit, i Kasharit dhe Liqeni i Lushnjes.

Përtej ujërave sipërfaqësore, Bashkia Lushnje gëzon edhe një rrjet të pasur burimesh nëntokësore, të cilat ndërlidhen në një shkallë rajonale. Janë pikërisht këto ujëra nëntokësor që kontribuojnë dhe në furnizimin me ujë të pijshëm,

Pavarësisht shtrirjes së gjerë, rrjetit ujitës është e amortizuar dhe kërkon riparim ose rehabilitim, për shkak se shumë kanale janë të bllokuara, me sedimente, mbetje apo të dëmtuara nga erozioni ose ndërhyrja njerëzore. Amortizimi i sistemit të ujitjes dikon në rendimentin e prodhimit, për shkak se fermerët janë shpesh herë të detyruar të përdorin pompa private me kosto të lartë, gjë që ul fitimin dhe rrit varësinë nga energjia.




Figura 2- Harta e morfologjisë dhe hidrografisë

Një situatë e ngjashme, është dhe për sistemet kulluese të amortizua, duke u bër shkas për përmbytje në fshatrat afër Shkumbinit dhe në zonat e ulëta të Krutjes, Fier-Sheganit dhe Ballagatit janë dëshmi e dobësisë së sistemit aktual. Për më tepër amortizimi i sistemit të kullimit nxit kripëzimin e tokës, stagnimin e ujërave, ndotjen mjedisore nga mbetjet bujqësore dhe plehrat kimike, duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme ne rendiment, rritjen e rrit riskut e sëmundjeve, cilësinë e produkteve etj.

<u>Konsiderata dhe rekomandime lidhur me morfologjinë</u>

Territori i Bashkisë Lushnje karakterizohet nga një pasuri ujore e konsiderueshme, me lumenj, rrjete vaditëse dhe rezervuarë që furnizojnë zonat bujqësore. Megjithatë, sistemet e ujitjes dhe kullimit janë të amortizuara, me kanale të bllokuara ose të dëmtuara, çka ndikon negativisht në prodhimtari, rrit kostot për

fermerët dhe shkakton probleme mjedisore si kripëzimi i tokës, ndotja dhe përmbytjet në zonat e ulëta (kryesisht pran zonës së Lumit Seman)

Në këtë kuadër bashkia Lushnje duhet të ndërmarri hapa të ndryshëm lidhur me :

- Hartimi i një plani të qëndrueshëm menaxhimi të burimeve ujore, në të cilin përfhsihen, inventarizimi, analiza e nevojave, plani i monitorimit periodik i gjendjes së rrjetit, identifikimin e zonave kritike që kërkojnë investime prioritare dhe mundësit e
- Rehabilitimi i rrjeteve ekzistuese të ujitjes dhe kullimit.
- Investime në riparim/ zgjerim të digave ekzistuese ;


II.4. Analiza Demografike dhe Sociale

II.4.1. Demografia e Bashkisë Lushnje

Me regjistrimin e fundit të popullsisë (Census 2023), Bashkia Lushnje regjistron 63,135 banorë rezident, ku rreth 41% e popullsisë banon në Njësinë Administrative Lushnje e cila është dhe qendra e Bashkisë, ndërsa rreth 59% të banorëve jetojnë në zona rurale.

Tabela 2 Popullsia e Bashkisë Lushnje

Njësia Administrative	Popullsia	
Allkaj	3043	4,8%
Ballagat	1711	2,7%
Bubullimë	4280	6,8%
Dushk	5157	8,2%
Fiershegan	5230	8,3%
Golem	3529	5,6%
Hysgjokaj	1787	2,8%
Karbunarë	2692	4,3%
Kolonjë	4147	6,6%
Krutje	5523	8,7%
Lushnje	26036	41,2%
Bashkia Lushnje	63135	100%




Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Ndërsa nga të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile, rezulton në Bashkinë Lushnje janë të regjistruar 132303 banore, në 1 Janar te 2025[3]. Diferenca e lartë mes popullsisë rezidente dhe asaj të regjistruar në Gjendjen Civile, rrjedhë si pasoj e nivelit të lartë të migrimi të jashtëm dhe të brendshëm të dekadave të fundit. Një pjesë e madhe e qytetarëve vazhdojnë të mbeten të regjistruar në adresën e tyre të mëparshme edhe pse fizikisht nuk banojnë më aty. Për shka të migrimi jashtë vendit, një pjesë e konsiderueshme e banorëve që kanë migruar dhe janë resident në një shtet të huaj, figurojnë ende të regjistruar në gjendjen civile të

[3] Burimi: Gjendja Civile Bashkia Lushnje

Bashkisë Lushnje. Po ashtu, shumë qytetar të bashkisë Lushnje janë shpërngulur drejt qyteteve të tjera më të mëdha në kërkim të punës, edukimit apo kushteve më të mira jetese, por nuk e kanë ndryshuar zyrtarisht vendbanimin e tyre në regjistrin civil. Ky fenomen rrjedh kryesisht prej faktit se sistemi aktual i gjendjes civile, burokracia administrative dhe/ose mungesa e vullnetit të qytetarëve, nuk mundësojnë pasqyrimin e migracionit të brendshëm dhe lëvizjet demografike në kohë reale. Diferenca e lartë mes popullsisë rezidente dhe asaj të regjistruar në gjendjen civile, rezulton kryesisht për shkak të nivelit të lartë të migrimit të jashtëm dhe atij të brendshëm.

Grafiku 1- Popullsia rezidente Census 2023 dhe Popullsie a regjistruar në gjendje Civile 2025.



Konsiderata dhe Rekomandime lidhur me popullsinë

Fakti se struktura demografike a Bashkisë Lushnje përbëhet kryesisht nga banorë që jetojnë në zona rurale, vendos theksin mbi rolin e rëndësishëm dhe fokusit që duhet te ketë pushteti publik në garantimin e qëndrueshmërisë së sektorit bujqësor në zhvillimin e territorit. Ndërsa shkalla e lartë e migrimit brenda dhe jashtë vendit, lë të kuptohet se Bashkia Lushnje përballet me problematika të thella lidhur me situatën socio-ekonomike.

Në këtë kontekst, për të mbështetur një planifikim sa më të saktë të politikave publike në nivel vendor, Bashkia Lushnje duhet të zhvilloj një inventar demografik të detajuar, që monitoron lëvizjet e popullsisë, vlerëson potencialin e kthimit nga migrimi, dhe vlerëson dinamikat demografike në kohë reale dhe në shkallë lokal.


II.4.2. Përbërja Demografike

Grup-moshat

Popullsia e Bashkisë Lushnje shfaq një moshë mesatare relativisht të re, prej 36,4 vjeç dhe përbehet nga:

- 8 442 banorë (ose 13,4 % e popullsisë) nga grup-mosha 0–14 vjeç;
- 39 633 banorë (ose 62,8 % e popullsisë) nga grup-mosha 15–64 vjeç;
- 15 060 banorë (ose 23,8 % e popullsisë) nga grup-mosha 65+ vjeç;

Grafiku 2- Përbërja Demografike - Census 2023




Burimi : Census 2023 - INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Krahasuar me mesataren kombëtare, struktura demografike e popullsisë së Bashkisë Lushnje tregon tendenca të qarta të plakjes. Konkretisht, përqindja e grup-moshës 0-14 vjeç në këtë bashki është më e ulët se mesatarja kombëtare prej 15,6%[4], ashtu si edhe grup-mosha aktive 15-64 vjeç, e cila gjithashtu qëndron nën nivelin kombëtar prej 64,7%[5] (me përjashtim të njësive administrative Karbunarë dhe Golem). Ndërkohë, përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 19,7%[6], çka reflekton qartë se popullsia rezidente e Bashkisë Lushnje shfaq një plakje me të lartë se mesatarja kombëtare.

[4] Census 2023 - INSTAT
[5] Census 2023 - INSTAT
[6] Census 2023 - INSTAT

Grafiku 3 - Përbërja Demografike e Bashkisë Lushnje 2011 dhe 2023



Burimi : Census 2011 dhe 2023 - INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Krahasimi ndërmjet regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 dhe atij të vitit 2023 për Bashkinë Lushnje tregon një transformim të theksuar të strukturës demografik, me një tendencë të qartë drejt plakjes së popullsisë. Grup-mosha 0-14 vjeç ka rënë ndjeshëm, nga 18,9% në vitin 2011 në vetëm 13,4% në vitin 2023, ndërsa përqindja e grup-moshës aktive 15-64 vjeç është ulur nga 69,1% në 62,8%. Më i dukshëm është rritja e popullsisë mbi 65 vjeç, e cila është pothuajse dyfishuar, nga 12,0% në 2011 në 23,8% në 2023. Këto ndryshime dëshmojnë për një plakje të përshpejtuar të popullsisë, që sjell pasoja të rëndësishme për tregun e punës, sistemin shëndetësor dhe politikat sociale të bashkisë.


Piramida e Moshës

Piramida e moshës e Bashkisë Lushnje shfaqet në ”formë kërpudhe”: e karakterizuar nga një bazë e ngushtë dhe një majë e gjerë, karakteristike e një shoqëri në tranzicion demografik me lindshmëri të ulët, përqendrim të popullsisë në moshë pune dhe një popullsi në plakje. Me konkretisht Piramida e moshës se Bashkisë Lushnje paraqet :

- Një Bazë e ngushtë dhe në tkurrje për grup-moshën 0–14 vjeç, çfarë tregon një nivel të ulët dhe në rënie të lindshmërisë, shkak për të cilin mund të jenë: vijueshmëria e eksodit rural, urbanizimi, kosto e lartë jetese, emigrimi i çifteve të reja, ose politikat in-efikase në mbështetjen e familjes dhe riprodhimit.
- Një mes cilindrik i piramidës ose grup-moshës 15–49 vjeç, çfarë tregon një popullsi në moshë pune ende të konsiderueshme, që rrjedh nga një nivel lindshmërie relativisht lartë në dekadat e kaluara (pavarësisht shkallës së lartë te migrimit).
- Zgjerimi i konsiderueshëm i piramidës për grup-moshës 50 – 65 vjeç, tregon qartë se në dekadën e ardhshme Bashkia Lushnje do te përballet me një rritje të konsiderueshme të të moshuarve, çfarë nënkupton se forca e ardhshme punëtore pritet të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme, se plakja e popullsisë pritet të risi presionin në sistemin e pensioneve, shëndetësinë dhe shërbimeve ndaj të moshuarve, dhe nevojat për riformulim/adaptim të politikave publike.
- E krahasuar në shkallë qarku, piramida e moshës së Bashkisë Lushnje shfaq karakteristika të ngjashme me Piramidën e Qarkut Fier. Por, nëse krahasojmë piramidën e moshës se Bashkisë Lushnje me piramidën na shkallë vendi, vërehen se popullsia e Bashkisë Lushnje shfaq :


- Një nivel më të ulët të grup-moshës 0-14 vjeç, çfarë tregon një nivel të lidhshmërisë dhe kapacitetit rinovues të popullsisë me te ulët se ai kombëtar.
- Një nivel më të ulët të grup-moshës 15- 40 vjeç, që nënkupton një nivel më të lartë migrimi të moshës së re, se ai kombëtar.
- Një nivel më të lartë të grup-moshës 50-69 vjeç, çfarë tregon një plakje më të shpejtë të popullsisë, se ai kombëtar.

Grafiku 4 - Piramida e moshës



Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Grafiku 5- Tendencat demografike në shkalle Bashkie, Qarku dhe Kombëtare.



Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Në këtë kontekst, piramida e moshës së Bashkisë Lushnje tregon:

- Një shoqëri që me natalitet të ulët, në pamundësi për të rinovuar popullsisë në të ardhmen;
- Një shoqëri që po plaket me ritme tepër të shpejta;
- Një shoqëri e cila do të përballet me një mungesë të theksuar fuqisë punëtore në 10 vitet e ardhshme;

Bilanci natyror i Bashkisë Lushnje

Në 2023, bashkia Lushnje regjistron 515 lindje, dhe 639 vdekje[7]. Bazuar në bilancin natyror të bashkisë Lushnje, rezulton se që në 2019 niveli i lindshmërisë ka kalon nën nivelin e vdekjeve, duke treguar se dinamikat demografike shfaqin një mungesë të theksuar të kapacitetit rinovues të popullsisë, që shoqërohen me plakjen e popullsisë dhe zvogëlimin e fuqisë punëtore aktive.

Grafiku 6 - Bilanci natyror i Bashkisw Lushnje 2011-2023



Burimi : Census 2024 - INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Koeficientit të Varësisë

Regjistrimet e popullsisë 2023, tregojnë një rritje të konsiderueshme të Koeficientit të Varësisë (koeficient që mat raportin midis popullsisë joaktive- fëmijë dhe të moshuar, dhe popullsisë në moshë pune). Në të vërtetë, Koeficientit të Varësisë kalon nga 44,8% ne 2011 në 59,3% ne 2023, çfarë nënkupton se një numër gjithnjë e më i vogël personash aktivë, duhet të mbajë mbi supe barrën ekonomike të një popullsie në varësi gjithnjë e më të lartë.

Përtej presionit mbi popullsinë aktive, rritja e koeficientit të varësisë rrezikon të ushtrojë presion të madh mbi shërbimet publike qendrore dhe lokale. Rënia e koeficientit të varësisë së të rinjve nga 27,4% ne 2011 në 21,3% në 2023, vendos theksin mbi tendencat në rënie të kërkesës për shërbime arsimor Ndërsa rritja e koeficientit të varësisë së të moshuarve nga 17,4% ne 2011 në 38% në 2023, ushtron një presion të madh mbi shërbimet publike, veçanërisht mbi sistemin e pensioneve, shërbimet shëndetësore dhe kujdesit social ndaj të moshuarve.

Për rrjedhojë, Bashkinë Lushnje përballet me sfida serioze lidhur me:


- Rishikim i planeve të investimeve publike në shërbime arsimore për fëmijët (investime në shkolla, kopshte, çerdhe, staf dhe infrastrukturë mbështetëse).
- Investime në kujdesin shëndetësor të specializuara për të moshuarit. Sistemet ekzistuese shëndetësore mund të përballen me mbingarkesë dhe nevojë për më shumë staf, pajisje dhe investime lidhur me kapacitetin dhe shtrirjen territoriale të shërbimeve.
- Rritje e kërkesës për shërbime sociale dhe përkujdesje. Me rritjen e numrit të pensionistëve, rriten dhe nevoja për ndihmë ekonomike, përkujdesje në shtëpi, strehim social dhe programe të

[7] Instat 2024

mbështetjes familjare, çka shton barrën financiare jo vetëm për buxhetin qendror por dhe për buxhetet vendor.


Ne konkluzion, rënia e grup-moshës 0-14 dhe rritja e grup-moshës mbi 65 vjeç, zhvendos prioritetet e investimeve publike nga arsimi drejt shëndetësisë dhe përkujdesjes.

Grafiku 7 - Koeficientit të Varësisë 2011



Burimi : Census 2011- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Grafiku 8 - Koeficientit të Varësisë 2023



Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Njësitë Ekonomike Familjare

Njësitë ekonomike familjare përfaqësojnë një bashkësi themelore individësh që jetojnë bashkë, ndajnë të njëjtën banesë dhe ndajnë shpenzimet për jetesën, ku një ose më shumë anëtarë janë të përfshirë në veprimtari ekonomike për të siguruar të ardhura. Madhësia mesatare e Njësive Ekonomike Familjare në Bashkinë Lushnje është rreth 2.9 persona/NJEF, duke shënuar një vlerë më të ulët se mesatarja kombëtare dhe një rënie prej pothuajse se 1 anëtari krahasuar me regjistrim e mëparshëm të popullsisë(3.8 anëtar/NjEF. në 2011[8]).

Rënia e numrit të anëtarëve në njësitë ekonomike familjare është një tregues i fort i fenomeneve të ndryshme socio-ekonomike , si :

- Uljen e lindshmërisë,
- Plakjen e popullsisë,
- Migrimin e të rinjve,
- Rritja e rasteve të divorcit apo lindjes jashtë martese;
- Ndryshimi i stilit të jetesës, ku të rinjtë preferojnë të jetojnë në banesa të veçanta, të ndarë nga familja e origjinës.

Grafiku 9- Njësitë Ekonomike Familjare.



Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Strukturat familjare e Bashkisë Lushnje po zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme, çfarë është një tregues i fort i një shoqërie në tranzicion e cila përballet me vështirësi ekonomike dhe sociale.

[8] Census 2011, INSTAT

Raporti gjinor

Raporti gjinor mesatar në Bashkinë Lushnje është 100.2, çka tregon një balancë shumë të mirë mes numrit të meshkujve dhe femrave në shkallë bashkiake. Megjithatë, kjoo mesatare fsheh variacione të dukshme mes njësive administrative të saj, duke reflektuar faktorë të ndryshëm demografikë dhe socialë.

Grafiku 10- Raporti Gjinor sipas njësive administrative.



Njësitë administrative me raport gjinor nën 100 (pra ku dominojnë femrat):

- Lushnje (qytet): 97.4
- Karbunarë: 97.4
- Ballagat: 98.0
- Dushk: 99.7

Njësitë me raport gjinor mbi 100 (ku dominojnë meshkujt):

- Bubullimë: 108.8
- Allkaj: 105.1
- Krutje: 104.2
- Kolonjë: 102.1
- Fier Shegan: 101.2
- Hysgjokaj: 100.6
- Golem: 100.6

Banorë me aftësi të kufizuara

Në bashkinë Lushnje të paktën një ndër 11 banorë deklarojnë se kanë të paktën një formë kufizimi në funksione bazë të jetës (ose: 8.9% e popullsisë)


- Kufizim lidhur me lëvizjen: 5.8%
- Kufizim lidhur me shikimin: 3.3%
- Kanë nevojë për kujdesi ditor: 2.4%
- Kufizim lidhur me dëgjimin: 2.3%
- Kufizim lidhur me kujtesën: 2.2%
- Kufizim lidhur me komunikimin: 1.6%

Nisur nga këto të dhëna, Bashkia Lushnje duhet të përmirësoj/adaptoj shërbimet për t,ju përgjigjur nevojave të kësaj kategorie, duke ofruar shërbime transporti të aksesueshme, programe mbështetëse për aftësinë e kufizuar, dhe një urbanizim gjithëpërfshirës.

Dinamikat Demografike

Për shkak të emigracionit të brendshëm dhe të jashtëm, popullsia e bashkisë Lushnje shfaq tendenca negative, duke shënuar një rënie të vazhdueshme të popullsisë në 20 vitet e fundit, ku vetëm në periudhën 2011-2023 shënohet një rënie prej 24,5 %, duke tejkaluar mesataren kombëtare prej 14,2%[9].

Grafiku 11- Dinamikat Demografike të Bashkisë Lushnje




Burimi : Regjistrimet e popullsisë - INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Të gjitha njësitë administrative përbërëse të Bashkisë Lushnje, shfaqin një rritëm rënie demografike më të lartë se mesatarja kombëtar. Janë pikërisht njësitë administrative rurale që shfaqin dhe ritmin më të larta shpopullimit, duke shënuar rënie që tejkalon 1/3 e popullsisë në një diapazon kohor prej 12 vitesh, si në rastin e Njësive Dushk, Golem, Hysgjokaj dhe Karbunarë. Pavarësisht se këto tendenca negative janë më të theksuara në zonat rurale, një rënie e vazhdueshme e popullsisë vërehet dhe në qytetin e Lushnjes, i cili ka humbur rreth 16,3% e popullsisë vetme në 12 vitet e fundit.

[9] Census 2023 - INSTAT

Grafiku 12- Dinamikat Demografike të Njësive Administrative 2011-2023



Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Shpopullimi përbën një sfidë tepër serioze për Bashkinë Lushnje dhe pritet të ketë ndikime të shumta në aspektin social dhe ekonomik. Me rënien e volumit të fuqisë punëtore, frenohet dhe zhvillimi i më tejshëm i aktivitetit ekonomik të bashkisë, rritet risku i braktisjes së aktiviteteve ekzistuese, pronave dhe banesave, dhe redukton atraktiviteti territorial për të tërhequr investime dhe aktivitete të reja ekonomike, etj. Gjithashtu, shpopullimi shoqërohet dhe me humbjen e kapitalit njerëzor të kualifikuar dhe njohurive lokale, çfarë ndikon negativisht në ruajtjen e kapaciteteve teknike dhe trashëgimisë së dijes, vështirëson përshtatjen me teknologji të reja dhe inovacion, dhe për rrjedhojë në konkurueshmërinë e aktivitetit ekonomik të bashkisë në treg të gjerë. Me uljen e popullsisë, shërbimeve publike si shkollat, qendrat shëndetësore dhe transporti publik, bëhen më pak të qëndrueshme ekonomikisht, duke çuar në disa raste në mbyllje ose kufizim të tyre, çfarë krijon një cikël negativ të zbrazjes së territorit. Nga pikëpamja sociale dhe kulturore, shpopullimi dobëson kohezionin social, traditat vendore dhe identitetin kulturor të zonës. Nisur nga fakti se janë pikërisht të rinjtë që shfaqin tendencën me te lartë për tu larguar, bën që fshatrat të mbeten kryesisht të populluara nga të moshuarit, duke rritur rrezikun e izolimit social dhe varfërisë.

Në këtë kontekst, Bashkisë Lushnje duhet të adresoj me urgjencë efektet e shpopullimit, duke ndërmarr masa për të ruajtur popullsinë e saje.

Projektimet demografike

Bashkia Lushnje, ashtu si shumë bashki të tjera të Shqipërisë, po përballet me një dinamikë demografike sfiduese që mund të përkeqësohet me rritmë të shpejta në vitet në vijim, nëse nuk merren masa të duhura. Tendencat aktuale, sugjerojnë një tkurrje të popullsisë si rezultat i migracionit të vazhdueshëm, nivelit të ulët të lindshmërisë dhe plakjes së popullsisë. Në zonat rurale, efekti i shpopullimit është dhe me i theksuar, për shkak se prek grup-moshat e reja, të cilët largohen drejt qyteteve të mëdha apo jashtë vendit për arsye punësimi, arsimi dhe cilësie më të lartë të jetesës. Qyteti i Lushnjes, si qendër administrative dhe ekonomike e bashkisë, shfaq një tendencë më të moderuar të renies se popullsisë, kjo për shkak të rolit të saj qendror, përqendrimit të shërbimeve dhe mundësive ekonomike.

Bazuar projeksioni i popullsisë sipas tendencave aktuale, vërehen se :

- grup-mosha 0–14 vjeç pritet të kaloj në vetëm 6585 në 2030, duke përfaruar vetëm 11,65 % të popullsisë dhe duke shënuar një rënie prej me shume se 1850 banor. Kjo rënie e konsiderueshme tregon qartë një të ardhme me mungesë të prurjeve të reja në sistemin arsimor dhe më tej në tregun e punës.

- grup-mosha 15–64 vjeç pritet të kaloj në vetëm 32 825 në 2030, duke përfaqësuar vetëm 58,05 %. Kjo rënie të konsiderueshme, tregon qartë sfidat e ardhshme për fuqi punëtore dhe plakjen e popullsisë.

- grup-mosha +65 vjeç pritet të kaloj në 17 132 në 2030, duke përfaruar 30,3 % të popullsisë, dhe duke shënuar një rritje prej me shume se 2070 banor. Kjo rritje e konsiderueshme tregon qartë rritjen e kërkesës për shërbime shëndetësore, sociale dhe përkujdesi, si dhe shtimin e barrës mbi sistemet e mbështetjes sociale dhe ekonomike.

Ky transformim demografik kërkon përgjigje të mirëplanifikuara politike, sociale dhe ekonomike nga Bashkia Lushnje, për të adresuar sfidat e plakjes, për të përmirësuar shërbimet për të moshuarit dhe për të stimuluar qëndrimin dhe kthimin e të rinjve në zonë. Në këtë kontekst, Bashkia duhet të ndërmarrë masa për të ndalur ritmet e larta të shpopullimit, kryesisht për grup-moshat e reja në zonat rurale. Për këtë arsye, politikat e zhvillimit të bashkisë, duhet të jenë të ndjeshme ndaj ndryshimeve demografike dhe të fokusohen në rigjallërimin ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ofrimin e mundësive të qëndrueshme për banorët aktualë dhe të ardhshëm.

Këto masa mund të ndërmerren, përmes zhvillimit ekonomik lokal, përmirësimit të cilësisë së jetës, politikave për të rinjtë dhe mbështetjes për kthimin e diasporës.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me demografinë

Nga analiza e grup-moshave, piramidës së moshave, bilancit natyror, koeficienti të varësisë, përbërjes familjare dhe projeksioneve, rezulton se:

- Bashkia Lushnje regjistron një bilanc natyror negativ, me një natalitet të ulët dhe një shoqëri në pamundësi për të rinovuar popullsisë në të ardhmen, çfarë vendos theksin mbi nevojën për të ndërmarr masa lidhur me politika vendore në mbështetje të lindjeve.

- Grup-mosha 0-14 vjeç shfaqin një rënie të konsiderueshme ndër vite, kjo tendence pritet të vijoj dhe në të ardhmen par shkak të nivelit të ulët të lidshmërisë. Rënia e kërkesës për shërbime publike si çerdhe, kopshte dhe shkolla pritet të thellohet në mënyrë të konsiderueshme në vitet e ardhshme, për ketë arsye lind nevoja për të rishikuar me urgjencë politikat dhe riorientuar investimeve lidhur me sistemin arsimor.

- Bashkia Lushnje shfaq një popullsi me të moshuar se mesatarja kombëtare dhe një shoqëri që po plaket me ritme tepër të shpejta, ku grup-mosha mbi 65 vjeç pritet të rritet në mënyrë të konsiderueshmë në vitet e ardhëshme. Ky fenomen, tregon se Bashkia Lushnje përballet me një kërkesa gjithnjë e më të larta për shërbime publike për të moshuarit (si për shembull shërbime shëndetësore dhe sociale, ndihmë ekonomike etj.). Për këto arsye lind nevoja për të rishikuar/zhvilluar politika në zhvillimin e shërbimeve dhe kushteve të jetesës për të moshuarit

- Bashkia Lushnje shfaq një shoqëri e cila pritet të përballet me një mungesë të theksuar fuqisë punëtore. Grup-mosha 15-64 vjeç shfaqin një rënie të konsiderueshme, fenomen që pritet të vijoj dhe në vitet në vijim. Mungesa e fuqisë punëtore pritet të ndikoj negativisht në zhvillimin e produktivitetit ekonomik, në mbulimin skemave sociale dhe të pensioneve, dhe në rritjen e barrës për punonjësit aktivë. Për këto arsye lind nevoja për të rishikuar/zhvilluar politika të punësimit, nxitjes të rikthimit të të rinjve dhe emigrantëve, tërheqjes së diasporës, zhvillim të kapitalit njerëzor etj.

Tendencat demografike aktuale të Bashkinë Lushnje kërkojnë veprim të menjëhershëm dhe të koordinuar, të cilat kombinojnë politikat sociale, ekonomike dhe territoriale, të cialat fokusohen në ruajtjen e potencialit njerëzor, shërbime të përshtatura për një shoqëri që plaket, si dhe politika për të nxitur lindshmërinë dhe rikthimin e migruesve. Këto veprime mund të konkretizohen përmes politikash, plane masash, strategjie demografike lokale, programe dhe projekte etj. ndër të cilat mund të përmenden:

- Hartimi i një Strategjie Demografike, e cila të bazohet në të dhënash të detajuara dhe desagreguara për popullsinë, migracionin, lindshmërinë dhe shërbimet ekzistuese.

- Hartimi i politikave për rritjen e lindshmërisë dhe mbështetje për familjet e reja, në të cilin parashikohen: skema subvencioni të plota ose të pjesshme për çerdhe dhe kopshte; programe strehimit për çiftet e reja; lehtësira fiskale për familjet me më shumë se 2 fëmijë; Shërbime për fëmijët falas për nënat që punojnë ose janë në formim profesional; etj.

- Hartimi i politikave të nxitjes së rikthimit të të rinjve dhe emigrantëve, në të cilin parashikohen platforma regjistrim vullnetar të emigrantëve që dëshirojnë të kthehen; paketa stimuluese për kthimin e emigrantëve (si për shembull: tokë bujqësore, kredi të buta, trajnime); fushata sensibilizuese punësimi në sektorët prioritare (si bujqësi, agro-industri, agro-turizëm) etj.

- Hartimi i politikave të përmirësimit të kushteve të jetesës për të moshuarit, në të cilin parashikohen krijimi i shërbimeve të integruara për të moshuarit (si qendra ditore, shërbime shtëpiake, vizita shëndetësore në shtëpi, ndihmë sociale); nxitja e projekteve që angazhojnë të moshuarit aktivë; fushata trajnimi të stafit të kujdesit social; qendra multifunksionale për përkujdesje, argëtim dhe integrim social etj.

- Hartimi i një plani riorganizimi të rrjetit arsimor, në të cilin parashikohen: investime në arsim dhe zhvillim të kapitalit njerëzor; mbyllje ose bashkim i shkollave me pak nxënës; zhvillimi i shkollave qendrore me transport falas dhe të garantuar; kurse dhe formim profesionale për të rinjtë në sektorët me potencial (si bujqësi, TIK, turizëm) etj.

- Hartimi i një plani të riorganizimi të rrjetit shëndetësor sipas strukturës demografike, në të cilin parashikohen: Riorganizim i qendrave shëndetësore; zhvillimi i shërbimeve të lëvizshme; zhvillimi i shërbimeve të kujdesit paliativ, telemjekësi etj.

- Hartimi i politikave të punësimit që synon mbajtjen e forcës punëtore, në të cilin parashikohen: Fushata ndërmjetësimi dhe orientimin profesional; programe mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; stimuj fiskalë për bizneset që punësojnë të rinj dhe gra; grante të vogla për start-up në zona rurale; grante për zhvillimi i turizmit dhe agro-industrisë; skema promovimi ta zonave të reja industriale dhe inkubatorëve të biznesit etj.

II.4.3. Arsimi, shëndetësia, kultura, barazia gjinore

Bashkia Lushnje mbart një histori të gjatë në fushën e arsimit, por aktualisht përballet me sfida të shumta lidhur me zhvillimin e kapitalit njerëzor. Strukturat arsimore ekzistuese ofrojnë shërbime nga arsimi parashkollor deri në atë të mesëm të lartë, ndërkohë që mungesa e një universiteti publik në qytet kufizon mundësitë për arsimin e lartë në nivel vendor.


Arsimimi i popullsisë së Bashkisë Lushnje

Regjistrimi i fundit i popullsisë, se niveli i përgjithshëm i arsimimit të popullsisë është relativisht i ulët, Krahasuar me mesataren kombëtare:

- 51,6% e popullsisë se Bashkisë Lushnje është me arsim fillor ose te mesëm të ulët (arsimin 8 ose 9 - vjeçar sipas reformave), kur në rang kombëtar kjo vlerë është vetëm prej 43%.
- 31% e popullsisë se Bashkisë Lushnje është me arsim të mesëm, kur ne rang kombëtar kjo vlerë është 33,7%.
- 11,7% e popullsisë se Bashkisë Lushnje është me arsim Arsimi Universitar dhe/ose Pasuniversitar, kur në rang kombëtar kjo vlerë është 19,5%.


Më shumë se gjysma e popullsisë ka përfunduar arsimin 8-vjeçar dhe pothuajse1/3 ka përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional, dhe vetëm 11.7% e popullsisë ka përfunduar arsimin e lartë. Krahasuar me mesataret kombëtare, Bashkia Lushnje regjistron një popullsi me arsimim relativisht të ulët, çka ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe disponueshmërinë e forcës punëtore të kualifikuar. Ky deficit përbën një pengesë për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Mungesa e kompetencave teknike dhe profesionale kufizon adoptimin e teknologjive të reja, rritjen e produktivitetit dhe inovacionin, duke e bërë zonën më pak tërheqëse për investitorët. Për të përmbushur kërkesat e tregut të punës dhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë lokale, është e domosdoshme të investohet në trajnime/formime profesionale dhe në lidhjen e arsimit me nevojat reale të sektorëve ekonomikë prioritarë.

Grafiku 13- Arsimimi i popullsisë së Bashkisë Lushnje



Burimi : Census 2023- INSTAT (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Figura 3- Harta e Arsimimit të Popullsisë





Vlen të theksohet se ekziston një ndarje gjeografike, ku banorët e zonave rurale kanë nivele më të ulëta arsimimi, ndërsa popullsia ma arsimim të lartë janë të përqendruar në qytetin e Lushnje. Ndarja gjeografike, reflekton diferencat në akses ndaj institucioneve arsimore dhe diferencën e mundësive ekonomike midis qytetit dhe fshatrave.

Sistemi Arsimor

Për nga pikëpamja territoriale, Bashkia Lushnje ka një rrjet relativisht të shpërndarë të kopshteve dhe shkollave 9 vjeçare publike, të cilat janë të pranishme pothuajse në të gjithë qendrat e banuara të njësive administrative. Pavarësisht, këtij rrjeti relativisht të zhvilluar, vërehet se:

- Numri i fëmijëve në kopshtet dhe shkollat 9 vjeçare është në rënie.
- Në zonat rurale, ambientet e kopshteve vendosen në godinat ose ambiente e shkollave.
- Në disa fshatra, kopshtet funksionojnë me orare të reduktuara.
- Mungesë e stafit të kualifikuar, veçanërisht për arsimin parashkollor.

- Nuk ekziston sistem transporti publik të dedikuar për fëmijët në vendbanime të izoluara etj.

Figura 4- Kopshte në Bashkinë Lushnje	*Figura 5- Shkolla 9 vjeçare në Bashkinë Lushnje*
	

Nga ana tjetër, shkollat e mesme publike shfaqin një shpërndarje territoriale më të lartë, çfarë nënkupton dhe një akses më të vështirë për nxënësit që jetojnë në vendbanime të izoluara. Në të vërtetë, nxënësit nga zonat më të largëta duhet të përshkojnë distanca të mëdha për të ndjekur shkollën e mesme, çka nxit braktisjen. Shkolla e Mesme Profesionale « Hasan Gina » është e vetmja shkollë publike profesionale në Bashkinë Lushnje. Kjo shkollë ofron një gamë të gjerë formimi, që mbulon informatikën, ekonominë dhe biznesin, elektroteknike, termohidrauliken, transportin etj.

Figura 6- Shkolla të mesme në Bashkinë Lushnje





Figura 7- Mbullimi territorial i Shkollava të mesme në Bashkinë Lushnje



Ashtu si dhe në zona të tjera të Shqipërisë, Bashkisë Lushnje përballen me vështirësi të ndryshme për sa i përket sistemit arsimor, si:

- Mungojnë shërbimeve të arsimi parashkollor në shumë fshatra për shkak të kërkesës së ulët dhe mungesës së burimeve;
- Kushtet dhe cilësia e shërbimeve arsimore mbeten ende të dobëta, veçanërisht në zonat rurale.
- Ulje nga viti në vit e numrit të nxënësve, cenon qëndrueshmërinë e strukturave arsimore, veçanërisht në zonat rurale.
- Arsimi i mesëm mbetet ende i vështirë për t'u ndjekur nga nxënësit që jetojnë në zona rurale të izoluara për shkak të distancës dhe kostove të transportit;
- Mungesa e universiteteve qofte publik qoftë privat, kontribuon në migrim e të rinjve drejt qyteteve të mëdha.
- Pavarësisht se shkollës profesionale publike « Hasan Gina », vërehet se në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje nuk ofrohen arsim profesional publik lidhur me sektorin e bujqësor dhe agro-përpunues, duke lënë të kuptohet se sistemi aktual i formimit profesional nuk i përgjigjet nevojave reale të tregut lokal të punës.

Si pasojë e këtyre vështirësive, të rinjtë nga zonat rurale përballen me më pak mundësi për zhvillim personal dhe profesional, duke kontribuar në ciklin e varfërisë dhe shpopullimit të fshatrave. Kjo situatë kërkon politika të dedikuara për barazinë e shanseve në arsim.

Ulje nga viti në vit e numrit të nxënësve, detyron bashkinë Lushnje të kryej një analizë të thelluar të nevojave për shërbime arsimore dhe investime, kjo për shkak se qëndrueshmëria e institucioneve arsimore në zonat rurale cenohet nga kërkesë e ulët. Për këtë arsye, hartimi i një Strategjie Lokale për Zhvillimin e Aftësive dhe Sistemit Arsimor, do të mundësonte një organizim eficent dhe cilësor të sistemit arsimor, që i përgjigjet tregut të punës dhe garanton akses dhe shance të barabrata për secilin nxënës.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me arsimimin e popullsisë

Niveli i ulet i arsimimit dhe kualifikimit të forcës punëtore, është një nder pengesat kryesore për të përthithur investime dhe zhvillimin teknologjik të një territori. Për këtë arsye, Bashkia Lushnje duhet të ndërmarri masa në zhvillimin e forcës punëtore dhe kapitalit njerëzor. Për ta arritur këtë bashkia mund te ndërmarri hapa të ndryshme si:

- Hartimi i një Strategjie Lokale për Zhvillimin e Sistemit Arsimor, i cili synon të riorganizoj sistemin arsimor me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve, aksesueshmërinë, barazinë dhe eficiencës ekonomike, duke orientuar veprimet drejtë nevojave reale të tregut të punës.

- Fuqizimi i Qendrave të Formimit Profesional dhe Aftësive, falë nxitjes se programe fleksibël dhe moderne, në bashkëpunimit me biznesin lokal dhe kurseve me bazë praktikën, etj.

- Nxitja e zhvillimit të arsimit profesional dhe / ose ofrimi i specialiteteve në arsimin e mesëm te përgjithshëm në drejtimet bujqësore, agro-përpunuese dhe të teknologjisë për të adresuar nevojat e tregut lokal të punës.

- Përmirësimi i sistemit të arsimit, duke kryer investimeve në infrastrukturën arsimore, veçanërisht në shkolla të mesme dhe laboratorë praktikë.

- Nxitja e bashkëpunimit me strukturat e arsimit të lartë në vend.

II.5. Ekonomia Lokale

II.5.1. Aktiviteti ekonomik në Bashkisë Lushnjë

Ndërmarrje Aktive


Nga të dhënat e Regjistrit të Bizneseve të ofruar nga INSTAT, vlerësohet se janë 2791 ndërmarrje aktive në Bashkinë Lushnje (ku nuk përfshin fermerët e regjistruar), ndër të cilat:

- 96.9% e ndërmarrjeve janë me pronësi shqiptare dhe vetëm 3.1% e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe/ose të përbashkët me shqiptarë.
- 89% e ndërmarrjeve kanë 1 deri në 4 të punësuar, 5.3% kanë 5 deri në 9 të punësuar dhe 5.7% kanë më shumë se 10 të punësuar.
- Vetëm 28.9% e ndërmarrjeve administrohen nga gra, çka tregon një pjesëmarrje ende të kufizuar të femrave në drejtimin e aktiviteteve ekonomike.
- 81.1% e ndërmarrjeve janë regjistruar si persona fizikë, ndërsa vetëm 18.9% si persona juridikë (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar – SHPK ose shoqëri aksionare – SHA).

Këto të dhëna pasqyrojnë një strukturë ekonomike të mbështetur kryesisht në ndërmarrje të vogla dhe biznese familjare. Dominimi i ndërmarrjeve me pak të punësuar tregon për një ekonomi lokale të

fragmentuar, me kapacitete të kufizuara rritjeje dhe zhvillimi, ndërsa pjesëmarrja e ulët e grave dhe e investimeve të huaja evidenton nevojën për politika mbështetëse për diversifikimin e sipërmarrjeve në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje.

Grafiku 14- Ndërmarrje aktive Bashkia Lushnje 2010-2024




Burimi : INSTAT 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Gjatë viteve të fundit, Bashkia Lushnje ka përjetuar një rënie graduale të numrit të ndërmarrjeve aktive, duke reflektuar një klimë biznesi të papërshtatshme për mbështetjen e sipërmarrjes.

Ndërmarrjet aktive prodhuese të të mirave dhe shërbimeve përbëjnë një komponent kyç të strukturës ekonomike vendore, duke kontribuar në punësim dhe zhvillim ekonomik. Ndërmarrjet prodhuese të të mirave përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh, që nga përpunimi i produkteve bujqësore dhe agro-industriale, deri te prodhimi i materialeve ndërtimore, konfeksioneve dhe shërbimeve të ndryshme të mbështetura nga sektori privat. Sipas të dhënave të INSTAT, numri i ndërmarrjeve aktive prodhuese të të mirave, kanë shfaqur stabilitet. Një pjesë të konsiderueshme prej tyre, janë të pozicionuara në qytetin e lushnjes ose përgjatë akseve rrugore kryesore. Ndërsa, ndërmarrjet aktive prodhuese të shërbimeve që mbulojnë një gamë të gjerë aktivitetesh që përfshijnë tregtinë me pakicë dhe shumicë, transportin, riparimin e automjeteve, shërbimet profesionale dhe teknike, si dhe ato sociale dhe edukative, përqendrohen në zonat urbane të bashkisë. Këto ndërmarrje shërbimesh përfaqësojnë pjesën më të madhe të sipërmarrjeve në territor, duke ofruar mundësi punësimi dhe shërbime thelbësore për komunitetin.

Grafiku 15- Ndërmarrje aktive prodhuese e të mirave dhe shërbimeve 2010-2024




Grafiku 16- Ndërmarrje aktive sipas numrit të të punësuarve 2010-2024



Burimi : INSTAT 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Grafiku 17- Ndërmarrje aktive sipas regjistrimit 2010-2024




Burimi : INSTAT 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Pavaësisht një tendence pozitive të dy viteve të fundit, profili i bizneseve mbetet i përqendruar kryesisht te mikro-ndërmarrjet me 1 deri në 4 të punësuar, çka tregon një strukturë ekonomike të fragmentuar dhe të brishtë, pa potencial të mjaftueshëm për zgjerim apo krijim të vendeve të reja të punës. Për më tepër, pjesa

më e madhe e subjekteve janë persona fizikë, të cilët operojnë shpesh në mënyrë individuale ose familjare, me kufizime në burime, teknologji dhe aftësi menaxheriale.

Grafiku 18- Ndërmarrje aktive sipas gjinisë së administratorit 2010-2024



Burimi : INSTAT 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Ndërmarrjet vazhdojnë të dominohen nga administratorë burra, duke e bërë pjesëmarrjen e grave në drejtimin e bizneseve ende të kufizuar dhe të pabarabartë.

Rënia graduale e numrit të ndërmarrjeve aktive, numri ulët i punonjësve dhe fakti se shumica e këtyre bizneseve janë të regjistruar si person fizik, tregon një strukturë ekonomike të fragmentuar (ku mbizotëron vetëpunësimi dhe aktiviteti ekonomik familjar), pa potencial të mjaftueshëm për zgjerim dhe investim, apo krijim të vendeve të reja pune. Kjo situatë thekson nevojën për politika më të fokusuara në mbështetjen e sipërmarrjes, klimës së biznesit, krijimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshme të tyre dhe zhvillimit të tyre ekonomik.


Shpërndarja Territoriale e bizneseve

Ndërmarrjet aktive të Bashkisë Lushnje janë përqendruar kryesisht në zonat urbane, veçanërisht në qytetin e Lushnjes, i cili funksionon si qendra kryesore ekonomike dhe tregtare e bashkisë. Është pikërisht në qytetin e Lushnjes, që zhvillohet pjesa më e madhe e aktivitetit tregtar, shërbimeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Në zonat rurale, bizneset janë të përqendruara kryesisht në sektorin e bujqësisë, agro-përpunimit dhe shërbimeve të lidhura me aktivitetet bujqësore dhe blegtorale, me një prani më të ulët të sipërmarrjeve të organizuara. Ndërsa përgjatë akseve kryesore rrugore vërehen aktivitet tregtare dhe të industrisë së lehtë. Zonat rurale periferike, kanë një akses të kufizuar në aktivitet ekonomik të qëndrueshëm, duke reflektuar nevojën për politika nxitëse dhe investime për të balancuar zhvillimin ekonomik në të gjithë territorin e bashkisë.

Figura 8- Shpërndarja Territoriale e bizneseve aktive sipas njësisë administrative




Grafiku 19- Bizneset aktive sipas Njësisë Administrative të Bashkisë Lushnje 2024



Fermerët

Në vitet e fundit është vërejtur një rritje e ndjeshme e numrit të fermerëve të regjistruar në Bashkinë Lushnje, çka dëshmon për një ndërgjegjësim në rritje të aktorëve lokalë për rëndësinë e formalizimit të aktivitetit bujqësor. Kjo tendencë është nxitur nga nevoja për të përfituar nga programet mbështetëse financiare të qeverisë dhe donatorëve, si dhe për të pasur akses në tregje më të strukturuara, në skema sigurimesh bujqësore dhe në kredi për zhvillimin e fermave.

Grafiku 20- Fermerët e regjistruar në Bashkinë Lushnje 2014-2024



Burimi : INSTAT 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Rritja e regjistrimeve ka kontribuar gjithashtu në përmirësimin e statistikave zyrtare mbi aktivitetin bujqësor, duke i dhënë bashkisë mundësi më të mira për planifikim dhe orientim të politikave zhvillimore.

Megjithatë, sfida të tilla si mungesa e informacionit, burokracitë në procesin e regjistrimit dhe përmasat e vogla të fermave mbeten pengesa për një formalizim më të plotë dhe të qëndrueshëm të këtij sektori jetik për ekonominë lokale.

Fakti që në Bashkinë Lushnje ka rreth 10,905 fermerë të regjistruar tregon qartë se struktura ekonomike e bashkisë është mbështetur fuqimisht në bujqësi dhe vetëpunësim në sektorin rural. Bujqësia përbën bazën kryesore të jetesës për pjesën më të madhe të popullsisë rurale, por ky numër i lartë fermerësh tregon se aktiviteti bujqësor është tepër i fragmentuar. Shumica e fermerëve operojnë në mënyrë individuale dhe në ferma të vogla, pa organizim në forma kolektive si kooperativa apo grupe prodhuesish, çka i pengon të negociojnë çmime më të mira apo të hyjnë në kontrata afatgjata. Mungesa e infrastrukturës së grumbullimit dhe përpunimit, çrregullimet në zinxhirin e furnizimit, dhe varësia nga ndërmjetësit, shpesh ulin fitimet dhe rrisin pasigurinë ekonomike të fermerëve. Për më tepër, shumë prej fermerëve nuk kanë akses në informacion mbi kërkesën e tregut, standardet cilësore apo mënyrat moderne të promovimit, duke i lënë jashtë mundësive të eksportit apo shitjes në tregjet urbane. Kjo situatë pengon zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe kufizon potencialin real të sektorit në rritjen e mirëqenies lokale.

<u>Konsiderata dhe rekomandime lidhur me aktivitetin ekonomik</u>

Bashkia Lushnje ka një bazë të fortë bujqësore, me një numër tejet të lartë fermerësh (që përfaqësojnë 10,3%[10] të totalit të fermerëve aktivë të pajisur me NIPT në nivel kombëtar). Ndërsa, shumica e ndërmarrjeve aktive janë kryesisht të vogla dhe të mesme, të fokusuara në shërbime. Ndërsa ndërmarrjet prodhuese te të mirave, përfaqësojnë ende një numër të vogël dhe janë kryesisht të orientuara në përpunim dhe tregtim të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Aktiviteti ekonomik dominohet nga ekonomia familjare dhe fermave të vogla, që operojnë në mënyrë individuale ose si ekonomi familjare, me një numër relativisht të ulët punonjësish.

Fakti se vërehen kryesisht struktura të vogla, tregon se sektori bujqësor shfaq një mungese të strukturimit në shoqatat dhe kooperativat, duke treguar kështu fuqinë negociuese të kufizuar, të fermerëve dhe ndërmarrjeve të vogla.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Mbështetja për nxitjen e organizimit të fermerëve dhe ndërmarrjeve të vogla (krijimin e kooperativave bujqësore, grupeve/ njësive të përbashkëta të përpunimit, ambalazhimi, magazinimi etj.).

- Forcimi i rolit të shoqatave dhe dhomave lokale të tregtisë për të ndihmuar fermerët me shërbime teknike, ligjore dhe të tregut.

- Mbështetje financiare për fermat dhe ndërmarrjet që modernizojnë aktivitetin e tyre, diversifikojnë aktivitetin e tyre në agro-turizmit, zhvillojnë produktet artizanale të traditës lokale, etj.

- Mbështetje me konsulencës teknike falas ose me kosto të ulët, veçanërisht për teknologji, mekanikë bujqësore dhe certifikime.

[10] Regjistrat e Biznesit Instat 2024


II.5.2. Sektori bujqësor

Fermerët e regjistruar në Bashkinë Lushnje përfaqësojnë 10,3%[11] të totalit të fermerëve aktivë të pajisur me NIPT në nivel kombëtar. Kjo e rendit bashkinë në krye të listës, për nga pesha e saj në sektorin bujqësor formal. Shkalla e lartë e formatizimit, është një tregues pozitiv mbi potencialit për modernizimin e prodhimit, rritjes së sigurisë ushqimore dhe përfshirjes më të gjerë të fermerëve në zinxhirin e vlerës bujqësore.

Mekanizimi Bujqësor

Numri i mjeteve mekanike bujqësore në Bashkinë Lushnje ka shfaqur një tendencë pozitive përgjatë viteve të fundit, duke reflektuar modernizimin gradual të bujqësisë dhe rritjen e produktivitetit dhe eficiencës së punës bujqësore. Megjithatë, kjo rritje ka ardhur duke u ngadalësuar, për shkak se në tre vitet e fundit vërehet një stagnacion, që mund të lidhet me kostot e larta të investimeve në makineri të reja, mungesën e subvencioneve të mjaftueshme, apo pengesat në aksesin në financime për fermerët e vegjël. Pavarësisht këtij ngërçi të përkohshëm, baza ekzistuese e mjeteve mekanike mbetet e rëndësishme për të mbështetur prodhimin bujqësor.


Grafiku 21- Numri i mjeteve të mekanikës bujqësore në Bashkisë Lushnje 2019-2024



Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

[11] Regjistrat e Biznesit Instat 2024

Grafiku 22- Numri i mjeteve të mekanikës bujqësore sipas llojit në Bashkinë Lushnje 2019-2024





Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Prodhimi bujqësor

Sipërfaqja e bimëve të kultivuara në ara në Bashkinë Lushnje është një tregues thelbësore i aktivitetit bujqësor dhe i përdorimit të tokës bujqësore për prodhim. Te dhënat e Ministrisë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, tregojnë se sipërfaqet e përdoruar për drithërat dhe për foragjeret shfaqin tendenca ne rënie, ndërsa kultivimi i perimeve në fusha shfaq një tendence pozitive gjate 5 viteve të fundit. Më tej vërehet se kultivimi i patates dhe luledielli kanë pasur një rritje të konsiderueshme në 2024. Këto dinamika, reflektojnë ndryshimet në strukturën e përdorimit të tokës dhe orientimin e fermerëve drejt kulturave më fitimprurëse. Nëse fokusohemi tek rendimenti i prodhimit të drithërave dhe perimeve, ajo që bie më shumë në sy është rënia theksuar e prodhimit, çka tregon për një ulje të rendimentit mesatar për hektar. Kjo situatë mund të lidhet me disa faktorë, përfshirë mungesën e inputeve cilësore bujqësore, përdorimin e teknikave të vjetruara të punimit të tokës, kushtet klimatike gjithnjë e më të paqëndrueshme si dhe mungesën e investimeve në teknologji moderne.


Grafiku 23- Sipërfaqja e drithërave, perimeve dhe foragjereve në arë 2018-2024 (në Hektar)[12]










Grafiku 24- Prodhimi i drithërave, perimeve dhe foragjereve në arë 2019-2024 (në TON)[13]









Grafiku 25- Rendimenti i drithërave, perimeve dhe foragjereve në arë 2019-2024 (në TON)








[12] Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)
[13] Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Në bashkinë Lushnje, sipërfaqja e dedikuar për prodhimin e perimeve në sera ka shfaqur qëndrueshmëri. Prodhimi intensiv në sera, ndonëse rrit ndjeshëm rendimentin dhe e zgjat sezonin e prodhimit bujqësor, sjell një sërë efektesh negative, veçanërisht kur nuk shoqërohet me praktika të qëndrueshme. Një nga shqetësimet kryesore është përdorimi i tepërt i pesticideve dhe plehrave kimike, që ndotin tokën, ujin dhe ajrin, dhe mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e produkteve bujqësore. Gjithashtu, shfrytëzimi intensiv i burimeve ujore për ujitje, sidomos në mungesë të sistemeve efikase, çon në uljen e rezervave ujore dhe degradimin e ekosistemeve lokale. Për më tepër, mungesa e rotacionit të kulturave dhe e pushimit të tokës shkakton varfërim të elementëve ushqyes, rritje të sëmundjeve dhe nevojë për më shumë ndërhyrje kimike, duke krijuar një cikël të pashëndetshëm për tokën dhe prodhimin. Në këtë kontekst, është e nevojshme që të promovohen praktika bujqësore të qëndrueshme. Ndërsa, ajo që shfaqet më dinamike është rritja e sipërfaqes së perimeve të mbjella në fusha, një tregues i kthimit të vëmendjes drejt prodhimit në natyrë për shkak të kostove më të ulëta, kërkesës së lartë të tregjeve të brendshme dhe të huaja, dhe përmirësimit të ndërlidhjes se prodhuesve me tregun.

Grafiku 26- Sipërfaqja e tokës e përdorur për prodhimin e perimeve në fusha dhe serra 2019-2024



Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Grafiku 27- Prodhimi i perimeve në fusha dhe serra 2019-2024



Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)


Ndër prodhimet bujqësore në fusha dhe sera, është grupi i bostanoreve dhe perimeve të njoma ai që njeh rritjen më të lartë si në sipërfaqe të mbjella ashtu edhe në sasi prodhimi. Janë pikërisht perimet e njoma dhe bostanoret të kultivuara në fushë, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqeve të mbjella dhe të sasisë totale të prodhimit. Klima e favorshme, toka pjellore dhe përvoja shumëvjeçare e fermerëve në kultivimin e këtyre kulturave kanë krijuar kushte optimale për zhvillimin e tyre në natyrë.

Grafiku 28- Prodhimi i perimeve në fusha dhe serra, sipas llojit 2019-2024




Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Grafiku 29- Prodhimi i perimeve të njoma në fusha dhe serra sipas llojit 2019-2024



Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Grafiku 30- Prodhimi i bostanore në fusha dhe serra sipas llojit 2019-2024




Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Pemë frutore

Pavarësisht se prodhimi i pemëve frutore në Bashkinë Lushnje ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në vitet e fundit, sipërfaqja totale e pemëve frutore ashtu edhe sipërfaqja në prodhim vijojnë të jenë në rënie. Rënia e sipërfaqes së pemëve frutore lidhet kryesisht me tkurrjen e sipërfaqeve të mbjella me vreshta, të cilat kanë pësuar një reduktim të ndjeshëm vitet e fundit. Ndërsa, sipërfaqet me agrume dhe ullinj kanë treguar një qëndrueshmëri relative ose një rritje të lehtë, duke reflektuar një interes më të madh të fermerëve për këto kultura që kërkojnë më pak mirëmbajtje dhe kanë një cikël prodhimi më të gjatë (ref. Aneksi Peme Frutore).Vlen te theksohet se vërehet një shfrytëzim gjithnjë e me i lartë i sipërfaqeve të mbjella me agrume,


duke reflektuar një interes më të madh të fermerëve për këto kultura që kërkojnë më pak mirëmbajtje dhe kanë një cikël prodhimi më të gjatë.

Grafiku 31- Prodhimi peme frutor Bashkia Lushnje 2019-2024



Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Grafiku 32- Sipërfaqe peme frutor gjithsej dhe në prodhim Bashkia Lushnje 2019-2024




Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

[Blegtoria]

Në Bashkinë Lushnje, sipërfaqja e arave e dedikuar për kultivimin e foragjereve ka njohur një rënie të shpejtë vitet e fundit, duke reflektuar një tendencë të qartë të braktisjes së kësaj kulture nga fermerët. Kjo rënie e prodhimit të përgjithshëm të foragjereve, shpjegohet me renien numrit të përgjithshëm i krerëve. Një nga fenomenet më shqetësuese që karakterizon sektorin bujqësor në Bashkinë Lushnje është rënia progresive e numrit të krerëve të gjësë së gjallë, duke reflektuar kështu një tkurrje të ndjeshme të sektorit blegtoral. Ky fenomen është veçanërisht i dukshme tek shpendët, por vërehet gjithashtu edhe tek specie të tjera blegtorale, me përjashtim të bletarisë, e cila përbën një nga sektorët e rrallë në rritje. Shkaqet që qëndrojnë në themel të kësaj rënieje janë të shumëfishta dhe të ndërlidhura. Së pari, rendimenti i ulët dhe

produktiviteti modest, e bëjnë blegtorinë e zonës jo konkurruese dhe pak fitimprurëse. Së dyti, përdorimi i teknikave tradicionale në prodhim dhe mungesa e pajisjeve moderne për përpunim, e kufizojnë ndjeshëm cilësinë dhe sasinë e produkteve blegtorale. Së treti, kostoja e lartë e inputeve – si ushqimi për kafshët, vaksinat, shërbimet veterinare – përballë të ardhurave të paqëndrueshme, e bën sektorin ekonomikisht të paqëndrueshëm për fermerët. Mungesa e tregjeve të organizuara dhe çmimet e paqëndrueshme, shtojnë pasigurinë për investim afatgjatë në këtë sektor. Së fundmi, mungesa e shërbimit këshillimor teknik, i lë fermerët pa mundësi për të përmirësuar praktikat menaxheriale dhe për të adoptuar teknologji të reja, duke e thelluar më tej krizën në blegtori.

Grafiku 33- Numri i krerëve Bashkia Lushnje 2019-2024



Burimi : MBZHR 2025 (përpunuar nga Qendra ALTRI)

Një ndër fenomenet me problematike që vërehet në sektorin bujqësor të Bashkisë Lushnje, është rënia e numrit të krerëve të gjësë së gjallë, që shfaq se sektori blegtoral është në rënie. Kjo rënie e justifikuar për sa i përket shpendëve, haset dhe për speciet e tjera (përjashtim bëjnë koshere bletësh). Kjo rënie, rrjedh për shkaqe të ndryshme si: produktiviteti dhe rendimenti i ulët, mungesa e teknikave dhe teknologjisë së prodhimit dhe përpunimit bashkëkohor, kosto e lartë e inputeve, mungesa e tregjeve të sigurta dhe çmimet të qëndrueshme, mungesë e njohurive dhe këshillimit teknik, etj.

<u>Konsiderata dhe rekomandime lidhur me sektorin bujqësor.</u>

Tokat që më parë mbilleshin me drithëra, po përdoren gjithnjë e më shumë për kultura me cikël të shkurtër dhe fitim më të lartë. (si perimet dhe pemët frutore). Rritja e prodhimit të perimeve në fusha shfaq tendencë pozitive që reflekton specializimin rajonal të zonës në perime, ku Lushnja ka përparësi konkurruese: klimën e favorshme, traditën, tregjet etj.

Pemët frutore, si agrumet dhe ullinjtë, shfaqin një shfrytëzim më të lartë, çfarë pasqyron një kërkesë më të qëndrueshme në treg. Ndërsa vreshtaria njeh një rënie të konsiderueshme duke çfarë pasqyron mungesën e tregjeve të sigurta dhe vështirësive në përpunim.

Mekanizimi mbetet në stagnacion dhe me një nivel modernizimi modest, por baza e mjeteve mekanike është relativisht e mjaftueshme për të mbështetur prodhimin bujqësor në përgjithësi. Mungesa e bashkëpunimit mes fermerëve për përdorimin e përbashkët të pajisjeve, është një fenomen i përgjithshëm që pengon reduktimin e kostove të prodhimit.

Sektori blegtoral në Bashkinë Lushnje po përjeton një rënie të ndjeshme, e reflektuar në uljen e numrit të krerëve të gjësë së gjallë, me përjashtim të bletarisë që paraqet rritje. Kjo rënie vjen si pasojë e një sërë faktorësh: rendiment i ulët, mungesë e teknologjisë bashkëkohore, kosto të larta prodhimi, mungesë tregjesh të sigurta dhe çmime të paqëndrueshme, mungesa e mbështetjes teknike etj.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Mbështetje për zhvillimin e fermave të specializuara në kultura me vlerë të lartë;
- Mbështetje për modernizim dhe mekanizimin bujqësor.
- Mbështetje për krijimin e strukturave të bashkëpunimit fermer për pajisje të përbashkëta (si kooperativave);
- Mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve për ruajtje dhe përpunim e produkteve bujqësore;
- Mbështetje për rimëkëmbjeb e sektorit blegtoral;
- Mbështetje për zhvillimi i zinxhirit të tregtimit dhe eksporteve;

II.5.3. Sektorët me potencial zhvillimi

Industria

Pozicioni gjeografik i favorshme (afërsia me aksin kombëtar Tiranë–Vlorë) dhe asetet territor të bashkisë Lushnje, ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e sektorit industrial. Por pavarësisht avantazheve, fakti se kjo bashkia ka qënë historikisht një qendër bujqësore me rëndësi kombëtare, zhvillimi industrial në këtë territor ka qenë tradicionalisht i lidhur ngushtë me sektorin bujqësor. Bashkia Lushnje shfaq një sektor industrial të limituar në aktivitetet kryesore, si:

- Industria Agro-ushqimore, në përpunimin e prodhimeve bujqësore.
- Industri të lehta, në përpunimin e plastikës, ndërtimin e pajisjeve metalike dhe prodhimin e mobilieve në shkallë të vogël dhe të mesme.
- Punishte artizanale dhe fason., në prodhimin artizanal tekstile, përpunim druri, etj.

Këto aktivitete shfaqin kapacitetet të kufizuara teknologjike dhe konkurrues, për shkak se shpesh herë mbështeten në teknologji dhe teknika të tejkaluar, me efikasitet dhe rendimet të ulët. Qasja e kufizuar në financa dhe faktit se shumë sipërmarrje industriale kanë vështirësi për të siguruar kredi apo fonde për zgjerim dhe modernizim, përbën një nder frenat kryesorë të zhvillimit industrial të zonës.

Pozicioni dominues në sektorin bujqësor, vendos theksin mbi nevojën e forcimit të zinxhirit agro-ushqimor. Krijimi dhe zhvillimi i një zinxhiri të mbyllur (nga ferma - përpunim - paketim - tregtim – eksport) dhe nxitja e bashkëpunimit midis të fermerëve dhe përpunuesve industrialë, renditen si një domosdoshmëri në zhvillimin e sektorit industrial dhe mbështetjes të sektorit bujqësor në një plan afatgjatë. Gjithashtu, pozicioni gjeografik, përbën një avantazh konkret për zhvillimin e industrisë se lehtë dhe në fusha të tjera nga bujqësia.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me sektorin industrial:

Bashkia Lushnje ka një pozicion gjeografik strategjik dhe kushte territoriale të favorshme për zhvillimin industrial. Megjithatë, zhvillimi i industrisë është historikisht i lidhur me sektorin bujqësor dhe përqendrohet te përpunimi agro-ushqimor, industrinë e lehtë dhe punishtet artizanale, shpesh me teknologji

të vjetëruar, rendimente të ulëta dhe mungesë konkurrueshmërie. Për të fuqizuar sektorin industrial dhe për të mbështetur bujqësinë në një plan afatgjatë, është e domosdoshme përforcimi i zinxhirit të integruar (fermë-përpunim-paketim-tregtim-eksport) dhe nxitja e bashkëpunimit mes fermerëve dhe përpunuesve lokalë. Pozicioni gjeografik mbetet avantazh konkret për zgjerimin në industrinë e lehtë dhe sektorë të tjerë ekonomike.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Zhvillojë një zonë industriale agrou-shqimore të mirëstrukturuar, moderne dhe të integruar, për të tërhequr kompani të mëdha përpunuese.

- Mbështetje financiar dhe teknike për përmirësimin teknologjik dhe certifikimin e produkteve, me qellim zhvillimin e eksporteve.

- Ndërmjetësim dhe lehtësim në financime dhe grante, përmes bashkëpunimit me donatorë dhe institucione financiare.

- Promovimi i partneriteteve publike-private për zhvillimin e industrive me bazë bujqësore etj.

Sektori I Turizmit

Sektori i turizmit në Bashkinë Lushnje përbën një potencial ende të pashfrytëzuar plotësisht. Territori ofron një kombinim të veçantë të pasurive natyrore, historike, kulturore dhe bujqësore. Në territorin e bashkisë Lushnje ndodhen 9 monumente kulturore të kategorisë së parë dhe 6 monumente te natyrës. Në shumë raste, pasuritë kulturore dhe mjedisore mbeten të pamirëmbajtura dhe të paidentifikuara.

Monumentet e kulturës në Bashkinë Lushnje përfaqësojnë një trashëgimi të çmuar historike dhe kulturore që luan një rol të rëndësishëm në identitetin e komunitetit lokal. Objekte të tilla si Manastiri Ardenicës, Kisha e Shën Kollit në Krutje, Kisha e Shën Mërisë në Bishqethëm, Kisha e Shën Todrit në Arrëz, dhe Kisha e Shën Kollit në Toshkëz, Shtëpia muze e Kongresit të Lushnjes, ura e Karbunarë dhe Kasharaj janë dëshmi të historisë së pasur të zonës. Restaurimi dhe promovimi i këtyre monumenteve, do të shërbente si një katalizator në tërheqjen e vizitorë vendas dhe të huaj në territorin e bashkisë Lushnje, dhe në gjenerimin e të ardhurave për komunitetin përmes hapjes së bizneseve të vogla, artizanatit lokal, bujtinave dhe guidave turistike, duke përforcuar ekonominë lokale dhe promovuar ruajtjen e vlerave historike.

Figura 9. Monumente kulture






Figura 10. Monumente të natyrës



Prania e fermave tradicionale, prodhimeve bujqësore cilësore, mikpritjes e komunitetit rural dhe peizazhi bujqësor i Myzeqesë, mbeten ende të pashfrytëzuara për nga pikëpamja turistike. Këto vlera lokale, mund të shndërrohen në atraksione të qëndrueshme për agro-turizmit dhe turizmit rural.

Pavarësisht këtij potenciali, turizmi në Lushnje përballet me sfida strukturore, si mungesa e infrastrukturave akomoduese, mungesa e qendrave/pika informacioni turistik, mungesa e identifikimit të monumenteve, Mungesa e informacionit dhe promovimit të destinacioneve etj.

Figura 11. Harta turistike Bashkia Lushnje



Konsiderata dhe rekomandime lidhur me Sektorin turistik:

Në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit bashkia mund te ndërmarri hapa të ndryshëm si:

- Investime në infrastrukturën turistike bazë, si: sinjalistika, rrugë lidhëse për në zona me interes turistik, pika informacioni turistik, etj.
- Krijimi i itinerareve turistike tematik të organizuara (itinerar kulturor, çiklizëm, ecje në natyrorë etj.)
- Inkurajim i investimeve në strukturave akomoduese si bujtina, në mbështetje të zhvillimit të turizmit rural.
- Restaurim dhe mirëmbajtje e monumenteve kulturore dhe të natyrës, për te zhvilluar atraktivitetin turistik.
- Integrimin i shërbimeve dhe produkteve turistike në destinacionet turistike.
- Bashkëpunim me bashki fqinje për krijimin e paketave turistike rajonale.
- Promovimi e destinacioneve, etj.

II.5.4. Tregu i punës dhe punësimi

Analiza demografike për Bashkinë Lushnje tregon një tendencë shqetësuese drejt plakjes së popullsisë dhe rënies së grup-moshës aktive 15-64 vjeç, e cila përbën bazën e fuqisë punëtore. Ky grup-moshë është në rënie të vazhdueshme dhe pritet të vijojë kështu edhe në dekadën e ardhshme, duke ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik, mbulimin e skemave sociale e pensioneve dhe duke rritur barrën mbi punonjësit aktivë. Ndërkohë, rënia e lindshmërisë dhe grup-moshës 0-14 vjeç sinjalizon një mungesë të ardhshme të brezit të ri të punës, duke thelluar më tej mungesën e fuqisë punëtore në të ardhmen.

Bujqësia renditet si sektori kryesor i punësimit me rreth 10905 fermer të regjistruar[14]. Roli i këtij sektori është dhe me i rëndësishëm, për shkak se ky sektor vuan ende nga informaliteti dhe puna e pa deklaruar në aktivitetin bujqësor familjar.

Sektori publik (administratë, arsim, shëndetësi) është një ndër sektorët e qëndrueshëm të punësimi, por me që shfaq mundësi të kufizuara për rritje.

[14] Instat 2025

Industria e lehtë dhe agro-përpunimi janë sektorë me potencial për rritje, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në tregun e punës në vitet e ardhshme, nëse paraprihet nga politika që përmirësojnë në mënyrë të integrua: klimën e biznesit, mundësitë e financimit, formimin e forcës punëtore, etj.

Shërbimet përbejnë një sektor të rëndësishëm në tregun e punës, që shfaq tendenca të qëndrueshme dhe një potencial zhvillimi të lartë në një plan afatgjatë. Turizmi, renditet nja nder levat e zhvillimit te tregut te punës në sektorin shërbimeve.

Pavarësisht se papunësia mbetet ende problematike (kryesisht tek të rinjtë dhe gratë), bizneset raportojnë mungesë të punonjësve të kualifikuar, dhe/ose kanë formim teorike me pak aplikim praktik. Në këtë kontekst, vërehet se ka një mospërputhje mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës. Programet kombëtare të nxitjes së punësimit janë të pranishme, por ndikimi i tyre është i kufizuar, për shkak se nuk përputhen me kerkesat specifike të tregut të punës në nivel lokal. Në këtë kuadër, bashkia Lushnje ka një rol plotësues në mbështetje të formimit dhe zhvillimit të fuqisë punëtore.

Konsiderata dhe Rekomandime lidhur me tregun e punës

Analiza tregon se Bashkia Lushnje përballet me sfida serioze në tregun e punës, për shkak të plakjes së popullsisë dhe rënies së grup-moshës aktive, çka pritet të ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik dhe mbulimin e skemave sociale. Bujqësia mbetet sektori kryesor i punësimit. Ndërkohë, industria e lehtë, agropërpunimi dhe shërbimet, përfshirë turizmin, paraqesin potencial për rritje të qëndrueshme. Mospërputhja mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, si dhe mungesa e punonjësve të kualifikuar, nënvizon nevojën për politika vendore që mbështesin formimin profesional dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Zhvillimi i një Strategjie Lokale për Forcën e Punës dhe Kapitalin Njerëzor
- Zhvillimin e arsimit profesional në sektorët prioritar, në bashkëpunim me shkollat profesionale dhe sektorin privat.
- Mbështetje në intensifikimin e bashkëpunimit me Zyrën e Punës dhe biznesin lokal.
- Zhvillimi i qendrave multifunksionale që ofrojnë trajnime, këshillim për karrierën dhe ndërmjetësim pune për të rinjtë, gratë dhe grupet e margjinalizuara etj.
- Organizimi i panaireve të punës dhe trajnimeve të shkurtra në partneritet me bizneset lokale

II.6. Mjedisi dhe Qëndrueshmëria

II.6.1. Burimet natyrore dhe menaxhimi i tyre

Bashkia Lushnje gëzon një pasuri të konsiderueshme burimesh natyrore, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal, veçanërisht në bujqësi, blegtori dhe agro-industri. Ndër burimet më të rëndësishme janë toka bujqësore e pjellore e Myzeqesë, burimet ujore (lumenj, kanale ujitëse dhe burime nëntokësore), si dhe pjesë të kufizuara të sipërfaqeve pyjore dhe biodiversiteti lokal.

Megjithatë, menaxhimi i burimeve natyrore në këtë bashki përballet me sfida të shumta. Tokat bujqësore janë nën presion nga fragmentarizimi, erozioni, mungesa e investimeve në sisteme moderne vaditjeje dhe ndotja nga përdorimi i pakontrolluar i pesticideve dhe plehrave kimike. Burimet ujore përballen me problematika si humbjet në rrjetin e kanaleve, mungesa e mirëmbajtjes dhe ndotja nga aktivitetet bujqësore

dhe urbane. Po ashtu, pyjet dhe zonat natyrore janë të kufizuara dhe shpesh të ekspozuara ndaj prerjeve të paligjshme apo keqmenaxhimit.

Në këtë kontekst, menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në Bashkinë Lushnje kërkon një qasje të integruar dhe ndërsektoriale. Duhet përmirësuar planifikimi i përdorimit të tokës, investuar në sisteme moderne vaditjeje dhe kullimi, përforcuar masat për mbrojtjen e cilësisë së ujërave, si dhe nxitur praktika bujqësore të qëndrueshme. Gjithashtu, është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe të forcohen kapacitetet institucionale për monitorimin dhe zbatimin e politikave mjedisore.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me burimet natyrore

Bashkisë Lushnje gëzon burimet natyrore të konsiderueshme që përbëjnë një potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm, por kjo kërkon ndërhyrje dhe angazhim afatgjatë të mirë planifikuar, të të gjitha palëve të interesit.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Zhvillimi dhe përditësimi i një inventari të plotë të burimeve natyrore (tokë, ujë, pyje, biodiversitet).
- Mbështetje e praktikave të qëndrueshme bujqësore.
- Ndërhyrje në rehabilitimi i tokave të degraduara dhe mbrojtja nga erozioni.
- Investime në menaxhimin efikas të burimeve ujore dhe modernizimi i sistemit të ujitjes.
- Fushata ndërgjegjësimi të komuniteteve lokale në monitorimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore.
- Mbështetje në nxitjen e investimeve të gjelbra etj.

II.6.2. Menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Lushnje përbën një sfidë të rëndësishme mjedisore dhe institucionale, e cila ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve, në mjedis dhe në ruajtjen e ekosistemeve natyrore. Zgjerimi i aktivitetit bujqësor dhe industrial, si dhe rritja e konsumit, kanë sjellë një sasi në rritje të mbetjeve urbane dhe bujqësore, të cilat shpesh herë nuk trajtohen në mënyrë të duhur.

Aktualisht, shërbimi i pastrimit në qytetin e Lushnjes dhe në njësitë administrative ofrohet nga ndërmarrjet private, që përballen me vështirësi të shumta: mungesë kapacitetesh teknike, mjete të amortizuara, mungesë të stacione të përzgjedhjes dhe riciklimit të mbetjeve, etj. Gjithashtu vlen të theksohet se një pjesa më e madhe e mbetjeve të ngurta përfundon në vendgrumbullime të pakontrolluara. Një problem serioz paraqet edhe menaxhimi i mbetjeve bujqësore, përfshirë plasmaset bujqësore, mbetjet nga pesticidet dhe mbetjet organike, duke ndikuar negativisht në cilësinë e tokës, ajrit dhe ujërave.

Për të përmirësuar situatën, Bashkia Lushnje duhet të ndërmarrë një sërë masash strategjike dhe operacionale: hartimin e një plani të integruar për menaxhimin e mbetjeve, investime në infrastrukturë moderne për grumbullim, transport dhe trajtim, promovimin e ndarjes në burim dhe riciklimit, si dhe forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe shoqërinë civile. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve duhet të shoqërojnë çdo reformë, duke e kthyer menaxhimin e mbetjeve në një proces bashkëpunues dhe të qëndrueshëm.

Konsiderata dhe rekomandime lidhure me menaxhimin e mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Lushnje përballet me mungesa në infrastrukturën e nevojshme për trajtimin e mbetjeve urbane dhe bujqësore. Shërbimet ekzistuese përballen me mungesë kapacitetesh teknike, mjete të amortizuara dhe mungesë të sistemit të ndarjes dhe riciklimit, ndërkohë që mbetjet përfundojnë shpesh në vendgrumbullime të pakontrolluara. Situata rëndohet më tej nga menaxhimi i dobët i mbetjeve bujqësore dhe mungesa e politikave për mbetjet e rrezikshme.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Hartimi dhe zbatimi i një Plani Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- Investime në ndarjen në burim të mbetjeve dhe vendosja e sistemeve të riciklimit.
- Investime në infrastrukturë moderne për grumbullim, transport dhe trajtim të mbetjeve.
- Investime në trajtimi i veçantë i mbetjeve bujqësore dhe atyre të rrezikshme (pesticide, plastika bujqësore).
- Fushata sensibilizuese për qytetarët dhe bizneset për reduktimin e mbetjeve etj.


II.6.3. Energjia dhe eficenca energjetike

Energjia në Bashkinë Lushnje, mbështetet kryesisht në rrjetin kombëtar të energjisë elektrike për furnizimin e nevojave të banorëve, bizneseve dhe sektorit bujqësor. Infrastruktura energjetike në disa zona mbetet e amortizuar, me ndërprerje të shpeshta të furnizimit, çka ndikon negativisht në aktivitetin ekonomik dhe cilësinë e jetesës. Një sfidë e veçantë lidhet me kostot e larta të energjisë për fermerët dhe sipërmarrësit, veçanërisht në periudhat e thatësirës kur nevojiten më shumë burime për ujitje. Kjo pengon zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe ul konkurrueshmërinë e tij.

Nga ana tjetër, potenciali për zhvillimin e energjive të rinovueshme, mbetet ende i pashfrytëzuar, edhe pse territori shfaq kushte të mira për investime në këtë drejtim. Teritori i Bashkisë Lushnje gëzon një potencial të mirë për shfrytëzimin e energjisë diellore, falë niveleve relativisht të larta të rrezatimit djellor direkt, të cilat mesatarisht variojnë nga 1,500 deri në 1,700 kËh/m² në vit. Kjo e bën territorin e bashkisë të përshtatshëm për instalimin e panelet fotovoltaike ose sistemet diellore termike.

Bashkia Lushnje, me një ekonomi të mbështetur fuqishëm në sektorin bujqësor dhe blegtoral, ka një potencial të konsiderueshëm për prodhimin e **energjinë së rinovueshme nga biomasa**. Sasia e madhe e mbetjeve organike bujqësore, përfaqësojnë një burim të vlefshëm energjie që aktualisht është pjesërisht i pashfrytëzuar. Zhvillimi i një zinxhiri lokal për mbledhjen dhe përpunimin e biomasës mund të kontribuojë në reduktimin e ndotjes mjedisore dhe rritjen e vetë-mjaftueshmërisë energjetike.

Figura 12. Harta e rrezatimit djellor direkt (Global Solar Atlas)



Për të përmirësuar situatën, Bashkia Lushnje duhet të orientohet drejt një strategjie energjetike të qëndrueshme që përfshin: promovimin e eficiencës energjetike në ndërtesa publike dhe banesa; mbështetjen e investimeve në panele diellore për ndriçim publik dhe objektet bujqësore; krijimin e lehtësive për partneritete publike-private në energji të pastër; si dhe ngritjen e kapaciteteve për menaxhim lokal të energjisë.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me energjinë

Energjia në Bashkinë Lushnje mbështetet kryesisht në rrjetin kombëtar, dhe përballet me probleme infrastrukturore, që shoqërohen me ndërprerje të shpeshta që ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës dhe aktivitetin ekonomik. Kostot e larta të energjisë për fermerët, sidomos gjatë thatësirave, përbëjnë një pengesë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrueshmërinë e bujqësisë. Megjithëse bashkia ka potencial për energji të rinovueshme, ky burim mbetet ende i pashfrytëzuar.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Zhvillimi i një strategjie vendore për tranzicionin drejt energjisë së pastër
- Investime në rritjen e eficiencës energjetike në ndërtesa publike dhe ndriçimin rrugor.
- Investime në instalimin e paneleve diellore në objekte publike.
- Nxitja dhe mbështetja e përdorimit të burimeve të rinovueshme nga banoret, ndërmarrjet dhe fermerët (energjia diellore, biomasa, era).

II.6.4. Rreziqet natyrore dhe ndryshimet klimatike

Bashkia Lushnje, si gjithë vendet e tjera, është e ekspozuar ndaj disa rreziqeve natyrore, të cilat po intensifikohen si pasojë e ndryshimeve klimatike. Ndër rreziqet më të shpeshta dhe me ndikim janë përmbytjet, thatësirat, erozioni i tokës dhe valët e të nxehtit, fenomene këto që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë prodhimin e sektorit bujqësor.

Përmbytjet janë një nga kërcënimet më të mëdha për territorin e Lushnjes, për shkak të relievit të ulët, pranisë së lumenjve dhe kanaleve të shumta kulluese, si dhe gjendjes së amortizuar të infrastrukturës së kullimit dhe mbrojtjes nga ujërat. Përgjatë shtrati të lumit Seman, fenomeni i erozionit ka ndikuar në reduktimin e tokës, cfarë kërkon ndërhyrje në fortifikimin e brigjeve te lumit për të luftuar erozionin dhe riskun nga përmbytjet.

Nga ana tjetër, thatësirat e zgjatura, të cilat po bëhen më të shpeshta si rezultat i ndryshimeve klimatike, ndikojnë në uljen e rendimentit bujqësor dhe në rritjen e nevojës për burime ujore për vaditje. Kjo rrit presionin mbi sistemet ujitëse, shumë prej të cilave janë të vjetëruara dhe të amortizuara. Pavarësisht se janë kryer investime në mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse dhe vaditëse parësore dhe sekondare, ket investime janë të pa mjaftueshme. Mungesa, e mirmëmbajtjes se sistemit të kullimit dhe vaditjes, kontribuon në degradimin i tokës bujësore, për shkak të erozionit, ndotjes se toke nga përmbytjet dhe mbetjet e inputeve bujqësore etj. Përtej nevojës për rehabilitimin e sistemit vaditës dhe kullues, lind nevoja për adaptim ndaj ndryshimeve kliamtike. modernizuar teknikat a vaditjes dhe për të rritur eficiencën në menaxhimin e ujit.

Ndikimi i valëve të të nxehtit mbi shëndetin publik, sidomos te grupet më të ndjeshme, si të moshuarit dhe fëmijët, është gjithashtu një shqetësim në rritje. Ndryshimet klimatike po ndikojnë dhe në ndryshimin e cikleve të kulturave bujqësore, duke kërkuar përshtatje të praktikave tradicionale të kultivimit.

Ndotja e ajrit në Bashkinë Lushnje, ndonëse jo në nivelet e zonave të urbanizuara të mëdha, përbën një shqetësim në rritje për mjedisin dhe shëndetin publik, sidomos në zonat urbane dhe ato me intensitet të lartë bujqësor. Burimet kryesore të ndotjes përfshijnë trafikun urban, djegien e materialeve në mënyrë të pakontrolluar, përdorimin e lëndëve djegëse fosile për ngrohje, si dhe aktivitetet bujqësore intensive që çlirojnë në atmosferë gazra serë dhe grimca të dëmshme nga përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike. Mungesa e monitorimit të rregullt të cilësisë së ajrit dhe ndërgjegjësimi i ulët i komunitetit i përkeqësojnë këto efekte. Për të frenuar përkeqësimin e situatës, kërkohen masa të integruara si monitorimi i ndotjes, kontrolli i djegieve të pakontrolluara, promovimi i energjive të pastra dhe praktikave të qëndrueshme bujqësore.

Ndotja e burimeve ujore, është një fenomen që mund të ndikoj në mënyrë te konsiderushmë zhvillimne e qëndrueshëm të bashkisë lushnje. Në të vertetë, Lumi Seman shfaq një nivel ndotje të lartë me metale të renda, duke vendosur në rrezik prodhimin bujqësor dhe shëndetin publik. Për këtë arsye nevojitet një bashkëpunim i ngushte me bashkitë fqinje, me qëllim të reduktimit të ndotjes, dhe menaxhimit i integruar të basenit të lumin Seman. Gjithashtu, nevojitet një monitorim i vazhdueshëm i cilësisë se ujit të lumit Seman, me qëllim garantimin e cilësisë se ujit që do të përdoret për vaditje, dhe cilësisë se produkteve bujqësore që prodhohen ne territor.

Në Bashkinë Lushnje, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe rurale paraqet sfida të vazhdueshme, veçanërisht në lidhje me **venddepozitimet informale** dhe mungesën e infrastrukturës së duhur për trajtimin dhe diferencimine e mbetjeve. Në disa zona periferike dhe rurale, mbetjet vazhdojnë të depozitohen në mënyrë të pakontrolluar në natyrë, kanale vaditëse apo në toka të lira, duke ndotur mjedisin dhe duke krijuar rrezik për shëndetin publik. Këto venddepozitime të egra shpesh përmbajnë mbetje plastike, organike, mbetje bujqësore dhe ndonjëherë edhe materiale ndërtimi apo substanca potencialisht të rrezikshme. Për shkak të mungesës së ndarjes në burim dhe të një sistemi efikas riciklimi, pjesa më e madhe e mbetjeve përfundojnë të pa diferencuara dhe recikluara. Situata rëndohet nga mungesa e ndërgjegjësimit qytetar dhe kontrolleve të dobëta administrative. Përmirësimi i kësaj situate kërkon investime në infrastrukturë për grumbullim dhe riciklim, ristrukturim të shërbimit të pastrimit, dhe ndërgjegjësim komunitar për menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve.

Në territorin e Bashkisë Lushnje identifikohen disa vatra të nxehta mjedisore, të cilat përbëjnë rrezik serioz për mjedisin dhe shëndetin publik për shkak të ndotjes së akumuluar ndër vite dhe mungesës së rehabilitimit, si: Landfildi, Magazina e vjetër e pesticideve, Uzina e plasmasit Spitali i Lushnjese etj. Këto vatra kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për pastrim, izolim dhe rehabilitim, si dhe monitorim të vazhdueshëm për të parandaluar përkeqësimin e situatës dhe ekspozimin e popullsisë ndaj ndotësve të rrezikshëm.

Përballë këtyre sfidave, Bashkia Lushnje ka nevojë për një qasje të integruar të menaxhimit të rreziqeve natyrore dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin përmirësimin e infrastrukturës së kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, modernizimin e sistemit të ujitjes, promovimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe rezistente ndaj klimës, si dhe forcimin e sistemeve të vëzhgimit, paralajmërimit të hershëm dhe reagimit emergjent. Po ashtu, edukimi i komunitetit dhe përfshirja e tij në proceset e planifikimit dhe ndërhyrjes është thelbësor për të ndërtuar qëndrueshmëri afatgjatë.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me rreziqet natyrore dhe ndryshimet klimatike

Bashkia Lushnje është gjithnjë e më e ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore si përmbytjet, thatësirat, erozioni i tokës dhe valët e të nxehtit. Përmbytjet dhe thatësirat shkaktojnë dëme të mëdha në bujqësi dhe infrastrukturë për shkak të sistemit të amortizuar të kullimit dhe ujitjes, ndërsa valët e të nxehtit përbëjnë rrezik për shëndetin publik dhe produktivitetin bujqësor. Ndryshimet klimatike kërkojnë përshtatje të praktikave tradicionale, modernizimin e infrastrukturës, zbatimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme, ngritjen e sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe angazhimin aktiv të komunitetit në menaxhimin e rreziqeve dhe përshtatjen ndaj klimës.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Hartimi i një Plani Vendor të Menaxhimit të Rreziqeve dhe Përshtatjes ndaj Klimës.
- Zhvillimi i strukturave të monitorimi dhe paralajmërimi i hershëm për fenomene ekstreme natyrore.
- Zhvillimi i sistemeve të reciklimit të ujit të shiut;
- Investime në zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe pyllëzimi i zonave të ekspozuara ndaj erozonit.
- Trajnimi i stafit vendor dhe komunitetit për përgatitje ndaj emergjencave natyrore, etj.
- Mbështetje në investime ose politika për zhvillimin e sistemeve moderne të ujitjes, për rritje të eficiencës, kursim të ujit dhe ulje të kostove për fermerët.
- Fushata ndërgjegjësuese për përdorimin racional të ujit, ruajtjen e kanaleve dhe minimizimin e ndotjes nga mbetjet bujqësore dhe kimikatet.
- Investime në mirëmbajte dhe thellimi të sistemtit të kullimit për reduktimin e riskut nga përmbytjet (veçanërisht në zonat si Krutja, Fiershegani dhe Ballagati) etj.

II.7. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

II.7.1. Transporti dhe rrjeti rrugor

Bashkia Lushnje ka një përfshirje të drejtpërdrejtë në rrjetin rrugor kombëtar përmes Rrugës Kombëtare SH4, që përbën korridorin kryesor veri–jug të Shqipërisë. Kjo rrugë mundëson akses të mirë për mallrat dhe njerëzit, duke lidhur territorin e Bashkisë Lushnje me Tiranën, Fierin, Vlorën dhe më tej me portin e Durrësit e atë të Vlorës. Gjithashtu, Bashkia Lushnje gëzon një pozicion kyç për sa i përket flukseve turistike që vizitojnë vijën bregdetare jugore, Gjirokastrën dhe Beratin.

Rrjeti rrugor, brenda për brenda territorit të bashkisë, është relativisht i zhvilluar, por një pjesë e tij është në gjendje të amortizuar ose në mos përputhje me standardet.




Figura 13- Rrjeti Rrugor kryesor Bashkia Lushnje.

Problematikat e rrjetit rrugor vërehen kryesisht në zonat rurale ose në zonat periferike urbane, të cilat shoqërohen me mbingarkesë të qarkullimit.

Ndërlidhja e qendrës se bashkisë, me njësitë administrative kryhen përmes rrugëve dytësore të cilat edhe pse të asfaltuara në disa segmente, shpesh janë amortizuara, pa sinjalistikë dhe janë të papërshtatshme për të përballuar flukset e mjeteve dhe makinerive bujqësore (veçanërisht gjatë sezonit të vjeljes bujqësore, ku përdoren edhe mjete të rënda për transport mallrash bujqësore).

Ndërsa, rrugët sekondare në zonat urbane hasin mbingarkesë gjatë orëve të pikut. Mungesa e vendeve të parkimit, trafiku i paorganizuar, mungesa e infrastrukturës alternative përkeqësojnë cilësinë e jetesës dhe sigurinë rrugore.

Lëvizshmëria e qëndrueshme nuk është zhvilluar ende, për shkak se mungojnë korsitë e dedikuara për biçikletat, trotuaret e amortizuara dhe ndriçimi rrugor është shpesh i pamjaftueshëm në zonat periferike, çfarë përbën një pengesë të mëdha për përdorimin e mjeteve jo-motorike si alternativë ndaj makinave.

Siguria rrugore përballet me sfida të shumta, sidomos në segmentet që lidhin zonat rurale me qytetin dhe rrugët hyrëse nga aksi kombëtar, ku shënohen aksidente të shkaktuara nga tejkalimi i shpejtësisë, mungesa e ndriçimit dhe kushtet e këqija të rrugëve. Përmirësimi i sigurisë rrugore kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë, vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, trotuare dhe korsi të dedikuara për biçikleta dhe ngritjen e një sistemi modern monitorimi dhe menaxhimi të trafikut.

Transporti publik ndër-urban është i kufizuar drejtë qëndrave kryesore të vendit dhe kryesisht operon përmes automjeteve me kapacitet te ulët. Ndërsa, transporti publik urban është shumë i kufizuar, çka detyron qytetarët të përdorin automjete private. Përtej ndotjes dhe trafikun, kjo situatë është veçanërisht sfiduese për kategoritë e cenueshme, si të moshuarit, gratë dhe të rinjtë pa automjete private.

Sistemi hekurudhor, i cili ka shërbyer historikisht për transportin mallrave dhe pasagjerëve, sot është në gjendje te keqe dhe nuk ofron mundësinë e transportit të mallrave. Me zhvillimin e viteve të fundit, transporti hekurudhor, pritet të marri një rol gjithnjë e më të artë në transportit e njerëzve dhe të mallrave, duke vendosur theksin mbi nevojën për integrimin e transportit hekurudhor në planifikimin afatgjatë të terrorit dhe transporti.

Fakti se bashkia Lushnje ka një bazë të fortë bujqësore, lë të kuptohet nevojat për një sistem transporti dhe logjistike efikas, me qëllim fluidifikimin e flukseve bujqësore drejt tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Konsiderata dhe Rekomandime lidhur me Transportin dhe rrjetin rrugor

Infrastruktura rrugore në Bashkinë Lushnje përfshin një rrjet të rëndësishëm lidhës me rrugën kombëtare SH4, që e pozicionon atë si nyje kyçe në korridorin veri–jug të Shqipërisë dhe e lidh me qytete si Tirana, Fieri, Vlora dhe portet kryesore. Megjithëse rrjeti rrugor brenda bashkisë është relativisht i zhvilluar, ai përballet me sfida të mëdha, sidomos në zonat rurale dhe periferike, ku rrugët dytësore janë të amortizuara, pa sinjalistikë dhe të papërshtatshme për flukset mikse (automjete dhe mjeteve bujqësore). Qarkullimi urban karakterizohet nga mbingarkesë trafiku gjatë pikut, mungesë parkimi dhe infrastrukturë të dobët për këmbësorët e biçikletat, duke ndikuar negativisht në cilësinë e jetesës dhe sigurinë rrugore. Mungesa e një sistemi të zhvilluar të transportit publik urban dhe ndërurban përkeqëson aksesin e grupeve të cenueshme. Për më tepër, potenciali bujqësor i zonës kërkon një sistem modern transporti dhe logjistike për të lehtësuar lëvizjen e mallrave drejt tregjeve më të gjera.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Hartimi i një plani të integruar të mobilitetit (që përfshin transportin e automjeteve, transportin publik, biçikletat dhe ecjen)
- Investime në rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale dhe urbane periferike.
- Investime në zhvillimin e një rrjeti efikas të transportit publik urban.
- Investime në zhvillimi i infrastrukturës për biçikleta dhe këmbësorë.
- Investime ose mbështetje për zhvillimin pika logjistike të integruara për transportin e mallrave.
- Investime në sinjalistikë, ndriçimin dhe siguri.
- Mbeshtetje e Zhvillimit të transporti hekurudhor për njërëzit dhe mallrat.
- investiem lidhur me përmirësimine sigurisë në kryqëzime, mbikalime, etj.

II.7.2. Sistemin e Ujësjellës-Kanalizimeve

Pavarësisht, ndërhyrje për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve, sektori ende nuk garanton furnizimin e pandërprerë me ujë të pijshëm, njeh humbjet teknike në rrjet dhe shfaq një sistem kanalizimesh të amortizuar dhe me ndikim në ndotjen mjedisore.

Bashkia e lushnjes furnizohet kryesisht nga burime ujore nëntokësore. Qyteti i Lushnjes ka një rrjeti të centralizuar shpërndarjeje që mbulon qendrën dhe disa lagje kryesore, duke garantuar një furnizim relativisht të regullt me ujë. Por lagjet periferike të qytetit dhe sidomos zonat rurale vuajnë ende nga një furnizimi i pjesshëm, ku kohëzgjatja e furnizimit ditor është e kufizuar në disa orë. Amortizimi dhe lidhjet e paligjshme, kontribuojnë në humbje të konsiderueshme në rrjet, çfarë shkakton humbje ekonomike për ndërmarrjen e ujësjellësit, dhe cenon cilësinë e shërbimit për qytetarët. Në këte drejtim, nevojitet zgjerim i rrjeteve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat rurale, dhe riparime të rrjeteve ekzistuese të furnizimit me ujë të pijshëm në qytetin e Lushnjes.

Rrjeti i kanalizimeve është relativisht i zhvilluar në zonën urbane, por mungon në pjesën më të madhe të zonave rurale ose periferike. Në qytetin e Lushnjës, pjesa me e madhe e sistemi të kalanilizimeve është ndërtuar rreth viteve 70-80, duke shfaqur një amortizim të lartë dhe është një rrjet i kombinuar me atë te ujërave të reshjeve atmosferike. Ndërkohe , në zonat rurale, sistemet e mbledhjes dhe largimit të ujerave të zeza, janë pothuajse inekzistente. Mungesa e i kanalizimeve rezulton në shumë raste, në derdhjen e ujërave të zeza në kanale të hapura, vadina ose përzihen me ujërat e bardha, duke shkaktuar ndotje mjedisore dhe duke rritur rrezikun për shëndetin publik. Gjithashtu, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura është një tjetër boshllëk serioz, pasi ujërat e ndotura shpesh shkarkohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë në lumenj, duke ndikuar negativisht në mjedis dhe për rrjedhoje në burimeve ujore të zonës.

Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Lushnje përballet me mungesë kapacitetesh teknike, financiare dhe menaxheriale. Shkalla e arkëtimit të pagesave për ujë të pijshëm mbetet e ulët, gjë që kufizon mundësinë e investimeve të reja ose mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues. Për më tepër, bashkia nuk disponon ende një strategji afatmesme për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, përfshirë furnizimin, kanalizimet dhe ujërat e bardha. Kjo pengon planifikimin efektiv dhe të qëndrueshëm të investimeve, sidomos në zonat me rritje demografike apo zhvillim të shpejtë urban.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me sistemin e ujësjellës-kanalizime.

Sistemi i ujësjellës-kanalizimeve kërkon ndërhyrje dhe investime të shumta për të garantuar furnizim e qëndrueshëm me ujë të pijshëm, menaxhim të sigurt të ujërave të ndotura dhe reduktim të ndikimeve mjedisore.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Hartimi i një strategjie të integruar për menaxhimin e ujërave, ku përfshihen të gjitha komponentët e sistemit ujësjellës, kanalizime, ujëra të bardha etj.

- Rikonstruksioni dhe modernizimi i rrjetit të shpërndarjes së ujit për të reduktuar humbjet dhe për të garantuar furnizim 24/7.

- Investime në zhvillimin e rrjetit të kanalizimeve në zonat rurale dhe periferike.

- Investime në ndarjen e rrjeteve të ujërave të zeza dhe atyre të bardha.

- Ngritja e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (me prioritete për zonat urbane dhe ato me ndikim të lartë mjedisor)

II.7.3. Strehimi dhe hapësirat publike

Strehimi përbën një dimension thelbësor të zhvillimit urban dhe social të Bashkisë Lushnje, për shkak se ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së banorëve, ekonomisë lokale, shërbimeve publike dhe kohezionit social. Fondi i banesave në Bashkinë Lushnje përbëhet kryesisht nga ndërtesa të ndërtuara para viteve 90, ku në zonën urbane të qytetit, dominojnë ndërtesat kolektive të ndërtuara gjatë periudhës socialiste dhe më pas, ndërsa në zonat rurale mbizotërojnë shtëpitë individuale një ose dy katëshe. Fakti se fondi i banesave është relativisht i vjetër dhe që nuk arrin standarde bashkëkohore, se vërehet një degradim për shkak të mungesës së mirëmbajtjes (kryesisht në banesat kolektive kolektive), përball bashkinë me sfida të shumta lidhur me përmirësimin e standardeve, organizimin dhe mirëmbajtjes se fondit të banesave.

Pas viteve 90, territori i bashkisë Lushnje përjetoi një transformim të thellë, me një zhvillimit urban të pakontrolluar, duke rezultuar në një fond të gjerë ndërtimesh informale, veçanërisht në periferi të qytetit dhe në afërsi të tokave bujqësore. Këto ndërtesa informale, shpesh të ndërtuara në mungesë të infrastrukturës publike dhe akses të kufizuar në shërbimet bazë, kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm urban. Procesi i legalizimit të ndërtimeve informale ka sjellë disa përmirësime, por ende ka shumë objekte pa status ligjor, pasi shumë ndërtime janë ngritur në zona me rrezik përmbytjeje ose pa respektuar normat e ndërtimit antisizmik. Zhvillimi informal ka rezultuar gjithashtu dhe në një shpërndarja gjeografike e theksuar, çfarë ndikon negativisht në ofrimin e barabartë të shërbimeve publike.

Bashkia Lushnje si shumë bashki të vendit, përballet me një kërkesë të vazhdueshme për strehim të subvencionuar apo strehim social. Pavarësisht përpjekjeve për ndërtimin apo adaptimin e banesave sociale, kapacitetet aktuale janë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat. Gjithashtu, përfitimi nga skemat e bonusit të qirasë, ndërhyrjet në përmirësimin e banesave ekzistuese dhe politika të tjera mbështetëse janë të kufizuara për shkak të fondeve të pamjaftueshme.

Nga ana tjetër, rënia e popullsisë ndikon drejte për drejtë në kërkesën për strehim, ky në disa zona rurale vërehet një numër i konsiderueshëm banesash të pabanuara ose të përdorura pjesërisht. Kjo sjell një shpërdorim të fondit ekzistues të banesave dhe ul vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme në këto zona. Ndërsa në qytetin e Lushnjës vërehet një presion në rritje për ndërtimin e banesave të reja.

Dinamikat demografike të 10 vjetarit të fundit, fakti se PPV Bashkia Lushnjë është hartuar në vitet 2015 dhe rishikuar pjesërisht në vijim, shtyn drejtë një qasje më të integruar të planifikimit urban, zhvillimit të qëndrueshëm të territorit dhe harmonizimit me standardet evropiane.

Konsiderata dhe rekomandime lidhur me sistemin e ujësjellës kanalizime.

Me qëllim rritjen e cilësisë së jetës, kohezionit social, ekonomisë lokale, dhe shërbimeve publike të barabarta, Bashkia Lushnje përballet me nevojën për te rritur standardet e fondit të banesave, përmes proceseve të rikualifikimit urban dhe rivitalizimin e lagjeve.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Hartimi i një regjistri të detajuar të banesave, në të cilin përfshihen dhe standardet, eficenca energjetike, aksesi në shërbime publike etj.

- Analiza e kërkesës për strehim, në të cilin përfshihen analiza e kapacitetit mbajtës, metabolizmit territorial etj.

- Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor, duke integruar në plan dinamikat e viteve të fundit, standardet evropiane, etj.

- Krijimi i Politikave të integruara të strehimit, skemave të bonusit të qirasë, strehim social, legalizimin dhe përmirësimin e banesave informale etj.

II.8. Qeverisja Lokale dhe Kapacitetet Institucionale

II.8.1. Strukturat administrative

Administrata e Bashkisë Lushnje përbën strukturën teknike dhe ekzekutive që zbaton politikat vendore, menaxhon shërbimet publike dhe mbështet veprimtarinë e kryetarit të bashkisë dhe të këshillit bashkiak. Përbërja e administratës qendrore përfshin një aparat të organizuar në drejtori, sektorë të specializuara, që veprojnë si në selinë qendrore të bashkisë në qytetin e Lushnjës, ashtu edhe në njësitë administrative periferike.

Organika e administratës së Bashkisë Lushnje përbehet nga 276 punonjës, të organizuar në 4 drejtori funksionale:

- Drejtoria e përgjithshme e shërbimeve publike, zhvillimit urban dhe rural
- Drejtoria e përgjithshme e menaxhimit financiar dhe të ardhurat vendore
- Drejtoria e përgjithshme e integrimit, politikave sociale dhe informimit
- Drejtoria e përgjithshme e legjislacionit dhe Burimeve njerëzore;

Në organikën e administratës së Bashkisë Lushnje integrohen dhe:


- Drejtorinë e policisë bashkiake
- Inspektorati i mbrojtjes se territorit
- Administratoret e njësive administrative

Krahas Administratës se Bashkisë, regjistrohen dhe:

- MNZSH
- Qendra Kulturores
- Kinotearri “Vace Zela”

- Biblioteka e Qytetit
- Muzeu historik dhe shtëpia e Kongresit të Lushnjës
- Klubi Shumesporte

Figura 14- Organika Bashkia Lushnje.



Në total Bashkia Lushnje ka 1083 punonjës, ku një peshë të madhe zënë "Qendra e arsimit" dhe "Qendra e Kulturës dhe klubi Shumesport" me përkatësisht 405 dhe 301 punonjës.

Në planin e kapaciteteve njerëzore, administrata përbëhet nga një numër relativisht i lartë punonjës ishte shpërndarë në mënyrë të pabarabartë ndërmjet qendrës dhe njësive administrative. Qendra bashkiake ka ngarkesën më të madhe të stafit dhe funksioneve vendimmarrëse, ndërsa njësitë administrative, të drejtuara nga administratorë, operojnë me burime minimale njerëzore dhe logjistike, duke pasur kapacitete të kufizuara për ofrimin e shërbimeve pranë qytetarëve dhe për të kontribuar në parimin e demokracisë të përafruar. Për më tepër, mungesa e sistemeve digjitale të integruara për menaxhimin e informacionit dhe të dhënave administrative e bën më të vështirë ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të barabarta për qytetarët.

<u>Konsiderata dhe rekomandime lidhur me Strukturën administrative</u>

Struktura administrative e Bashkisë Lushnje, përbëhet nga një numër i lartë punonjësish, ku vërehet një centralizim i vendimmarrjes. Ristrukturimi funksional, përmirësimi i koordinimit të brendshëm dhe investimi në burime njerëzore dhe teknologji janë hapa të domosdoshëm për ta bërë këtë strukturë më efikase, më të hapur dhe më të orientuar drejt nevojave të komunitetit.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Ristrukturimi i administratës, ku përcaktohen qartë rolet, kompetencat dhe funksioni e strukturës, vlerësohet mundësia e përforcimit të rolit të administratës në njësitë vendor për t'i afruar shërbimet pranë qytetarëve etj.
- Rritja e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme, veçanërisht në fushat e IT-së, projektimit dhe monitorimit të politikave publike.
- Digjitalizimi i proceseve dhe krijimi i platformave të integruara për shërbime dhe menaxhim dokumentacioni.
- Zhvillimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe vlerësimit, bazuar në transparencë dhe llogaridhënie të administratës etj.

II.8.2. Financat lokale

Bashkitë në Shqipëri, financohen përmes katër burimeve kryesore :

- Të ardhurave të veta (Të ardhura nga taksat, Të ardhura nga tarifa etj.)
- Të ardhura nga asetet publike dhe borxhi vendor.
- Transferta nga qeveria qendrore (transferta e pakushtëzuar, Transfertat a pakushtezuara sektoriale, trasnfertat e kushtëzuar)
- Donacione dhe projekte të financuara nga organizata ndërkombëtare

Të ardhurat e Bashkisë Lushnje përbëhen nga një kombinim i burimeve vendore (të ardhura të veta vendore) dhe burimeve të jashtme (transferta nga buxheti i shtetit dhe donacione), por pjesa më e madhe e të ardhurave rrjedh nga transfertat e pakushtëzuara qendrore, duke reflektuar një varësi të lartë nga financimet qendrore. Të ardhurat e veta vendore (që përfshijnë taksat, tarifat, qiratë dhe të ardhura nga menaxhimi i pronës publike dhe tarifat), zënë një peshë relativisht të vogël në totalin e buxhetit. Arkëtimi i të ardhurave vendore, mbetet një sfidë për bashkinë Lushnje, parregullsisë në pagesat e taksave dhe tarifave vendore nga banoret por dhe mungesa e një sistemi efikas për ndjekjen e debitorëve. Të ardhurat nga pronat dhe qeraja janë relativisht të ulta dhe shfaqin paqëndrueshmëri, çfarë nënkupton një mungesë efikasiteti në menaxhimin e tyre. Nga ana tjetër, donacionet dhe financimet e huaja përbëjnë një mundësi për rritjen e të ardhurave dhe realizimin e projekteve zhvillimore, megjithatë aftësia e bashkisë për të konkurruar për fonde ndërkombëtare është e kufizuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore t dedikuara dhe një stafi të specializuar në hartimin dhe menaxhimin e projekteve.

Shpenzimet e Bashkisë Lushnje ndahen në tre kategori kryesore: shpenzime kapitale, shpenzime korrente dhe borxhi vendor. Shpenzimet korrente, zënë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit dhe përfshijnë pagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore të administratës, kostot e shërbimeve sociale, mirëmbajtjen e infrastrukturës, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve. Ndërsa nga ana tjetër, shpenzimet kapitale që përfshijnë investimet publike si ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugëve, kanalizimeve, ndriçimit dhe objekteve arsimore, mbeten të kufizuara për shkak të mungesës së kapacitetit vet-financues, mungesës së bashkëfinancimeve apo kapacitetit të përthithjes së burimeve alternative të financimit.

Konsideruar të ardhurat e veta dhe shpenzimet, vlerësohet se Bashkia Lushnje ka një nivel të ulët autonomia, për nga pikëpamja financiare. Vlerat e larta të shpenzimeve, kufizojnë ndjeshëm investime të reja dhe ndërhyrjet strategjike. Në këtë kontekst, përmirësimi i performancës financiare në gjenerimin e fondeve të veta dhe racionalizimi shpenzimeve janë thelbësore për një zhvillim strategjik të qëndrueshëm.

Për sa i përket borxhit vendor, Bashkia Lushnje ka filluar rishtazi të shfrytëzoje instrumentet e kredimarrjes, duke hapur kështu mundësi të reja financimi për projekteve zhvillimore. Krahas përdorimit të instrumenteve financiare si huaja, bashkia Lushnje duhet të mbështet dhe në fondet e donatorëve, partneritetin Publik privat, të cilët paraqesin një mundësi për realizimin e investimeve kapitale me kosto të ulët.

Në kushtet e burimeve financiare të kufizuara, Bashkia duhet të mbështetet në:

- Fondet nga buxheti i shteti, përmes transfertave të kushtëzuara ose projekteve të financuara nga programet qendrore për zhvillim vendor, infrastrukturë apo arsim/shëndetësi)
- Fondet nga donatorët ndërkombëtar (si IPA, GIZ, KfË, BERZH, UNDP, AFD, AAFD, Banka Botërore etj.) që ofrojnë grante, financime apo asistencë teknike për projekte në fushat të ndryshëm si mjedisit, infrastruktura, digjitalizimit, turizmi, zhvillimi rural etj.
- Partneritete Publike-Private (PPP) – parmes financimit të sektorit privat për realizimin e projekteve të mëdha infrastrukturore si tregje, qendra grumbullimi/qendrave agro-logjistike etj. Gjithashtu, projekte kapitale mund të financohen dhe **komunitetit dhe biznesit lokal** për projekte të përbashkëta.
- Kredimarrje nga institucione financiare duke respektuar kuadrin ligjor për huamarrjen.
- Përdorim eficient dhe f**uqizimi i të ardhura nga pasuritë publike**, mund të gjenerohen të ardhura për financimin e projekteve kapitale.

Në këtë drejtim, bashkisë Lushnje i lipset një strukturë e konsoliduar për hartimin, aplikimin, menaxhimin dhe monitorimin e projekteve.

Konsiderata dhe rekomandime lidhure me financat

Në tërësi, struktura aktuale e të ardhurave e kufizon ndjeshëm autonominë financiare të Bashkisë Lushnje dhe pengon realizimin e planeve të qëndrueshme për zhvillim ekonomik, përmirësim të shërbimeve publike dhe investime kapitale në territorin e saj. Ndërsa Shpenzimet, shfaqin vlera të larta të cilat len pak vend për investimet kapitale dhe projekte zhvillimore.

Në këtë kuadër, Bashkua Lushnje mund të ndërmarri hapa të ndryshëm, si:

- Investim në sisteme digjitale për taksa e tarifa, me qëllim rritjen e kontrollit, monitorimit dhe arkëtimeve;

- Rishikimi i strukturave administrative, me qëllim një menaxhimi më efikas të shpenzimeve dhe shërbimeve.

- Përforcimi dhe zhvillimi i një strukture për menaxhimin e projekteve dhe aplikimet për grante ndërkombëtare, Partneritete publiko-private për investime strategjike

- Inventarizimi**,** vlerësimi dhe përdorimi strategjik i pasurive publike**;**

III. Analiza e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT)

Pikat e forta :

- Pozicion i favorshëm gjeografik dhe ndërlidhja e mirë me akset kombëtare: Bashkia Lushnje ndodhet në një nyje të rëndësishme midis Tiranës, Fierit dhe Beratit, duke u shndërruar në një pikë kalimi strategjike për tregtinë dhe lëvizjen e mallrave. Lidhja me aksin kombëtar Tiranë-Vlorë dhe afërsia me portin e Durrësit dhe të Vlorës dhe aeroportin e Rinasit dhe aeroportin e ri të Vlorës, rrit atraktivitetin për investime.
- Potencial i lartë bujqësor dhe agro-industrial : Bashkia Lushnje ka një sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore të cilësisë së lartë dhe një klimë mesdhetare që favorizon prodhimin e një game të gjerë kulturash bujqësore, përfshirë perimet, drithërat, ullinjtë dhe frutat. Tradita bujqësore shumëvjeçare dhe përvoja në përpunimin e produkteve bujqësore përbëjnë një avantazhe konkurruese.
- Kapacitete njerëzore me përvojë në bujqësi: Popullsia lokale ka njohuri praktike dhe përvojë në menaxhimin e fermave, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore. Ky kapital njerëzor është një bazë e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe potenicialit të zhvillimit të më tejshëm të agro-industrisë.
- Trashëgimi kulturore, historike dhe natyrore: Bashkia Lushnje ka elementë të fortë të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore që ofrojnë mundësi për zhvillimin e agroturizmit, turizmit rural dhe të kulturës. Banesat tradicionale, tradita e prodhimeve lokale dhe zonat me karakter rural të theksuar, përbejnë një pikë të fortë për zhvillimin e agro-turizmit dhe turizmit rural. Ndërsa historia e qytetit të Lushnjës, mundëson zhvillimin e turizmit kulturor.

Dobësitë :

- Infrastruktura e amortizuar në zonat rurale : Rrugët dytësore dhe rrjetet e ujitjes e kanalizimeve në zonat rurale janë të amortizuara ose dëmtuara, kjo kufizon aksesin në treg dhe ul efikasitetin e prodhimit bujqësor.
- Fragmentim i tokës dhe mungesë bashkëpunimi ndërmjet fermerëve : Sipërfaqet e tokës bujqësore të ndara në parcela të vogla dhe mungesa e bashkëpunimit formal ndërmjet fermerëve (kooperativa, grupime ekonomike) pengon mundësinë e mekanizimin dhe përpunimin me kosto të lirë, si dhe mundësitë për të eksportuar në mënyrë të organizuar.
- Migrim dhe plakje e popullsisë : Zhvillimi demografik negativ po prek drejtpërdrejt fuqinë punëtore, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe ofrimin e shërbimeve publike.
- Kapacitete të kufizuara në administratën vendore : Bashkia Lushnje ka mungesë të kapaciteteve për të përthithur fonde, për të hartuar projekte zhvillimi dhe për të implementuar politika afatgjata.
-

Mundësitë :

- Zhvillimi i qendrave të integruara agro-logjistike: Zhvillimi i qendrave agro-logjistike përfaqëson një hap strategjik drejt modernizimit të zinxhirit të vlerës bujqësore, duke lehtësuar grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Përfitimi nga programet dhe donatorët ndërkombëtarë : Fondet e BE[15]-së dhe mbështetja nga agjencitë donatore mund të shfrytëzohen për zhvillimin e infrastrukturës, ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe agro-industrial.
- Rritja e kërkesës për produkte cilësore lokale : Tendenca globale drejt konsumit të produkteve të freskëta, të gjurmueshme dhe të prodhuara në mënyrë natyrale ofron mundësi për krijimin e markave lokale dhe certifikime bio për produktet e Lushnjës.
- Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit rural : Investimet në bujtina, rrugë rurale, qendra fshati dhe promovim të produkteve tradicionale mund të krijojnë destinacione produkte dhe shërbime turistike, që sjellin të ardhura të reja dhe të krijojnë vende pune.
- Partneritetet me institucionet arsimore dhe kërkimore : Bashkëpunimi me shkollat profesionale, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe institucionet kërkimore mund të ndihmojë për modernizimin e bujqësisë, zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionin rural.

Kërcënimet :

- Ndryshimet klimatike dhe rreziqet natyrore : Rritja e frekuencës së thatësirave, përmbytjeve dhe temperaturave ekstreme rrezikon ciklin e prodhimit bujqësor dhe krijon pasiguri për të ardhurat e fermerëve.
- Vazhdimi i emigracionit dhe shpopullimi i zonave rurale : Nëse nuk ndërmerren masa konkrete për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mundësitë ekonomike në fshat, shumë zona rurale do të vazhdojnë të humbasin popullsinë aktive.
- Konkurrenca nga importet dhe mungesa e standardeve : Produktet e importuara shpesh janë më të lira dhe të certifikuara për tregje ndërkombëtare, ndërkohë që fermerët lokalë përballen me vështirësi për të plotësuar standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore.
- Planifikim i dobët dhe mungesë bashkëpunimi ndërinstitucional : Mungesa e koordinimit me qeverinë qendrore, partnerët privatë dhe bashkitë fqinje rrezikon të çojë në mbivendosje ndërhyrjesh dhe zhvillim të pabalancuar.

[15] IPARD III, IPA, Green Agenda

IV. VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

IV.1. Parimet e Zhvillimit

Pika e nisjes për ndërtimin e vizionit zhvillimor të Bashkisë Lushnje për një periudhë 5 vjecare, është analiza e situatës aktuale. Kjo analizë është ndërtuar mbi të dhëna statistikore zyrtare (qendror ose vendor), dhe ofron një panoramë të qartë të sfidave dhe potencialeve të bashkisë.

Bashkia Lushnje është e përkushtuar ndaj një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të balancuar, që mbron burimet natyrore, rrit kapitalin njerëzor dhe nxit zhvillimin ekonomik lokal, të mbështetur në potencialet lokale dhe nevojat reale të komunitetit. Në këtë kuadër Përcaktohen parimet kryesore të zhvillimit që Bashkia Lushnje duhet të ndjekë:

- **Zhvillimi i qëndrueshëm:** Ky parim ka për qëllim të siguroj një balancë mes zhvillimit ekonomik, mirëqenies sociale dhe ruajtjes së mjedisit.
- **Zhvillimi i bazuar në vlerat territoriale:** Ky parim ka për qëllim të mbështes zhvillimin në avantazhet konkurruese dhe karakteristikat unike të territorit.
- **Përfshirja sociale:** Ky parim ka për qëllimi të siguroj pjesëmarrjen e të gjithë grupeve sociale, pavarësisht gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit ekonomik apo vendbanimit (urbane/rurale).
- **Zhvillimi ekonomik i diversifikuar:** Ky parim ka për qëllimi të shmang varësia nga një sektor i vetëm (si p.sh. bujqësia) dhe të promovohen sektorë të rinj me potencial të lart zhvillimit.
- **Partneriteti dhe bashkëpunimi**: Ky parim ka për qëllimi të promovoj një qasje bashkëpunuese mes institucioneve lokale qendrore dhe vendore, komunitetit, sektorit privat dhe donatoreve.
- **Mirëqeverisja e dhe Transparenca:** Ky parim ka për qëllimi të forcoj llogaridhënien, efikasitetin dhe transparencën e administratën lokale.
- **Menaxhimi hapësinor i qëndrueshëm:** Ky parim ka për qëllimi të promovoj një zhvillim urban të rregullt, të organizuar dhe të orientuar drejt cilësisë së jetesës, qëndrueshmërisë dhe shërbimeve publike të barabarta dhe cilësore.
- **Inovacioni dhe dixhitalizimi:** Ky parim ka për qëllimi të rris kapacitetin inovues të bashkisë përmes teknologjisë dhe modernizimit të shërbimeve.
- **Integrimi rajonal dhe evropian:** Ky parim ka për qëllimi të rris përputhshmërinë e politikave lokale me ato kombëtare dhe evropiane.
- **Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të krizave**: Ky parim ka për qëllimi të forcoj kapacitetin e territorit dhe komuniteteve për t'u përballur me rreziqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu.

Në bazë të këtyre parimeve, strategjia 5-vjeçare e zhvillimit për Bashkinë Lushnje mund të strukturohet në mënyrë koherente dhe të orientuar drejt rezultateve të matshme, duke ndërtuar një vizion të përbashkët dhe një plan veprimi të realizueshëm.

IV.2. Vizioni i Zhvillimit për Bashkinë Lushnje

Vizioni i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje formulohet kështu:

« Të zhvillojmë një bashki konkurruese, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, e cila, duke shfrytëzuar potencialet bujqësore, burimet natyrore dhe pozicionin strategjik, promovon rritjen ekonomike, përmirëson

cilësinë e jetës dhe garanton një zhvillim të balancuar mes zonave urbane dhe rurale, në harmoni me mjedisin dhe me standarde evropiane.»

IV.3. Prioritetet Strategjike

IV.3.1. Objektivat strategjik

Vizioni mbështetet në 5 objektiva strategjik zhvillimi:

1. **Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe konkurrues**

Ky objektiv synon të nxisë rritjen ekonomike duke shfrytëzuar avantazhin krahasues që bashkia Lushnje ka në sektorin bujqësor dhe agro-industrial. Përmes modernizimit të bujqësisë, përpunimit të produkteve, certifikimit të cilësisë dhe lehtësimit të aksesit në tregje kombëtare e ndërkombëtare, synohet krijimi i një ekonomie rurale dinamike dhe me vlerë të shtuar të lartë. Po ashtu, mbështetja për bizneset e vogla dhe ekonomitë familjare, nxitja e formave të bashkëpunimit (kooperativa, grupe prodhuesish) dhe promovimi i inovacionit përbëjnë shtylla kyçe për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë në të gjithë territorin e bashkisë.

2. **Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike**

Ky objektiv fokusohet në modernizimin e infrastrukturës themelore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës për banorët e Bashkisë Lushnje. Investimet në rrjetet rrugore, sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimeve, infrastrukturën shkollore dhe shëndetësore do të ndihmojnë në uljen e pabarazive midis zonave urbane dhe rurale. Po ashtu, garantimi i aksesit të barabartë në shërbime për të gjitha grupet sociale ku do që të ndodhen, do të forcojë kohezionin social dhe do të rrisë qëndrueshmërinë demografike të territorit.

3. **Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe përfshirja sociale**

Ky objektiv synon të fuqizojë burimet njerëzore si baza më e rëndësishme për zhvillimin afatgjatë të bashkisë. Përmes përmirësimit të arsimit dhe aftësimit profesional, Bashkia synon të ulë papunësinë dhe të krijojë kushte për punësim të qëndrueshëm. Njëkohësisht, përfshirja sociale, barazia gjinore dhe kujdesi për shtresat në nevojë do të përmirësojnë mirëqenien e përgjithshme dhe do të forcojnë pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse.

4. **Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore**

Ky objektiv adreson nevojën për një zhvillim harmonik me natyrën, duke mbrojtur ekosistemet, biodiversitetin dhe burimet natyrore të territorit. Përmes përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve, ndërtimit të infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura, promovimit të energjive të rinovueshme dhe eficiencës në përdorimin e tokës e ujit, synohet krijimi i një bashkie të gjelbër dhe rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Zhvillimi rural duhet të orientohet drejt praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe ruajtjes së peizazhit natyror.

5. **Qeverisje e mirë, planifikim dhe partneritete**

Ky objektiv fokusohet në forcimin e kapaciteteve të Bashkisë për të planifikuar, zbatuar dhe monitoruar politikat zhvillimore në mënyrë të efektshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse. Përdorimi i teknologjive digjitale, angazhimi i qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe rritja e transparencës në qeverisje janë parime themelore. Bashkia synon gjithashtu të zgjerojë partneritetet ndër-institucionale dhe ndërkombëtare për të tërhequr financime, shkëmbime përvojash dhe projekte të përbashkëta zhvillimi.

IV.3.2. Programet strategjike

Objektiva Strategjik përkthehen në Programe strategjike zhvillimi:

Objektivi 1: Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe konkurrues

1. Programi i zhvillimit të bujqësisë së qëndrueshme dhe agrobiznesit, fale mekanizimit bujqësor, akses në inpute cilësore, përpunimin dhe paketimin e produkteve bujqësore.
2. Programi i mbështetjes për sipërmarrjen lokale dhe ekonomitë familjare, fal politikave mbështetëse për bizneset, mbështetjes për zhvillimin e kooperativave dhe grupimeve.
3. Programi për zhvillimin e markave dhe produkteve lokale, fal certifikimit, labelizimit, kontrollit të origjinë gjeografike, dhe promovimit.
4. Programi i zhvillimit të tregjeve dhe qendrave agro-logjistike, fal përmirësimit të tregjeve ekzistuese, ngritje pikash grumbullimi të integruara, bashkëkohore dhe inovative, që lidhen me rrjete transporti dhe zinxhirë furnizimi te tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Programi i zhvillimit të qëndrueshëm të Turizmit.

Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike

1. Programi për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe transportit publik the aksesi, fal rikonstruksionit dhe mirëmbajtje e rrugëve lidhëse mes fshatrave, Transporti publik i qendrueshwm dhe miqësor me mjedisin.
2. Programi i modernizimit të rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimeve dhe ujitjes, fal zgjerimit të rrjeteve të furnizimit me ujë të pijshëm, rehabilitim i kanaleve të ujitjes dhe kullimit.
3. Programi për zhvillimin e infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore, fal ristrukturimit të sistemit dhe rehabilitimit të shkollave dhe qendrave shëndetësore rurale.
4. Programi për eficiencën energjetike dhe energjinë e rinovueshme, fal ndriçim LED në rrugë dhe godina publike, investime në sisteme diellore në ndërtesa publike.

Objektivi 3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe përfshirja sociale

1. Programi për arsimin profesional dhe orientimin drejt tregut të punës, fal bashkëpunimit me Zyrën e Punës dhe qendrat e formimit profesional, në zhvillimin e kurseve të përshtatura me nevojat lokale (bujqësi, turizëm, shërbime),
2. Programi për rininë, barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen qytetare, fal qendrave komunitare për të rinjtë dhe gratë, formim dhe orientim në tregun e punës.
3. Programi i përfshirjes sociale dhe mbështetjes për shtresat në nevojë, strehim social, ndihmë ekonomike dhe shërbime për personat me aftësi ndryshe, integrim për të moshuarit dhe grupet vulnerabil.

Objektivi 4: Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

1. Programi për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, fal përmirësim i sistemit të grumbullimit dhe ndarjes së mbetjeve, fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi mjedisor etj.
2. Programi për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe burimeve ujore, fal monitorimit të cilësisë së tokës dhe burimeve ujore, zbatimi i praktikave bujqësore të qëndrueshme.
3. Programi për mbrojtjen mjedisore, biodiversitetit dhe peizazhit, fal rehabilitim i pyjeve dhe zonave të mbrojtura, promovim i vlerave natyrore dhe edukim ekologjik
4. Programi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, vlerësim i riskut dhe plane emergjente për përmbytje/thatësira, fal planeve lokale të adaptimit dhe zbutjes klimatik, planeve dhe strukturimit të emergjencave, sinjalizimit të hershme, regjisë së rinovueshme.

Objektivi 5: Qeverisje e mirë, planifikim dhe partneritete

1. Programi për forcimin e kapaciteteve të administratës vendore dhe sistemeve digjitale për qeverisje efikase, fal trajnimeve për stafin e bashkisë në planifikim, buxhetim dhe menaxhim projektesh, manuale, databaza dhe sisteme digjitale për qeverisje efikase, sisteme në lehtësimin e procedurave te ofrimit të shërbimeve publike dhe menaxhimit.
2. Programi për transparencën dhe përfshirjen qytetare, falë Portale digjitale për informim dhe konsultim me qytetarët, Buxhetimi me pjesëmarrje në lagje dhe fshatra
3. Programi për planifikimin e integruar dhe menaxhimin e territorit, fal përditësimit / standardizimit dhe zbatim i planeve të përgjithshme vendore dhe planeve të detajuara, rregullimi i zhvillimit urban dhe kontrolli i ndërtimeve

IV.3.3. Rezultatet e Pritshme

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe konkurrues

Zbatimi i këtij objektivi do të sjellë një transformim gradual, por të qëndrueshëm të sektorit bujqësor në një sektor të modernizuar dhe të orientuar drejt tregut. Rritja e produktivitetit bujqësor përmes mekanizimit, përmirësimi i aksesit në teknologji dhe shërbime këshillimore do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave të fermerëve. Mbështetja për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve rurale, përfshirë agroturizmin, do të kontribuojë në krijimin e vendeve të reja të punës, uljen e varësisë nga bujqësia tradicionale dhe nxitjen e diversifikimit të ekonomisë vendore. Për më tepër, certifikimi dhe markimi i produkteve lokale do të forcojë identitetin agro-ushqimor të zonës dhe do të hapë rrugën për eksport dhe tregti të drejtpërdrejtë, sidomos me vendet e BE-së. Rrjedhimisht, Lushnja pritet të konsolidohet si një pol i rëndësishëm agro-industrial në Shqipëri.

Objektivi Strategjik 2: Infrastruktura dhe shërbimet publike

Zbatimi i këtij objektivi do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Investimet në rrugë rurale dhe urbane do të përmirësojnë qarkullimin, do të lehtësojnë aksesin në tregje dhe do të reduktojnë kostot për komunitetin bujqësor. Ndërhyrjet në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve dhe të ujitjes do të garantojnë një furnizim më të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm, si dhe eficiencë më të lartë në përdorimin e ujit për bujqësi. Po ashtu, rehabilitimi i infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore do të sjellë rritjen e aksesit, sigurisë dhe cilësisë së këtyre shërbimeve jetike. Ndriçimi efikas energjetik në zonat urbane dhe rurale do të përmirësojë ndjeshëm ndjesinë e sigurisë dhe do të reduktojë shpenzimet energjetike të bashkisë.

Objektivi Strategjik 3: Kapitali njerëzor dhe përfshirja sociale

Rezultatet e pritshme nga ky objektiv përfshijnë një përmirësim të dukshëm të cilësisë së burimeve njerëzore dhe përfshirjes shoqërore. Investimet në arsimin profesional dhe programe të punësimit do të rrisin përputhjen mes kërkesës së tregut të punës dhe ofertës së aftësive të të rinjve dhe të papunëve. Për rrjedhojë, pritet rritje e punësimit lokal, ulje e migrimit dhe përmirësim i kushteve të jetesës. Mbështetja për gratë, të rinjtë dhe grupet e margjinalizuara do të çojë në rritje të përfshirjes në jetën publike, në vendimmarrje dhe në sipërmarrje. Ndërhyrjet në fushën e përfshirjes sociale do të përmirësojnë aksesin në strehim social, shërbime sociale dhe kujdes afatgjatë për shtresat në nevojë, duke ulur pabarazitë dhe duke promovuar kohezionin social.

Objektivi Strategjik 4: Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve natyrore

Nga zbatimi i këtij objektivi priten rezultate konkrete në përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Pritet një rritje e ndjeshme e mbulimit me shërbime të menaxhimit të mbetjeve, reduktim i depozitimit të paligjshëm dhe shtim i përpunimit e riciklimit të mbetjeve. Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe ujit do të kontribuojë në reduktimin e degradimit të tokës bujqësore dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore. Investimet në mbrojtjen e biodiversitetit dhe pyllëzimet do të kontribuojnë në rritjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe në përballimin e sfidave të ndryshimeve klimatike. Për më tepër, ndërtimi i planeve për adaptim dhe reziliencë do të përgatisë bashkinë për të menaxhuar më mirë fatkeqësitë natyrore dhe efektet afatgjata të ngrohjes globale.

Objektivi Strategjik 5: Qeverisje e mirë dhe partneritete efektive

Nga ky objektiv, rezultatet pritet të jenë rritja e besimit të qytetarëve ndaj administratës publike përmes transparencës, llogaridhënies dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve. Forcimi i kapaciteteve institucionale, trajnimi i stafit dhe përmirësimi i sistemeve të menaxhimit do të përkthehen në një administratë më efikase, e aftë për të menaxhuar fondet dhe projektet zhvillimore. Planifikimi urban më i mirë dhe zbatimi efektiv i planeve vendore do të përmirësojë organizimin e territorit dhe do të mundësojë zhvillim të kontrolluar dhe të balancuar. Së fundmi, krijimi i partneriteteve me aktorë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë do të hapë mundësi për financime të reja, bashkëpunim teknik dhe shkëmbim përvojash që e bëjnë më të qëndrueshëm zhvillimin e bashkisë.

V. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Zhvillimit të Bashkisë Lushnje është ndërtuar mbi një strukturë të ndërlidhur që garanton një qasje të integruar dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete. Në qendër qëndrojnë pesë objektivat strategjikë, të cilët përfaqësojnë drejtimet kryesore afatgjata të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social, mjedisor dhe institucional të territorit. Për secilin prej këtyre objektivave janë hartuar programe strategjike që veprojnë si blloqe të ndërhyrjes. Brenda çdo programi janë përcaktuar ndërhyrje/ projektesh dhe veprimesh specifikë, të cilët konkretizojnë qëllimin me rezultate të matshme dhe të arritshme në periudha të caktuara kohore. Ndërhyrjet, projektet dhe veprimet janë të përshkruara me afate, indikatorë, kosto të përafërta, burime financimi dhe njësitë përgjegjëse për zbatimin. Kjo strukturë e integruar garanton një linjë logjike të qartë nga vizioni dhe objektivat e përgjithshme, drejt prioriteteve sektoriale dhe veprimeve konkrete në terren, duke mundësuar matjen e progresit dhe rritjen e efikasitetit në përdorimin e burimeve publike dhe partnerëve zhvillimorë.

V.1. Metodologjia e prioritizimit të planit të veprimit

Prioritizimi i veprimeve dhe projekteve brenda Planit të Veprimit është një proces i rëndësishëm që synon të orientoj burimet financiare, institucionale dhe teknike, drejtë ndërhyrjet me ndikim dhe zbatueshmëri më të lartë. Ky proces kryhet në disa hapa:

1. Hartimi i listës së projekteve të mundshme për secilin objektiv dhe program strategjik, bazohet në analizën e nevojave, dokumentet strategjike/planeve te veprimit, propozime, projekte të papërfunduara.

2. Përcaktimi i kritereve të vlerësimit dhe prioritizimit :

Për të prioritizuar, ndërhyrjet, projektet dhe veprimet, grupi i punës vlerëson secilin projekt sipas kritereve kryesore :

- Rëndësia strategjike: Ku vlerësohen me prioritet me të lartë projektet të cilët shfaqin përputhshmëri me objektivat e strategjik.
- Ndikimi socio-ekonomik: Ku vlerësohen më prioritet me të lartë projektet më përfitim më të lartë për komunitetin, punësim, zhvillim ekonomik, përfshirje sociale etj.
- Urgjenca dhe rëndësia: Ku vlerësohen me prioritet më të lartë projekte me ndikimi të lartë në cilësinë e jetesës.
- Zbatueshmëria Teknike : Ku vlerësohen më prioritet me të lartë projektet me mundësi reale për zbatimin e projektit me burimet teknike ekzistuese.
- Përfitueshmëria territoriale : Ku vlerësohen më prioritet më të lartë projektet me ndikim territorial, mbulesa gjeografike dhe numër njësish administrative më të gjerë.
- Mundësia për financim : Ku vlerësohen më prioritet më të lartë projektet me ndikim të ulët në buxhetin e bashkisë, dhe mundësi financimi nga buxheti i shtetit, donatorë ose PPP.
- Kosto-efektiviteti: Ku vlerësohen më prioritet më të lartë projektet me raport kostos përfitim më të lartë.

Për secilin ndërhyrjet, projektet dhe veprimet, grupi i punës aplikon një sistem pikëzimi nga 1 në 5 për secili kriter të lartpërmendur (ku 1 përfaqëson një rendësi të ulët dhe 5 një rëndësi të lartë). Më pas llogariten pikët mesatare për secilën ndërhyrje, projekt dhe veprim, duke mundësuar renditjen sipas pikëve totale të grumbulluara.

3. Klasifikimi i projekteve sipas afatit kohor

Bazuar në vlerësimin dhe renditjen e ndërhyrjeve, projekteve dhe veprimeve të etapës se mëparshme dhe analizën e kapaciteteve dhe burimeve, projektet ndahen në 3 faza :

- **Afatshkurtër (1 vit)** – Ndërhyrje, projekte dhe veprime me ndikim të menjëhershëm dhe prioritare;
- **Afatmesëm (2–3vjet)** – Ndërhyrje, projekte dhe veprime transformuese me përgatitje dhe financim të ndërmjetëm;
- **Afatgjatë (3–5 vjet)** – Ndërhyrje, projekte dhe veprime, që kanë për investime dhe koordinim afatgjatë.

4. Konsultim dhe validim

Plani i veprimit i propozuar nga grupi i punesa, shqyrtohet dhe validohet në konsultim me publikun, qytetarëve dhe aktorëve lokal. Fal një procesi konsultimi publik përfaqësues e gjithëpërfshirës, shqyrtohen në mënyrë demokratike prioritizimi i projekteve.

5. Përgatitja e Planit të Veprimit final

Në Planin e Veprimit përfundimtar, do të përfshihen:

- Objektivin përkatës strategjik
- Programin dhe objektivin specifik
- Ndërhyrje, Projekti, Veprimi
- Kosto
- Afati i zbatimit
- Burimet e financimit

- Njësitë zbatuese dhe partnere

Kjo metodologji siguron transparencë, lidhje me nevojat reale, dhe efikasitet në vendimmarrje.

V.2. Plani i Veprimit

Ndërhyrje/Projekt	Kosto e Përafërt	Njësitë përgjegjëse	Burime financimi	Indikatorë Kryesorë	Afati					Fiche
Objektivi 1: Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe konkurrues						T1	T2	T3	T4	T5	
O.1.P1. Programi i zhvillimit të bujqësisë së qëndrueshme dhe agrobiznesit.											
Platforma digjitale që ofron informacione mbi inputet bujqësore, çmimet e tregut për produktet bujqësore, kalendarin e aplikimeve për financime, këshilla agroteknike etj.	2 000 000	Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural Struktura e ngarkuar për IT dhe Digjitalizimit (bashkia)	Buxheti i Bashkisë Programet IPA / BE për digjitalizim Donatorë ndërkombëtarë (BE, FAO, GIZ, UNDP) Partneritete publike-private (PPP) Projekte inovacioni dhe teknologjie	Platformë funksionale Nr. përdoruesve të regjistruar (fermerë)	Afatshkurtër – Afatmesëm						PO
Zhvillimi I programit të shoqërimit të fermerëve (Mbështetje teknike, ligjore dhe financiare për krijimin e kooperativave bujqësore dhe njësive të përbashkëta për mekanizim, përpunim, ambalazhimi,	1 500 000	Struktura e ngarkuar për bujqësinë dhe Zhvillimit Rural Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Financat Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Programet IPARD / IPA Skemat kombëtare të bujqësisë Donatorë ndërkombëtarë (FAO, GIZ, UNDP) Kontribut i fermerëve	Nr. kooperativave të krijuara dhe formalizuara Nr. fermerëve të përfshirë në program Nr. njësive të përbashkëta të pajisjeve dhe magazinimit	Afatshkurtër – Afatmesëm – Afatgjatë						PO

magazinim dhe shitje.)											
Zhvillimi i një qendre të integruar të shërbimeve për bujqësinë dhe fermerët në partneritet me MBZHR (në të cilën përfshihen shërbimet e aktorëve të ndryshëm, , AZHBR, Agjencia Rajonale e Ekstensionit, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, biznesi lokal ...)	Sipas studimit/projektit	Drejtoria e ngarkuar për bujqësinë MBZHR AZHBR Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Agjencia e Ekstensionit Biznes privat	Buxheti i Bashkisë MBZHR Programet IPARD / IPA Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, FAO) Partneritete Publike–Private (PPP)	Nr. fermerëve që marrin shërbime Nr. shërbimeve të integruara	Afatmesëm						PO
Programi i mbështetjes për mekanizimin e fermave (Grante për fermat që aplikojnë teknologji bashkëkohore: GPS, sensorë uji, automatizim i vaditjes, etj.)	2 500 000	Drejtoria e ngarkuar për bujqësinë	Buxheti i Bashkisë Fondet e MBZHR Programet IPARD / IPA Donatorë ndërkombëtarë Bashkëfinancim nga fermerët	Nr. fermave të përfshirë Nr. sistemeve të vaditjes së automatizuar të instaluara Nr. fermerëve të trajnuar	Afatmesëm – Afatgjatë						PO

Program mbështetës dhe këshillim për fermerët, për adaptimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme.	4 000 000	Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Struktura e ngarkuar për Mjedisit dhe Territorit Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Programet IPARD / IPA Fondet e BE për klimë dhe mjedis Donatorë ndërkombëtarë (FAO, GIZ, UNDP, BE) Bashkëfinancim nga fermerët	Nr. fermerëve të trajnuar	Afatgjatë						PO
O.1.P2. Programi i mbështetjes për sipërmarrjen lokale dhe ekonomitë familjare.											
Programi i Mbështetjes për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe Fermat për Investime të Gjelbra dhe Bujqësi të Qëndrueshme	15 000 000	Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Projekteve Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Struktura e ngarkuar për Mjedisit dhe Shërbimeve Publike	Buxheti i Bashkisë Programet e BE për tranzicionin e gjelbër Fondet kombëtare për energji të rinovueshme Partneritete publike-private Donatorë ndërkombëtarë (GIZ, UNDP, FAO)	Nr. fermave/NVM-ve të mbështetura	Afatshkurtër – Afatmesëm						PO

Fondi për Start-up në fshat (Mbështetje financiare për ndërmarrjet e reja në zonat rurale.)	10 000 000	Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë Struktura e ngarkuar për Financave dhe Buxhetit	Buxheti i Bashkisë Programet IPARD / IPA Fondet e BE për sipërmarrje dhe zhvillim rural Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP, FAO) Partneritete publike-private	Nr. start-up-eve të financuara (target: 10–20) Nr. planeve të biznesit të mbështetura Nr. përfituesve të trajnuar Shuma totale e financimit të disbursuar	Afatshkurtër – Afatmesëm						PO
Ngritja e Inkubatori i Biznesit Rural (Mbështetje me hapësira dhe shërbime për biznese të reja në agro-industri dhe turizëm.)	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësinë Struktura e ngarkuar për Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit Struktura e ngarkuar për Arsimit dhe Formimit Profesional (për trajnimet)	Buxheti i Bashkisë Programet IPA / BE për sipërmarrje dhe inovacion Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP, FAO) Partneritete publike-private (PPP) Fondet për zhvillim rural dhe inovacion	Nr. bizneseve të mbështetura (startup-e) Nr. pjesëmarrësve në programet e inkubimit Nr. trajnimeve dhe mentorimeve të ofruara Hapësira funksionale e inkubatorit	Afatmesëm						PO

Programi i mbështetjes për Start-up në agro-turizëm dhe produkte tradicionale (Grante të vogla për familjet që diversifikojnë veprimtarinë e tyre drejt turizmit rural, prodhimeve artizanale dhe përvojave agro-kulturore me standarde të qëndrueshme mjedisore)	10 000 000	Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik Struktura e ngarkuar për Turizmit Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Buxheti i Bashkisë Programet IPA / BE për zhvillim rural dhe turizëm Donatorë ndërkombëtarë (FAO, UNDP, GIZ, BE) Partneritete publike-private Skemat kombëtare të mbështetjes së turizmit	Nr. start-up-eve të financuara (target: 10–20) Nr. planeve të biznesit të mbështetura Nr. përfituesve të trajnuar Shuma totale e financimit të disbursuar	Afatmesëm					PO
	O.1.P3.	**Programi për zhvillimin e markave dhe produkteve lokale.**									
Zgjerimi i rolit / funksionit të panairi i prodhimeve lokale (përfshirja e prodhuesve lokal te vegjel e të mesëm, platformë për të lidhur fermerët me konsumatorët final, rrjetëzim me tregtarë dhe promovim të markave lokale).	-	Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik Struktura e ngarkuar për Turizmin	Buxheti i Bashkisë Fondet e zhvillimit rural dhe turizmit Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private Skemat kombëtare të mbështetjes së bujqësisë	Nr. prodhuesve pjesëmarrës Nr. marrëveshjeve tregtare të krijuara	Afatmesëm					PO

Programi për zhvillimin e brendimit dhe certifikimit (Mbështetje për krijimin e markave për produkte lokale)	5 000 000	Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Buxheti i Bashkisë Fondet IPA dhe programet e BE Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private Skemat kombëtare të zhvillimit rural	Nr. produkteve të certifikuara Nr. markave të krijuara Nr. prodhuesve të përfshirë në program	Afatgjatë						PO
O.1.P4. Programi i zhvillimit të tregjeve dhe qendrave agro-logjistike.											
Park Bujqësore Rajonal I Integruar – Hapësirë multifunksionale ku përfshihen: - Pika grumbullimi/magazinimi; - Pika përpunimi / ambalazhimi; - Laboratorë për monitorim/certifikim të cilësisë së produkteve, tokës, ujit; - Tregtia Inputeve bujqësore; - Shërbime këshillimi bujqësor, financiar, juridik; - Shërbime	Sipas studimit/projektit	##########	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA III / IPARD Partneritete Publike–Private (PPP) Investitorë privatë në agro-industrinë Donatorë ndërkombëtarë	Nr. fermerëve dhe NVM-ve të shërbyera Ton produkte të grumbulluara dhe të përpunuara Nr. analizave laboratorike të kryera Nr. kontratave tregtare të lidhura	Afatshkurtër – Afatmesëm – Afatgjatë						PO

ndërlidhje me tregjet ...											
Rehabilitimi i tregjeve lokale në qendrat e Njësive Administrative.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Shërbimeve Publike Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Fondet e zhvillimit rural dhe rajonal Donatorë ndërkombëtarë (FAO, GIZ, UNDP) Partneritete publike–private Programet IPA të BE	Nr. tregjeve të rehabilituara ose të ndërtuara Nr. tregtarëve të regjistruar Nr. fermerëve pjesëmarrës	Afatmesëm						PO
Zhvillimi i pikave logjistike të integruara për grumbullimin, magazinimin, perpunimin dhe amabllazhimin dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore në njësitë administrative. (Rehabilitimi i magazinave ish industriale në Njësinë Administrative Golem, dhe	-	Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik Struktura e ngarkuar për Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike Drejtoria e Planifikimit Urban	Buxheti i Bashkisë Fondet IPARD dhe IPA Partneritete Publike–Private (PPP) Donatorë ndërkombëtarë Investime private në zinxhirin agro-ushqimor	Nr. pikave logjistike të ndërtuara/funksionale Ton produkte të grumbulluara dhe të përpunuara Nr. fermerëve të përfshirë në sistem Nr. kontratave tregtare të realizuara	Afatgjatë						PO

kthimi i tyre në pika magazinimi0											
Rehabilitimi dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të bashkisë në të cilin përfshihen: Zona ish-Industriale në fshatin Plug, Zona ekonomike e ish fabrikës së dyshekëve.	Sipas studimit/projektit	Bashkia Lushnje Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin urban	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE për zhvillim ekonomik Partneritete Publike–Private (PPP) Investime direkte private	Nr. bizneseve të vendosura (≥50) Nr. vendeve të punës të krijuara (	Afatgjatë						JO
O.1.P5. Programi i zhvillimit të qëndrueshëm të Turizmit											
Zhvillimi I projekti të rezervuarit të Kasharit (Njësia Administrative Karbunarë), dhe kthimin e tij si një destinacion turistik për aktivitete rekreative.	Sipas studimit/projektit	################################## ################	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Partneritete publike-private (PPP) Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)	Sipërfaqja e rehabilituar rreth rezervuarit Nr. zonave rekreative të krijuara Nr. sinjalistikave të vendosura	Afatshkurtër – Afatmesëm						Po

Zhvillimi I ndriçim i monumenteve historike dhe sinjalistika e tyre (Instalimi i ndriçimit dekorativ dhe sinjalistikës së integruar për vizitorët.)	10 000 000	Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / projekte të BE / GIZ Partneritete publike-private (PPP) për mirëmbajtje	Nr. monumenteve të pajisura me ndriçim dekorativ Nr. tabelave sinjalistike të vendosura	Afatshkurtër – Afatmesëm						Po
Nxitja e zhvillimi të eko-fermave turistike në Njësitë Administrative të Hysgjokaj dhe Ballagat.	10 000 000	Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural Struktura e ngarkuar për Turizmin Njësitë Administrative (Hysgjokaj dhe Ballagat)	Buxheti i Bashkisë Programet IPARD / IPA Skemat kombëtare të bujqësisë Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, FAO, UNDP etj.) Bashkëfinancim nga përfituesit (fermerët)	Nr. eko-fermave të krijuara/mbështetura Nr. fermerëve të trajnuar Nr. aktiviteteve turistike të zhvilluara në fermë	Afatshkurtër						Po
Zhvillimi i shtigjeve për ecje në natyrë (Hikking), me sinjalistikë dhe infrastrukturë të adaptuar. - Shteg nga Zgjana e deri në Kasharaj (me dy	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Mjedisin Struktura e ngarkuar për Pyjet Njësitë Administrative përkatëse	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Donatorë ndërkombë	Km shtigje të rehabilituara dhe të sinjalizuara Nr. pikave të pushimit të krijuara Nr. tabelave orientuese dhe informative të vendosura	Afatshkurtër – Afatmesëm						Po

ndalesa), - Shteg turistike në kodrën e Ardenicës.			tarë (BE, GIZ, UNDP) Partneritete me sektorin privat (tur operatorë)								
Mbështetje financiare për zhvillimin e shtëpive druri "hostel" në pika panoramike strategjike.	10 000 000	Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban dhe Zhvillimin e Territorit Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë (grante nxitëse) Programet IPARD / IPA Investime private (bashkëfinancim) Partneritete Publike-Private (PPP) Donatorë ndërkombëtarë	Nr. strukturave "hostel" të ndërtuara (target: 5–10) Nr. investitorëve/ përfituesve të mbështetur	Afatshkurtër						Po
Zhvillimi "QËNDRE PRITJE PËR VIZITORËT"në katin I të Shtëpisë Muze "Kongresi I Lushnjes" ku turistët do kenë mundësi të njihen me Bukuritë Natyrore që ofron Bashkia Lushnje.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për IT dhe Komunikim	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Donatorë ndërkombëtarë	Qendra e krijuar dhe funksionale Nr. materialeve informative dhe digjitale të zhvilluara Nr. stafit të trajnuar	Afatshkurtër						Po

Restaurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore. -Kisha e Shën Kollit , në fshatin Krutje e Sipërme; -Kisha e Shën Mërisë, në fshatin Bishqethëm ,Njësia Administrative Kolonjë; -Kisha Shën Kollit, në fshatin Toshkëz, Njësia Administrative Allkaj.	Sipas studimit/projektit	Bashkia Lushnje Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Ministria e Kulturës Fondet IPA / BE Donatorë ndërkombëtarë (UNESCO, GIZ, AADF) Partneritete publike–private për turizëm kulturor	Nr. objekteve të restauruara Sipërfaqja e ndërhyrjeve restauruese Nr. tabelave informuese të vendosura	Afatmesëm						Po
Programi për mbështetjen për familjet në fshatra me potencial turistik, të cilat ofrojnë shërbime si "Bujtina", ushqim dhe pije tradicionale, aktivitete autentike për vizitorët etj.	10 000 000	Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Njësitë Administrative (terren)	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPARD / IPA Donatorë ndërkombëtarë (GIZ, UNDP, etj.) Bashkëfinancim nga përfituesit (familjet)	Nr. familjeve të mbështetura Nr. bujtinave të krijuara Nr. trajnimeve të zhvilluara Nr. produkteve/eksperiencave turistike të krijuara	Afatmesëm						Po

Pasqyrimi i pikave të interesit turistik në internet (në faqen e bashkisë, në Google maps, Instagram, Facebook, Tripadvisor...)	15 000 000	Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Komunikimim dhe Marrëdhënien me Publikun Drejtoria e IT Njësitë Administrative (identifikimi i pikave lokale)	Buxheti i Bashkisë Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, etj.) Partneritete me sektorin privat (marketing bashkëpunues)	Nr. pikave të interesit të publikuara online Nr. materialeve promocionale të prodhuara	Afatmesëm						Po
Rehabilitim dhe vënia në funksion e pishinës jofunksionale edhe gjatë periudhës së dimrit.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike Struktura e ngarkuar për Rininë dhe Sportin Struktura e ngarkuar për Shëndetit Publik Njësia Administrative përkatëse	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Partneritete Publike–Private (PPP) Donacione dhe grante sportive	Pishina e rehabilituar dhe funksionale Sistem ngrohjeje i instaluar Kapaciteti i përdorimit ditor të objektit	Afatmesëm						po
Zhvillimi I një Portali Turistik të Bashkisë Lushnje - Platformë digjitale ku promovohen produktet dhe shërbimet turistike dhe pikat e interesit turistik, si : - Destinacionet turistike lokale; - Shërbimet e akomodimit	2 000 000	Struktura e ngarkuar për IT dhe Inovacionin Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Komunikimin dhe Marrëdhëniet me Publikun	Buxheti i Bashkisë Programet IPA / BE (digjitalizim & turizëm) Donatorë ndërkombëtarë Partneritete me sektorin privat (sponsorizime / reklama)	Platforma e ndërtuar dhe funksionale Nr. destinacioneve të publikuara Nr. bizneseve turistike të regjistruara Nr. itinerareve të krijuara	Afatshkurtër – Afatmesëm						Po

(bujtinat, Hotel, Hotel...); - Shërbimet turistike autentike (lidhur me agro-tuizimin, eko-turizmit, turizmin kulturor ...); - Itineraret turistik tematik, shtigjet Hikking, Treking Biçikleta etj.											
Binjakëzimi me Qytete Evropiane.	-	Struktura e ngarkaur për Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Struktura e ngarkuar për Turizimin	Buxheti I Bashkise Programet e BE (Toën Tëinning)	Nr. marrëveshjeve Projekte/aktivitete të përbashkëta	Afatgjatë						Jo
Krijimi I rrjetit të qendrave të Informacionit Turistik.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për IT dhe Komunikimit Njësitë Administrative (menaxhim lokal)	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP) Partneritete publike-private (PPP) (ne rast delegimit të menaxhimit)	Nr. qendrave të informacionit të krijuara Nr. materialeve promocionale të prodhuara Nr. stafit të trajnuar	Afatgjatë						Po

Zhvillimi I një "FOTOTEK" në mbështetje të promovimit të monumenteve të kulturës, natyrës dhe pikave të interesit turistik.	1 000 000	Bashkia Lushnje Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën	Buxheti i Bashkisë Fondet IPA / BE për digjitalizim dhe kulturë Donatorë ndërkombëtarë (UNESCO, GIZ, AADF) Sponsorizime private Partneritete me sektorin e turizmit	Nr. fotografive Nr. materialeve promovuese të prodhuara	Afatgjatë						JO
Zhvillimi I aktiviteteve rekreative "Piknik në park" në afërsi të fshatit Allprenaj, Njësia Administrative Golem.	Sipas studimit/projektit	Bashkia Lushnje Struktura e ngarkuar për Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit Struktura e ngarkuar për Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës Struktura e ngarkuar për Mjedisin Struktura e ngarkuar për Turizmit Njësia Administrative	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimine Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE për mjedisin dhe komunitetin Donacione dhe partneritete private Projekte komunitare dhe NGO	Sipërfaqja e parkut të krijuar/rehabilituar Nr. tavolinave dhe zonave të piknikut Nr. këndeve të lojërave të instaluara	Afatgjatë						JO

Zhvillimi i pikës panoramike në kodrën e Harburit ku të ofrohet shërbim vëzhgim me dylbi apo teleskop.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike Struktura e ngarkuar për e Mjedisit Struktura e ngarkuar për Zhvillimin urban Njësia Administrative përkatëse	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Partneritete publike-private (PPP) Donacione dhe grante mjedisore	Pika panoramike e krijuar dhe funksionale Nr. pajisjeve vëzhguese të instaluara Nr. tabelave informuese të vendosura	Afatgjatë					Po
Zhvillimi I banjave termale në Njësinë Administrative Kolonjë dhe në Njësinë Administrative Karbunarë, si destinacione turistike lokale.	Sipas studimit/projektit	##########	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Donatorë ndërkombëtarë (BE, Kfë, UNDP) Partneritete Publike–Private (PPP) Investime private në sektorin ëellness	Nr. qendrave/zonave termale të rehabilituara Nr. strukturave mbështetëse të ndërtuara	Afatgjatë					JO

Zhvillimi I shtigjet natyrore të biçikletave. - Pranë liqenit të Kasharajt - Fshatin Allprenaj-Shegas Golem - Pergjate Perroit të Qytetit	Sipas studimit/projektit	Bashkia Lushnje Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Mjedisin Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE për turizëm dhe mjedis Donatorë ndërkombëtarë (BE, Kfë, UNDP) Partneritete publike-private	Km shtigjesh të krijuara ose rehabilituara Nr. itinerareve të sinjalizuara Nr. pikave të pushimit të ndërtuara	Afatgjatë						JO
Zhvillimi I aktiviteteve rekreative turistike aeronautika në kodrën e Ballagatit (në të cilën ofrohet mundësia për pistë për deltaplanet).	Sipas studimit/projektit	Bashkia Lushnje Struktura e ngarkuar për Turizmin Struktura e ngarkuar për Kulturën Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Shërbimeve Publike Struktura e ngarkuar për Planifikimit të Territorit Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) Programet IPA / BE Partneritete Publike–Private (PPP)	Zona e përshtatur për fluturime e funksionale Nr. eventeve sportive aeronautike të organizuara	Afatgjatë						JO
Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike											
O.2.P1. Programi për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, Transportit Publik dhe aksesit.											
Ndërtimi I stacionit Multimodal për transportin publik lokal dhe interurbantë qytetit të Lushnjes.	1 000 000 000	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE për transport dhe turizëm Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Nr. linjave të reja të krijuara Nr. autobusëve në funksion Nr. përdoruesve të regjistruar në sistem	Afatshkurtër – Afatmesëm						Jo

			Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private								
Vlerësimi, dhe zhvillimi i një rrjetit efikas të transportit publik urban dhe ndër urban miqësor me mjedisin dhe lehtësisht të aksesueshëm nga përdoruesit me aftësi të kufizuara. (Vendosja e linjave të autobusëve me frekuenca të rregullta dhe integrim të tarifave për grupet e cenueshme.)	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE për transport të qëndrueshëm Institucione financiare ndërkombëtare Partneritete publike-private (PPP)	Nr. linjave të reja të krijuara Nr. autobusëve ekologjikë në funksion Nr. stacioneve të ndërtuara/rehabilituara Nr. përdoruesve të regjistruar në sistem	Afatshkurtër – Afatmesëm						PO
Zhvillimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi sinjalistikës rrugore dhe pikave të interesit turistik.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike	Buxheti i Bashkisë Fondet IPA / BE për transport dhe turizëm Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private	Nr. shenjave rrugore të vendosura/rehabilituara Nr. tabelave turistike të instaluara Km rrugë me sinjalistikë të përmirësuar Nr. pikave turistike të sinjalizuara	Afatshkurtër – Afatmesëm						PO

Projektim, rikonstrusioni dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku përfshihet përmirësimi i cilësisë së ndriçimit dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Shërbimeve Publike Struktura e ngarkuar për Mjedisin	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private	Km rrugë të rikonstruktuara dhe të zgjeruara Nr. ndriçuesve LED të instaluar Nr. pemëve të mbjella përgjatë rrugëve Km rrugë me standarde të përmirësuara	Afatshkurtër – Afatmesëm						po
Rikonstruksioni i rrugëve rurale dhe periferike dytësore të amortizuara për të siguruar akses më të mirë dhe siguri në qarkullim.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike Njësitë Administrative përkatëse	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE Fondi Shqiptar i Zhvillimit Donatorë ndërkombëtarë	Km rrugë të rikonstruktuara Nr. segmenteve të përmirësuara Nr. fshatrave të lidhura me rrugë të standardizuara	Afatshkurtër – Afatmesëm						po
Vlerësimi, projektimi dhe Investime për përmirësimin e sigurisë në kryqëzime dhe mbikalime (ndërtim/modernizim i mbikalimeve dhe rregullimi i kryqëzimeve kritike për uljen e aksidenteve.)	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Transportin Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Policia Bashkiake dhe bashkëpunim me Policinë Rrugore	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE për transport dhe siguri rrugore Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike	Nr. kryqëzimeve të rehabilituara Nr. mbikalimeve/nënkalimeve të ndërtuara Km rrugë me sinjalistikë të përmirësuar Nr. zonave me ndriçim të ri	Afatshkurtër – Afatmesëm						PO

Projektim dhe rikonstruksioni i rrugës historiko-kulturore të Manastirit të Ardenicës dhe pajisja me korsinë e dedikuar të biçikletave në mbështetje të turizmit.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Turizmin	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE për turizëm dhe transport të gjelbër Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private	Km rrugë të rikonstruktuara Km korsie biçikletash të ndërtuara Nr. tabelave dhe sinjalistikës turistike Nr. pikave panoramike të krijuara	Afatshkurtër – Afatmesëm						po
Zhvillimi dhe ndërtimi i korsive dhe rrugëve të dedikuara për biçikleta dhe trotuare të sigurta në zonat urbane dhe në qendrat rurale.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike	Buxheti i Bashkisë Fondet IPA / BE për transport të gjelbër Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private	Km korsish biçikletash të ndërtuara Km trotuare të rehabilituara Nr. pikave të parkimit për biçikleta Nr. zonave të përfshira në projekt	Afatmesëm – Afatgjatë						PO
Identifikimi dhe rikonstruktimi i rrugëve peizazhistike vernakolare dhe pajisja me sinjalistikën dhe ndriçimin rrugor.	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban Struktura e ngarkuar për Turizmin	Buxheti i Bashkisë Fondet IPA / BE për turizëm dhe trashëgimi Donatorë ndërkombëtarë Partneritete publike-private Skema për zhvillim rural dhe turizëm	Km rrugë vernakolare të identifikuara dhe të rehabilituara Nr. itinerareve turistike të krijuara Nr. tabelave dhe elementeve të sinjalistikës Nr. pikave të ndalesës dhe pushimit	Afatgjatë						po

O.2.P2. Programi i modernizimit të rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimeve dhe ujitjes.											
Vlerësimi dhe hartimi I Plani të menaxhimit per sistemin e furnizimit me uje të pijshëm dhe kanalizimet e ujrave të zeza	Sipas studimit/projektit	Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike Struktura e ngarkuar për Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	Buxheti i Bashkisë Programet IPA të Bashkimit Evropian Donatorë ndërkombëtarë Fondet kombëtare për ujësjellës-kanalizime	Plan i miratuar zyrtarisht Hartë e plotë e sistemit ujësjellës dhe kanalizimeve Investime prioritare	Afatshkurtër – Afatmesëm						Po
Rivitalizim i rrjetit të kullimit (mirëmbajtje, thellimi, pastrim, rehabilitim dhe sistemim i rrjeteve kulluese në zonat me rrezik përmbytjeje, për të përmirësuar kapacitetin e menaxhimit të ujërave sipërfaqësorë.)	Sipas studimit/projektit	Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimn Rural Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike Njësitë Administrative	Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit Fondet IPA / BE Donatorë ndërkombëtarë Skema të menaxhimit të riskut	Km kanalesh të pastruara dhe rehabilituara Nr. zonave të trajtuara me risk përmbytjeje Nr. strukturave kulluese të ndërtuara/rehabilituara Nr. sistemeve monitoruese të instaluara	Afatshkurtër – Afatmesëm						Po
Afati i zbatimit

Afatshkurtër - Afatmesëm

O.1.P3. Programi për zhvillimin e markave dhe produkteve lokale.

FISHA E PROJEKTIT - Programi për Zhvillimin e Brendimit dhe Certifikimit të Produkteve Lokale

Titulli i projektit

Programi për Zhvillimin e Brendimit dhe Certifikimit të Produkteve Lokale

Përshkrimi i projektit

Rritja e vlerës së produkteve lokale përmes krijimit të markave të identifikuara (branding) dhe certifikimit të cilësisë, origjinës dhe standardeve të prodhimit, duke forcuar konkurrueshmërinë në tregun vendas dhe ndërkombëtar.
Ky program synon të mbështesë prodhuesit lokalë, fermerët dhe NVM-të në krijimin e identitetit të produkteve të tyre përmes markave të standardizuara, paketimit profesional dhe certifikimit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
Programi do të fokusohet në:
Krijimin e markave kolektive dhe individuale për produkte lokale
Certifikimin e origjinës (p.sh. "Produkt i Lushnjes")
Certifikim të standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore
Dizajn modern të paketimit dhe etiketimit
Promovim në tregjet kombëtare dhe eksport
Formalizim dhe standardizim i zinxhirit të vlerës agro-ushqimore
Skema e mbështetjes

- Fushata informimi
- Mbështetje teknike dhe dokumentacion
- Prioritet për:
    - produkte tradicionale dhe autoktone
    - grupe prodhuesish (kooperativa, shoqata)
    - produkte me potencial eksporti

Komponentët e programit
1. Krijimi i markave lokale
    - Marka territoriale ("Made in Lushnje")
    - Marka sektoriale (produkte bujqësore, bulmet, fruta-perime)
    - Marka për produkte tradicionale artizanale
2. Certifikimi i cilësisë
    - Certifikim HACCP dhe standarde ushqimore
    - Certifikim i origjinës dhe gjurmueshmërisë
    - Mbështetje për standarde BE për eksport
3. Dizajn dhe paketim
    - Dizajn profesional i etiketave dhe paketimit
    - Paketim ekologjik dhe tërheqës për tregun
    - Standardizim i prezantimit të produktit
4. Promovim dhe treg
    - Pjesëmarrje në panaire dhe ekspozita

- Platforma digjitale për promovim
- Fushata marketingu për produktet lokale

Kosto e përafërt

5 000 0000 lekë
Fushatë informimi/ sensibilizimi
Trajnime dhe asistencë teknike, standarde Evropiane
Fushatë promovimi

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Partnerët e mundshëm

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AZHBR
Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë
Organizata ndërkombëtare (FAO, GIZ, UNDP)
Agjenci të certifikimit dhe laboratorë ushqimorë
Shoqata të prodhuesve lokalë

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet IPA dhe programet e BE
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publike-private
- Skemat kombëtare të zhvillimit rural

Indikatorët

- Nr. produkteve të certifikuara
- Nr. markave të krijuara
- Nr. prodhuesve të përfshirë në program

Afati i zbatimit

Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT - Zgjerimi dhe funksionalizimi i panairit të prodhimeve lokale si platformë e integruar e tregut

Titulli i projektit

Zgjerimi dhe Funksionalizimi i Panairit të Prodhimeve Lokale si Platformë e Integruar e Tregut

Përshkrimi i projektit

Zgjerimi i rolit të panairit të prodhimeve lokale nga një aktivitet promovues në një platformë të qëndrueshme tregu, që lidh drejtpërdrejt fermerët dhe prodhuesit lokalë me konsumatorët, tregtarët dhe rrjetet e shpërndarjes.

Ky projekt synon transformimin e panairit të prodhimeve lokale në një mekanizëm të strukturuar ekonomik dhe promovues, i cili shërben si urë lidhëse midis prodhuesve të vegjël e të mesëm dhe tregut.

Panairi do të funksionojë si:

- Platformë e përhershme promovimi dhe shitjeje për produktet lokale
- Hapësirë për lidhjen direkte fermer–konsumator
- Qendër rrjetëzimi midis prodhuesve, tregtarëve dhe operatorëve turistikë
- Platformë për promovimin e markave lokale dhe produkteve të certifikuara
- Mekanizëm për formalizimin dhe standardizimin e tregtisë lokale

Kosto e përafërt

0 lekë

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik
- Struktura e ngarkuar për Turizmin

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- AZHBR
- Shoqatat e fermerëve dhe prodhuesve
- Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë
- Sektori privat (supermarkete, restorante, hotele…)
- Organizata ndërkombëtare (FAO, GIZ, UNDP)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e zhvillimit rural dhe turizmit
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publike-private
- Skemat kombëtare të mbështetjes së bujqësisë

Indikatorët

- Nr. prodhuesve pjesëmarrës
- Nr. marrëveshjeve tregtare të krijuara

Afati i zbatimit

Afatmesëm

O.1.P4. Programi i zhvillimit të tregjeve dhe qendrave agro-logjistike.

FISHA E PROJEKTIT - Parku Bujqësor Rajonal i Integruar – Qendër Multifunksionale për Zhvillimin e Zinxhirit Agroushqimor

Titulli i projektit

Parku Bujqësor Rajonal i Integruar – Qendër Multifunksionale për Zhvillimin e Zinxhirit Agroushqimor

Përshkrimi i projektit

Krijimi i një qendre rajonale të integruar që mbështet të gjithë zinxhirin e vlerës bujqësore, nga prodhimi deri te tregtimi, përmes shërbimeve të grumbullimit, përpunimit, certifikimit, këshillimit dhe lidhjes me tregjet.

Parku Bujqësor Rajonal i Integruar synon të funksionojë si një hub agro-ekonomik modern, i cili bashkon fermerët, NVM-të agro-përpunuese, tregtarët dhe institucionet mbështetëse në një strukturë të vetme efikase.

Ky park do të shërbejë si motor zhvillimi për rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor, uljen e kostove logjistike dhe rritjen e vlerës së shtuar të produkteve lokale.

Komponentët kryesorë të parkut

1. Pika grumbullimi dhe magazinimi
   - Qendra logjistike për grumbullimin e produkteve bujqësore
   - Magazina frigoriferike dhe depo standarde
   - Sisteme gjurmueshmërie dhe menaxhimi inventari
2. Përpunim dhe ambalazhim
   - Linja të vogla dhe të mesme përpunimi agro-ushqimor
   - Ambalazhim modern dhe standardizim i produkteve
   - Përgatitje për tregun vendas dhe eksport
3. Laboratorë cilësie dhe certifikimi
   - Analiza të produkteve bujqësore dhe ushqimore
   - Monitorim i tokës dhe ujit për përdorim bujqësor
   - Certifikim i standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore
4. Treg inputesh bujqësore
   - Shpërndarje e farave, plehrave dhe inputeve moderne
   - Këshillim për përdorimin e teknologjive të reja
   - Ulje e kostove për fermerët përmes blerjeve të përbashkëta
5. Shërbime këshillimi dhe mbështetjeje
   - Këshillim agronomik dhe teknik për fermerët
   - Shërbime financiare dhe akses në kredi/grante
   - Asistencë juridike dhe formalizim biznesi
6. Ndërlidhja me tregjet
   - Platformë për kontraktim me tregtarë dhe eksportues
   - Lidhje me supermarketet
   - Integrim me platforma digjitale të tregtisë

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Struktura e kostos:

- Studimi fisibiliteti
- Hartimi i planit të biznesit;
- Projektim / Zbatim
- Administrim

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik
- Struktura e ngarkuar për Bujqësinë
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin dhe zhvillimin urban
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Partneritete publike-private

Partnerë të mundshëm

- MBZHR
- AZHBR
- BE / IPA fonde
- Donatorë ndërkombëtarë (GIZ, FAO, UNDP, AAFD)
- Laboratorë certifikimi dhe institucione kërkimore
- Sektori privat agro-përpunues dhe tregtar

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Buxheti i Shtetit
- Fondet IPA III / IPARD
- Partneritete Publike–Private (PPP)
- Investitorë privatë në agro-industrinë
- Donatorë ndërkombëtarë

Indikatorët e suksesit

- Nr. fermerëve dhe NVM-ve të shërbyera
- Ton produkte të grumbulluara dhe të përpunuara
- Nr. analizave laboratorike të kryera
- Nr. kontratave tregtare të lidhura

Afati i zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm – Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT - Rehabilitimi dhe modernizimi i tregjeve lokale në qendrat e njësive administrative

Titulli i projektit

Rehabilitimi dhe Modernizimi i Tregjeve Lokale në Qendrat e Njësive Administrative

Përshkrimi i projektit

Përmirësimi i infrastrukturës së tregjeve lokale në njësitë administrative, duke krijuar hapësira të sigurta, higjienike dhe funksionale për tregtimin e produkteve bujqësore dhe artizanale, si dhe formalizimi i tregtisë lokale.

Ky projekt synon rehabilitimin e tregjeve ekzistuese dhe/ose krijimin e tregjeve të reja në qendrat e njësive administrative, me qëllim rritjen e aksesit të fermerëve në treg, përmirësimin e kushteve të shitjes dhe rritjen e sigurisë ushqimore.

Tregjet do të shërbejnë si pika të rëndësishme të ekonomisë lokale dhe do të lidhen me zinxhirin e përgjithshëm të tregtisë agro-ushqimore.

Komponentët e projektit

1. Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese
   - Rikonstruksion i hapësirave të tregjeve
   - Rregullim i çative, dyshemeve dhe strukturave mbrojtëse
   - Ndriçim dhe sistem ventilimi
2. Higjiena dhe standardet e sigurisë
   - Krijimi i zonave të pastra për produkte ushqimore
   - Sisteme për ujë të pijshëm dhe kanalizime
   - Menaxhim i mbetjeve tregtare
3. Modernizimi i funksionimit
   - Stenda të standardizuara për shitësit
   - Sistem i regjistrimit të tregtarëve
   - Organizim i hapësirave sipas kategorive të produkteve
4. Lidhja me prodhuesit lokalë
   - Prioritet për fermerët vendas
   - Organizim i ditëve të prodhimeve lokale
   - Mbështetje për kooperativa dhe grupe prodhuesish

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Struktura e kostos:

- Studimi i gjendjes aktuale dhe nevojave
- Hartimi i projekteve / Zbatim

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Shërbimeve Publike
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë
- Njësitë Administrative

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- AZHBR
- Shoqatat e tregtarëve dhe fermerëve
- Organizata ndërkombëtare (FAO, GIZ, UNDP)
- Sektori privat

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e zhvillimit rural dhe rajonal
- Donatorë ndërkombëtarë (FAO, GIZ, UNDP)
- Partneritete publike–private
- Programet IPA të BE

Indikatorët

- Nr. tregjeve të rehabilituara ose të ndërtuara
- Nr. tregtarëve të regjistruar
- Nr. fermerëve pjesëmarrës

Afati i zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i pikave logjistike të integruara për zinxhirin e vlerës së produkteve bujqësore në njësitë administrative

Titulli i projektit

Zhvillimi i pikave logjistike të integruara për zinxhirin e vlerës së produkteve bujqësore në njësitë administrative

Përshkrimi i projektit

Krijimi i një rrjeti pikash logjistike të integruara në territorin e njësive administrative për të përmirësuar efikasitetin e grumbullimit, magazinimit, përpunimit, ambalazhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore, duke ulur kostot dhe humbjet pas korrjes.

Ky projekt synon asistencën dhe mbështetjen e operatorëve privat në zhvillimin e pikave logjistike lokale si nyje mbështetëse të ekonomisë bujqësore, të cilat do të shërbejnë si hallka ndërmjet fermerëve, grosistëve dhe tregjeve finale.

Pikat logjistike do të krijojnë një sistem të integruar dhe të koordinuar të zinxhirit agro-ushqimor, duke rritur konkurrueshmërinë e produkteve lokale dhe aksesin në treg.

Komponentët e projektit

1. Grumbullimi i produkteve bujqësore
   - Qendra lokale për dorëzim të produkteve nga fermerët
   - Sisteme të regjistrimit dhe gjurmueshmërisë
   - Organizim sipas llojit të produktit dhe sezonit
2. Magazinimi dhe ruajtja
   - Depo standarde dhe frigoriferike
   - Ruajtje e produkteve për të reduktuar humbjet sezonale
   - Menaxhim i stokut dhe cilësisë
3. Përpunimi dhe ambalazhimi
   - Linja të thjeshta për përpunim primar
   - Ambalazhim standard dhe i certifikuar
   - Përgatitje për tregun lokal dhe eksport
4. Shpërndarja dhe logjistika
   - Organizim i transportit drejt tregjeve lokale dhe rajonale
   - Lidhje me tregjet, supermarketet
   - Optimizim i zinxhirit të furnizimit

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Struktura e kostos:

- Evidentimi i strukturave ekzistuese në pronësi të bashkisë të cialt mund të shërbejnë si piak logjistike
- Rehabilitimi/Hartimi i projekteve / Zbatim (p.sh.: rehabilitimi i magazinave ish industriale në Njësinë Administrative Golem, dhe kthimi i tyre në pika magazinimi.)

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimit Ekonomik
- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike
- Drejtoria e Planifikimit Urban

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- AZHBR
- Operatorë privatë logjistikë dhe agro-përpunues
- Organizata ndërkombëtare (FAO, GIZ, UNDP, BE)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet IPARD dhe IPA
- Partneritete Publike–Private (PPP)
- Donatorë ndërkombëtarë
- Investime private në zinxhirin agro-ushqimor

Indikatorët

- Nr. pikave logjistike të ndërtuara/funksionale
- Ton produkte të grumbulluara dhe të përpunuara
- Nr. fermerëve të përfshirë në sistem
- Nr. kontratave tregtare të realizuara

Afati i zbatimit

Afatgjatë

O.1.P5. Programi i zhvillimit të qëndrueshëm të Turizmit

FISHA E PROJEKTIT - Krijimi i rrjetit të Qendrave të Informacionit Turistik në Bashkinë Lushnje

Titulli i projektit

Krijimi i rrjetit të Qendrave të Informacionit Turistik në Bashkinë Lushnje

Përshkrimi i projektit

Përmirësimi i shërbimeve ndaj vizitorëve dhe rritja e aksesit në informacion turistik përmes krijimit të një rrjeti të integruar qendrash informacioni.

Projekti synon krijimin e një rrjeti funksional të qendrave të informacionit turistik në pika strategjike të Bashkisë Lushnje (qendra urbane dhe zona me potencial turistik), duke përfshirë:

- Krijimin/rehabilitimin e pikave fizike të informacionit
- Pajisjen me materiale informuese (harta, guida, broshura)
- Instalimin e kioska digjitale interaktive
- Ofrimin e informacionit mbi destinacionet, akomodimin, aktivitetet dhe eventet
- Integrimin me portalin turistik të bashkisë dhe platformat online
- Trajnimin e stafit për shërbim cilësor ndaj vizitorëve
- Funksionim si pika koordinimi për operatorët turistikë lokalë

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Shpërndarja e kostove:

- Evidentimi i objekteve që mund të shërbejnë si të Qendra të Informacionit Turistik
- Studimi i fisibilitetit/projektim
- Ndërtim/rehabilitim i qendrave
- Pajisje (mobilim, IT, kioska digjitale)
- Materiale promocionale
- Trajnim staf

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për IT dhe Komunikimit
- Njësitë Administrative (menaxhim lokal)

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Operatorë turistikë dhe biznese lokale

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / BE
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Partneritete publike-private (PPP) (ne rast delegimit të menaxhimit)

Indikatorët

- Nr. qendrave të informacionit të krijuara
- Nr. materialeve promocionale të prodhuara
- Nr. stafit të trajnuar

Afati i zbatimit

Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT - Programi për mbështetjen e familjeve në fshatra me potencial turistik (bujtina, ushqim tradicional, aktivitete autentike)

Titulli i projektit

Programi për mbështetjen e familjeve në fshatra me potencial turistik (bujtina, ushqim tradicional, aktivitete autentike)

Përshkrimi i projektit

Zhvillimi i turizmit rural dhe diversifikimi i ekonomisë lokale përmes mbështetjes së familjeve që ofrojnë shërbime turistike autentike.

Programi synon identifikimin, mbështetjen financiare dhe teknike të familjeve në zonat rurale të Bashkisë Lushnje me potencial për zhvillim turistik.

Ndërhyrjet përfshijnë:

- Mbështetje për krijimin dhe përmirësimin e bujtinave
- Nxitjen e gatimit tradicional dhe produkteve lokale
- Zhvillimin e eksperiencave turistike autentike (punë bujqësore, guida lokale, aktivitete kulturore)
- Trajnime për standarde shërbimi, marketing dhe menaxhim
- Promovim në platforma turistike dhe integrim në portalin e bashkisë

Kosto e përafërt

10 000 000 lekë

Shpërndarja orientuese:

- Skema grantesh për familjet: 500 000 – 1 000 000 lekë (10-20 subjekte)
- Trajnime & asistencë teknike

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
- Struktura e ngarkuar për Turizmin dhe Kulturën
- Njësitë Administrative (identifikim dhe ndjekje në terren)

Partnerë të mundshëm

- AZHBR / Skemat Kombëtare të Bujqësisë
- Programe IPARD
- Donatorë ndërkombëtarë (GIZ, UNDP, etj.)
- Operatorë turistikë privatë

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPARD / IPA
- Donatorë ndërkombëtarë (GIZ, UNDP, etj.)
- Bashkëfinancim nga përfituesit (familjet)

Indikatorët

Nr. familjeve të mbështetura (target: 10–20)

- Nr. bujtinave të krijuara ose përmirësuara
- Nr. trajnimeve të zhvilluara
- Nr. produkteve/eksperiencave turistike të krijuara

Afati i zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i ndriçimit të monumenteve historike dhe sinjalistikës turistike

Titulli i projektit

Zhvillimi i ndriçimit të monumenteve historike dhe sinjalistikës turistike

Përshkrimi i projektit

Rritja e atraktivitetit turistik dhe aksesueshmërisë së monumenteve të trashëgimisë kulturore përmes ndriçimit dekorativ dhe informimit të strukturuar për vizitorët.

Projekti synon përmirësimin e infrastrukturës turistike kulturore përmes:

- Instalimit të ndriçimit dekorativ LED në monumente historike dhe objekte me vlera kulturore
- Vendosjes së sinjalistikës turistike të standardizuar (tabela orientuese, informuese dhe interpretative)
- Integrimit të kodeve QR për informacion digjital (histori, guida, multimedia)
- Përmirësimit të aksesit dhe orientimit për vizitorët (sidomos në zonat rurale)
- Krijimit të një identiteti vizual të unifikuar për destinacionet turistike të bashkisë

Kosto e përafërt

10 000 000 lekë
Shpërndarja orientuese:

- Ndriçimi dekorativ (pajisje + instalim): 7 mln lekë
- Sinjalistika fizike (tabela, orientim): 2 mln lekë
- Projektim & mbikëqyrje: 2 mln lekë

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike
- Struktura e ngarkuar për Turizmin dhe Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Kulturës
- Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK)
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, etj.)
- Operatorë privatë (për instalim dhe mirëmbajtje)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / projekte të BE
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publike-private (PPP) për mirëmbajtje

Indikatorët

- Nr. monumenteve të pajisura me ndriçim dekorativ
- Nr. tabelave sinjalistike të vendosura

Afati i zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i Portalit Turistik të Bashkisë Lushnje

Titulli i projektit

Zhvillimi i Portalit Turistik të Bashkisë Lushnje

Përshkrimi i projektit

Rritja e vizibilitetit dhe aksesit në informacion për ofertën turistike të Bashkisë Lushnje përmes një platforme digjitale të integruar.

Projekti synon krijimin e një platforme moderne digjitale që promovon në mënyrë të strukturuar dhe të aksesueshme potencialin turistik të bashkisë.

Portali do të përfshijë:

- Destinacionet turistike lokale (natyrë, kulturë, monumente)
- Shërbimet e akomodimit (bujtina, hotele, agroturizëm)
- Shërbimet turistike autentike (agro-turizëm, eksperienca lokale)
- Itinerare tematike turistike (hiking, trekking, biçikleta, guida kulturore)
- Hartë interaktive me pikat e interesit
- Integrim me Google Maps dhe rrjetet sociale
- Seksion për evente dhe aktivitete lokale
- Mundësi për regjistrim/promovim të bizneseve lokale
- Version shumëgjuhësh (shqip, anglisht, etj.)
- Integrim me QR kode nga sinjalistika fizike

Kosto e përafërt

2 000 000 lekë
Shpërndarja orientuese:

- Zhvillimi i platformës (ëeb): 1.2 mln lekë
- Krijimi i përmbajtjes (foto, video, tekste): 0.5 mln lekë
- Integrime teknike (harta, databaza, API): 0.3 mln lekë

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për IT dhe Inovacionin
- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Komunikimin dhe Marrëdhëniet me Publikun

Partnerë të mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Kompani IT dhe marketingu digjital
- Operatorë turistikë lokalë

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë

- Programet IPA / BE (digjitalizim & turizëm)
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete me sektorin privat (sponsorizime / reklama)

Indikatorët (Output)

- Platforma e ndërtuar dhe funksionale
- Nr. destinacioneve të publikuara
- Nr. bizneseve turistike të regjistruara
- Nr. itinerareve të krijuara

Afati i zbatimit

Afatshkurtër -Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Nxitja e zhvillimit të eko-fermave turistike në Njësitë Administrative Hysgjokaj dhe Ballagat

Titulli i projektit

Nxitja e zhvillimit të eko-fermave turistike në Njësitë Administrative Hysgjokaj dhe Ballagat

Përshkrimi i projektit

Zhvillimi i turizmit rural dhe i ekonomisë së gjelbër përmes krijimit dhe fuqizimit të eko-fermave turistike që ofrojnë produkte bio dhe eksperienca autentike për vizitorët.
Projekti synon të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e eko-fermave turistike në zonat me potencial të Hysgjokajt dhe Ballagatit, duke përfshirë:

- Mbështetje financiare për ngritjen/përmirësimin e eko-fermave
- Nxitjen e prodhimit organik dhe produkteve tradicionale
- Zhvillimin e aktiviteteve turistike në fermë (vizita, degustime, pjesëmarrje në procese bujqësore)
- Krijimin e hapësirave për akomodim rural (bujtina të vogla në fermë)
- Trajnime për standarde ekologjike, mikpritje dhe marketing
- Certifikim dhe branding si "eko-fermë turistike"
- Integrim me portalin turistik dhe rrjetin e promovimit

Skema e mbështetjes:

- Grante të vogla për eko-ferma: 500,000 – 1,000,000 lekë
- Financim deri në 50% të investimit
- Prioritet për:
    - familjet në zonat rurale me potencial turistik
    - gratë dhe të rinjtë
    - projektet me ndikim mjedisor të qëndrueshëm

Kosto e përafërt

10 000 000 lekë

Struktura e kostos:
Grante për eko-fermat: 9 mln lekë (për 10 derri me 20 Start-up)
Trajnime, Mbështetje, Asistencë, Promovim: 1 mln lekë

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Njësitë Administrative (Hysgjokaj dhe Ballagat)

Partnerë të mundshëm

- AZHBR (Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural)
- Programet IPARD
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, FAO, UNDP)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Programet IPARD / IPA
- Skemat kombëtare të bujqësisë
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, FAO, UNDP)
- Bashkëfinancim nga përfituesit (fermerët)

Indikatorët

- Nr. eko-fermave të krijuara/mbështetura
- Nr. fermerëve të trajnuar
- Nr. aktiviteteve turistike të zhvilluara në fermë

Afati i zbatimit

Afatshkurtër

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i Qendrës së Pritjes për Vizitorët në katin I të Shtëpisë Muze "Kongresi i Lushnjes"

Titulli i projektit

Zhvillimi i Qendrës së Pritjes për Vizitorët në katin I të Shtëpisë Muze "Kongresi i Lushnjes"

Përshkrimi i projektit

Përmirësimi i eksperiencës së vizitorëve dhe promovimi i potencialeve turistike të Bashkisë Lushnje përmes krijimit të një hapësire moderne informimi dhe interpretimi.
Projekti synon krijimin e një qendre pritjeje për vizitorët brenda një prej objekteve më të rëndësishme historike të qytetit, duke kombinuar trashëgiminë kulturore me promovimin e turizmit lokal. Ndërhyrjet përfshijnë:

- Rikualifikimin e katit të parë të Shtëpisë Muze
- Krijimin e një hapësire informimi dhe orientimi për turistët
- Vendosjen e paneleve informuese interaktive mbi bukuritë natyrore, destinacionet dhe aktivitetet turistike
- Instalimin e ekraneve digjitale / multimedia (video promocionale, guida virtuale)
- Ekspozim i produkteve lokale dhe materialeve promocionale
- Krijimin e një këndi për informacion mbi itineraret turistike dhe shërbimet lokale

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën
- Struktura e ngarkuar për IT dhe Komunikim

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Kulturës
- Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK)
- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / BE
- Donatorë ndërkombëtarë

Indikatorët

- Qendra e krijuar dhe funksionale
- Nr. materialeve informative dhe digjitale të zhvilluara
- Nr. stafit të trajnuar

Afati i zbatimit

Afatshkurtër

FISHA E PROJEKTIT - Mbështetje financiare për zhvillimin e shtëpive druri "hostel" në pika panoramike strategjike

Titulli i projektit

Mbështetje financiare për zhvillimin e shtëpive druri "hostel" në pika panoramike strategjike

Përshkrimi i projektit

Zgjerimi i kapaciteteve akomoduese dhe rritja e atraktivitetit turistik përmes zhvillimit të strukturave të lehta dhe ekologjike në zona panoramike të Bashkisë Lushnje.
Projekti synon të nxisë investimet në struktura akomodimi të tipit hostel prej druri, të vendosura në pika me vlerë panoramike dhe turistike, duke përfshirë:

- Mbështetje financiare (grante/bashkëfinancim) për ndërtimin e shtëpive druri
- Identifikimin e zonave strategjike panoramike për zhvillim (kodra, liqene, zona rurale)
- Standardizimin e strukturave sipas kritereve ekologjike dhe turistike
- Nxitjen e përdorimit të materialeve natyrore dhe energjive të rinovueshme
- Integrimin me shtigje turistike, aktivitete natyrore dhe itinerare ekzistuese
- Promovimin e strukturave në portalin turistik dhe rrjetet digjitale

Skema e mbështetjes:

- Grante të vogla për shtëpive druri "hostel": 1,000,000 lekë
- Financim deri në 50% të investimit
- Prioritet për:
    - familjet në zonat rurale me potencial turistik
    - gratë dhe të rinjtë
    - projektet me ndikim mjedisor të qëndrueshëm

Kosto e përafërt

10 000 000 lekë

Struktura e kostos:
Grante për shtëpive druri "hostel": 9 mln lekë (për 5 deri në 10 subjekte)
Trajnime, Mbështetje, Asistencë, Promovim: 1 mln lekë

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban dhe Zhvillimin e Territorit
- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Njësitë Administrative

Partnerë të mundshëm

- Investitorë privatë dhe sipërmarrës lokalë
- AZHBR / programet IPARD
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Agjenci turistike dhe operatorë të turizmit aventurë

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë (grante nxitëse)
- Programet IPARD / IPA
- Investime private (bashkëfinancim)
- Partneritete Publike-Private (PPP)
- Donatorë ndërkombëtarë

Indikatorët

- Nr. strukturave "hostel" të ndërtuara (target: 5–10)
- Nr. investitorëve/ përfituesve të mbështetur

Afati i zbatimit

Afatshkurtër

FISHA E PROJEKTIT - Pasqyrimi dhe promovimi i pikave të interesit turistik në internet dhe rrjetet digjitale

Titulli i projektit

Pasqyrimi dhe promovimi i pikave të interesit turistik në internet dhe rrjetet digjitale

Përshkrimi i projektit

Rritja e vizibilitetit dhe aksesueshmërisë së ofertës turistike të Bashkisë Lushnje përmes pranisë aktive dhe të strukturuar në platformat digjitale
Projekti synon identifikimin, dixhitalizimin dhe promovimin e pikave të interesit turistik në platformat kryesore online, duke përfshirë:

- Regjistrimin dhe përditësimin e destinacioneve në Google Maps dhe platforma të tjera navigimi
- Krijimin dhe menaxhimin e profileve zyrtare në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Tripadvisor, etj.)
- Publikimin e përmbajtjeve të strukturuara (foto, video, përshkrime, guida)
- Standardizimin e informacionit për çdo destinacion (orare, akses, përshkrim, koordinata)
- Integrimin me faqen zyrtare të bashkisë dhe portalin turistik
- Fushata promovimi digjital (social media marketing)
- Bashkëpunim me biznese lokale për përditësimin e të dhënave

Kosto e përafërt

1 500 000 lekë
Shpërndarja orientuese:

- Krijim dhe menaxhim përmbajtjeje: 0.5 mln lekë
- Fotografi dhe video profesionale: 0.5 mln lekë
- Marketing digjital dhe promovim: 0.5 mln lekë

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Komunikimim dhe Marrëdhënien me Publikun
- Drejtoria e IT
- Njësitë Administrative (identifikimi i pikave lokale)

Partnerë të mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Operatorë turistikë lokalë
- Influencerë dhe krijues përmbajtjeje
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, etj.)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, etj.)
- Partneritete me sektorin privat (marketing bashkëpunues)

Indikatorët

- Nr. pikave të interesit të publikuara online
- Nr. materialeve promocionale të prodhuara

Afati i zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i shtigjeve për ecje në natyrë (Hiking) me sinjalistikë dhe infrastrukturë të adaptuar

Titulli i projektit

Zhvillimi i shtigjeve për ecje në natyrë (Hiking) me sinjalistikë dhe infrastrukturë të adaptuar

Përshkrimi i projektit

Zhvillimi i turizmit natyror dhe aktiv në Bashkinë Lushnje përmes krijimit të shtigjeve të sigurta, të sinjalizuara dhe të aksesueshme për ecje dhe eksplorim të natyrës.
Projekti synon zhvillimin dhe standardizimin e dy shtigjeve kryesore turistike në territorin e bashkisë:

- **Shtegu Zgjana – Kasharaj**, me dy ndalesa panoramike dhe pushimi
- Shtegu turistik në Kodrën e Ardenicës, si itinerar natyror dhe kulturor

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Pastrimin dhe sistemimin e shtigjeve ekzistuese
- Shënjimin dhe sinjalistikën turistike orientuese dhe informuese
- Krijimin e pikave të pushimit (banka, hijezim, tabela informuese)
- Vendosjen e hartave orientuese dhe QR kodeve për informacion digjital
- Përmirësimin e aksesit dhe sigurisë së vizitorëve
- Integrimin me portalin turistik të bashkisë dhe rrjetet e promovimit

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike
- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Mjedisin
- Struktura e ngarkuar për Pyjet
- Njësitë Administrative përkatëse

Partnerë të mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (nëse aplikohet)
- Organizata mjedisore dhe hiking/outdoor
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Klube sportive dhe turizmi aventurë

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / BE
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Partneritete me sektorin privat (tur operatorë)

Indikatorët

- Km shtigje të rehabilituara dhe të sinjalizuara
- Nr. pikave të pushimit të krijuara
- Nr. tabelave orientuese dhe informative të vendosura

Afati i zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i pikës panoramike në Kodrën e Harburit me shërbime vëzhgimi (dylbi/teleskop)

Titulli i projektit

Zhvillimi i pikës panoramike në Kodrën e Harburit me shërbime vëzhgimi (dylbi/teleskop)

Përshkrimi i projektit

Krijimi i një pike turistike panoramike të pajisur me infrastrukturë të lehtë dhe shërbime vëzhgimi, me qëllim rritjen e atraktivitetit të turizmit natyror dhe eksperiencës së vizitorëve në Bashkinë Lushnje. Projekti synon zhvillimin e Kodrës së Harburit si një pikë panoramike turistike e standardizuar, duke përfshirë:

- Krijimin e një platforme panoramike të sigurt për vizitorët
- Instalimin e dylbive dhe/ose teleskopëve vëzhgues për peizazhin natyror
- Vendosjen e sinjalistikës informuese mbi zonën dhe pamjet përreth
- Ndërtimin e infrastrukturës së lehtë (banka, hijezim, ndalesa pushimi)
- Ndriçim të lehtë dhe elemente sigurie
- Integrim me itineraret turistike dhe portalin digjital të bashkisë
- Promovim si destinacion për turizëm ditor dhe fotografik

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike
- Struktura e ngarkuar për e Mjedisit
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimin urban
- Njësia Administrative përkatëse

Partnerë të mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Operatorë turistikë dhe kompani të pajisjeve optike
- Organizata të turizmit natyror dhe aventurës

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / BE
- Donatorë ndërkombëtarë
- Sponsorizime private (BE, GIZ, UNDP)
-

Indikatorët (Output)

- Pika panoramike e krijuar dhe funksionale
- Nr. pajisjeve vëzhguese të instaluara
- Nr. tabelave informuese të vendosura

Afati i zbatimit

Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i rezervuarit të Kasharit si destinacion turistik dhe rekreativ (Njësia Administrative Karbunarë)

Titulli i projektit

Zhvillimi i rezervuarit të Kasharit si destinacion turistik dhe rekreativ (Njësia Administrative Karbunarë)

Përshkrimi i projektit

Shndërrimi i rezervuarit të Kasharit në një hapësirë multifunksionale turistike dhe rekreative, duke rritur vlerën e tij ekonomike, mjedisore dhe sociale për komunitetin lokal.
Projekti synon rehabilitimin dhe zhvillimin e zonës së rezervuarit të Kasharit si një destinacion turistik i qëndrueshëm, duke përfshirë ndërhyrje infrastrukturore dhe mjedisore për aktivitete rekreative.
Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Pastrimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës së rezervuarit
- Krijimi i shëtitoreve rreth rezervuarit
- Ndërtimi i zonave të pushimit (banka, hijezim, pika pikniku)
- Krijimi i hapësirave për aktivitete rekreative (peshkim, kanoe, vëzhgim natyre)
- Vendosja e sinjalistikës turistike dhe informuese
- Ndriçim i zonës për përdorim ditor dhe të pjesshëm në mbrëmje
- Krijimi i një pike të vogël shërbimi (kioskë/info point)
- Integrimi me rrjetin e shtigjeve dhe pikave turistike të bashkisë

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Mjedisin
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimin e Territorit
- Struktura e ngarkuar për Turizmin
- Struktura e ngarkuar për Kulturën
- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike
- Njësia Administrative Karbunarë

Partnerë të mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (nëse aplikohet)
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, GIZ, UNDP)
- Organizata mjedisore dhe turistike
- Operatorë privatë për menaxhimin e shërbimeve

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / BE
- Partneritete publike-private (PPP)
- Donacione dhe grante mjedisore

Indikatorët

- Sipërfaqja e rehabilituar rreth rezervuarit
- Nr. zonave rekreative të krijuara
- Nr. sinjalistikave të vendosura

Afati i zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Rehabilitimi dhe vënia në funksion e pishinës jofunksionale gjatë gjithë vitit (edhe në periudhën e dimrit)

Titulli i projektit

Rehabilitimi dhe vënia në funksion e pishinës jofunksionale gjatë gjithë vitit (edhe në periudhën e dimrit)

Përshkrimi i projektit

Rikthimi në funksion i pishinës ekzistuese për përdorim sportiv, rekreativ dhe social gjatë gjithë vitit, duke e shndërruar në një infrastrukturë të qëndrueshme për aktivitet fizik dhe shërbime komunitare.

Projekti synon rehabilitimin e pishinës jofunksionale dhe përshtatjen e saj për përdorim gjatë gjithë vitit, përmes ndërhyrjeve infrastrukturore dhe teknike që mundësojnë ngrohjen dhe mirëmbajtjen e standardeve higjieno-sanitare.

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Rikonstruksion i strukturës ekzistuese të pishinës (basen, hidroizolim, sistem filtrimi)
- Instalimi i sistemit të ngrohjes së ujit (për përdorim dimëror)
- Përmirësimi i sistemit të filtrimit dhe trajtimit të ujit sipas standardeve
- Rehabilitimi i ambienteve ndihmëse (dush, zhveshtore, tualete)
- Krijimi i hapësirave për spektatorë dhe aktivitet rekreativ
- Përmirësimi i sistemit elektrik dhe ndriçimit
- Masa sigurie dhe aksesueshmërie për të gjitha grupmoshat
- Krijimi i modelit të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së objektit

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike
- Struktura e ngarkuar për Rininë dhe Sportin
- Struktura e ngarkuar për Shëndetit Publik
- Njësia Administrative përkatëse

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Federata e Notit në Shqipëri
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, KfË, UNDP)
- Partneritet Publik – privat (PPP)
- Klube sportive dhe organizata rinore

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)
- Programet IPA / BE
- Partneritete Publike–Private (PPP)
- Donacione dhe grante sportive

Indikatorët

- Pishina e rehabilituar dhe funksionale
- Sistem ngrohjeje i instaluar
- Kapaciteti i përdorimit ditor të objektit

Afati i zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Restaurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore në Bashkinë Lushnje

Titulli i projektit

Restaurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore në Bashkinë Lushnje

Përshkrimi i projektit

Objektet e përfshira

- Kisha e Shën Kollit, fshati Krutje e Sipërme
- Kisha e Shën Mërisë, fshati Bishqethëm (Njësia Administrative Kolonjë)
- Kisha e Shën Kollit, fshati Toshkëz (Njësia Administrative Allkaj)

Mbrojtja, restaurimi dhe valorizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore fetare si pjesë e identitetit historik dhe zhvillimit të turizmit kulturor në Bashkinë Lushnje.
Projekti synon ndërhyrje restauruese dhe mirëmbajtëse në tre objekte të trashëgimisë kulturore, me qëllim ruajtjen e autenticitetit arkitektonik dhe rritjen e aksesueshmërisë për vizitorët dhe komunitetin.

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Restaurimi i strukturave arkitektonike (mure, çati, themele)
- Konsolidimi i elementeve dekorative dhe ikonografike
- Pastrimi dhe konservimi i afreskeve dhe ikonave (ku aplikohet)
- Përmirësimi i aksesit dhe infrastrukturës për vizitorët
- Vendosja e sinjalistikës informative historike dhe turistike
- Ndriçim i jashtëm për evidentim të objekteve
- Krijimi i kushteve minimale për vizita turistike të organizuara
- Hartimi i planeve të mirëmbajtjes periodike

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Kulturën dhe Trashëgiminë Kulturore
- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Territorin
- Struktura e ngarkuar për Turizmin dhe Promovimin
- Njësitë Administrative përkatëse (Krutje, Kolonjë, Allkaj)

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Kulturës
- Instituti i Monumenteve të Kulturës
- Kisha Autoqefale Orthodokse e Shqipërisë (kur aplikohet)
- UNESCO / programe kulturore të BE-së
- Organizata të trashëgimisë kulturore (ICOMOS, etj.)

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë

- Ministria e Kulturës
- Fondet IPA / BE
- Donatorë ndërkombëtarë (UNESCO, GIZ, AADF)
- Partneritete publike–private për turizëm kulturor

Indikatorët (Output)

- Nr. objekteve të restauruara
- Sipërfaqja e ndërhyrjeve restauruese
- Nr. tabelave informuese të vendosura

Afati i zbatimit

Afatmesëm

Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike

O.2.P1. Programi për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, Transportit Publik dhe aksesit.

FISHA E PROJEKTIT - Vlerësimi, Projektimi dhe Investime për Përmirësimin e Sigurisë në Kryqëzime dhe Mbikalime

Titulli i projektit

Vlerësimi, Projektimi dhe Investime për Përmirësimin e Sigurisë në Kryqëzime dhe Mbikalime

Përshkrimi i projektit

Reduktimi i aksidenteve rrugore dhe rritja e sigurisë për përdoruesit e rrugës (automjete, këmbësorë, biçikleta) përmes ndërhyrjeve të targetuara në kryqëzimet dhe mbikalimet me risk të lartë në territorin e Bashkisë Lushnje

Projekti synon një qasje të integruar që fillon me analizën e pikave të rrezikut dhe vijon me projektimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve infrastrukturore dhe sinjalistike për përmirësimin e sigurisë rrugore.

Komponentët e projektit
1. Vlerësimi i sigurisë rrugore
   - Identifikimi i kryqëzimeve dhe segmenteve me aksidente të shpeshta
   - Analizë e të dhënave të aksidenteve dhe fluksit të trafikut
   - Audit i sigurisë rrugore sipas standardeve kombëtare/BE
2. Projektimi teknik
   - Hartimi i projekteve për rikonfigurimin e kryqëzimeve
   - Projektim i mbikalimeve dhe nënkalimeve për këmbësorë
   - Studime për rrethrrotullime, semaforizim dhe ndriçim
3. Ndërhyrje infrastrukturore
   - Ndërtim dhe modernizim i mbikalimeve/nënkalimeve
   - Transformim i kryqëzimeve në rrethrrotullime ku është e nevojshme
   - Vendosje e barrierave mbrojtëse dhe elementeve të sigurisë
4. Sinjalistika dhe ndriçimi
   - Sinjalistikë horizontale dhe vertikale sipas standardeve
   - Ndriçim i përmirësuar në kryqëzime dhe zona urbane
   - Sisteme paralajmëruese dhe kufizimi shpejtësie
5. Masa të sigurisë për përdoruesit vulnerabël
   - Kalime të sigurta për këmbësorë
   - Korsitë për biçikleta në zonat urbane
   - Kalime pranë shkollave dhe qendrave të banuara

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën dhe Transportin
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban
- Policia Bashkiake dhe bashkëpunim me Policinë Rrugore

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)
- Policia e Shtetit (Policia Rrugore)
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, BERZH, Banka Botërore)
- Konsulentë dhe studio projektimi

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Buxheti i Shtetit
- Fondet IPA / BE për transport dhe siguri rrugore
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publike

Indikatorët

- Nr. kryqëzimeve të rehabilituara
- Nr. mbikalimeve/nënkalimeve të ndërtuara
- Km rrugë me sinjalistikë të përmirësuar
- Nr. zonave me ndriçim të ri

Afati i zbatimit

Afatshkurtër -Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Zhvillimi i një Rrjeti Efikas, të Gjelbër dhe të Aksesueshëm të Transportit Publik Urban dhe Ndërurban

Titulli i projektit

Zhvillimi i një Rrjeti Efikas, të Gjelbër dhe të Aksesueshëm të Transportit Publik Urban dhe Ndërurban

Përshkrimi i projektit

Krijimi i një sistemi transporti publik të qëndrueshëm, efikas dhe gjithëpërfshirës, që redukton ndotjen, përmirëson lëvizshmërinë dhe garanton akses të barabartë për të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e cenueshme

Projekti synon vlerësimin dhe riorganizimin e sistemit aktual të transportit publik, si dhe zhvillimin e një rrjeti të ri modern që përfshin:

- Linja urbane dhe ndërurbane të strukturuara dhe me frekuencë të rregullt
- Autobusë ekologjikë (elektrikë ose me emetime të ulëta)
- Infrastrukturë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit
- Sistem të integruar tarifash dhe menaxhimi digjital

Komponentët e projektit

1. Vlerësimi dhe planifikimi i rrjetit
   - Analizë e kërkesës dhe flukseve të udhëtarëve
   - Hartimi i linjave optimale urbane dhe ndërurbane
   - Planifikim i orareve dhe frekuencave (intervale fikse)
   - Identifikim i pikave kyçe (stacione, terminale)
2. Zhvillimi i flotës së transportit
   - Futja e autobusëve elektrikë / hibridë
   - Modernizimi i flotës ekzistuese
   - Standarde për aksesueshmëri (rampa, hapësira për karrige me rrota)
3. Infrastrukturë mbështetëse
   - Ndërtim dhe rehabilitim i stacioneve të autobusëve
   - Sinjalistikë dhe informim për pasagjerët
   - Ndërlidhje me terminalin ndërurbane
4. Aksesueshmëria dhe përfshirja sociale
   - Platforma dhe mjete të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara
   - Ulje tarifash për studentë, të moshuar dhe kategori në nevojë
   - Informacion i aksesueshëm (audio/visual)
5. Sistemi i tarifimit dhe digjitalizimi
   - Integrim i tarifave (biletë e vetme për disa linja)
   - Kartë elektronike ose aplikacion për pagesë
   - Monitorim në kohë reale i autobusëve
6. Menaxhimi dhe operimi
   - Model i menaxhimit publik ose PPP
   - Kontrata shërbimi me operatorë privatë
   - Monitorim i performancës dhe cilësisë së shërbimit

Kosto e përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Transportin dhe Infrastrukturën
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban
- Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike

Partnerë të mundshëm

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Bashki fqinje për linjat ndërurbane
- Operatorë privatë transporti
- Donatorë ndërkombëtarë (BE, BERZH, Banka Botërore)
- Kompani teknologjie dhe mobiliteti

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Buxheti i Shtetit
- Fondet IPA / BE për transport të qëndrueshëm
- Institucione financiare ndërkombëtare
Projekti synon të rrisë përfshirjen aktive të të moshuarve në jetën komunitare, duke shfrytëzuar përvojën dhe njohuritë e tyre për të kontribuar në zhvillimin social dhe edukimin e brezit të ri.
Ndërhyrja do të përfshijë:

- Organizimin e aktiviteteve komunitare (klube sociale, aktivitete kulturore dhe artistike, evente ndërbreznore);
- Programe trajnimi për të moshuarit në aftësi të reja (p.sh. përdorimi i teknologjisë, komunikimi, mentoring);
- Krijimin e një skeme mentoringu ku të moshuarit ndajnë eksperiencën me të rinjtë (zanate, sipërmarrje, vlera sociale);
- Bashkëpunim me shkolla dhe qendra rinore për aktivitete të përbashkëta;
- Fushata ndërgjegjësimi për promovimin e rolit aktiv të të moshuarve në komunitet.

Projekti kontribuon në përmirësimin e mirëqenies së të moshuarve, reduktimin e izolimit social dhe forcimin e lidhjeve ndërbreznore.

Kosto e Përafërt

1 500 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Shërbimet Sociale
- Struktura e ngarkuar për Kulturën, Rininë dhe Sportet
- Njësitë Administrative

Partnerët e Mundshëm

- Organizata të shoqërisë civile që punojnë me të moshuarit dhe të rinjtë
- Shkolla dhe institucione arsimore
- Qendra komunitare dhe sociale
- Donatorë ndërkombëtarë (p.sh. UNDP, organizata të zhvillimit social)
- Biznese lokale (në kuadër të përgjegjësisë sociale)
- Vullnetarë dhe grupe rinore

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e donatorëve ndërkombëtarë
- Programet kombëtare për përfshirje sociale dhe aktive të të moshuarve
- Partneritete publiko-private (PPP në shkallë të vogël)

Indikatorët

- Numri i të moshuarve të angazhuar në aktivitete
- Numri i aktiviteteve të organizuara
- Numri i të rinjve të përfshirë në programe mentoringu

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Program subvencionimi për çerdhet dhe kopshtet për fëmijët e familjeve në nevojë dhe nënave kryefamiljare

Titulli i Projektit

Program subvencionimi për çerdhet dhe kopshtet për fëmijët e familjeve në nevojë dhe nënave kryefamiljare

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon të lehtësojë aksesin e fëmijëve nga familjet me të ardhura të ulëta dhe të nënave kryefamiljare në shërbimet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (çerdhe dhe kopshte), duke ulur barrën financiare dhe duke nxitur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.
Ndërhyrja do të përfshijë:

- Subvencionimin e plotë ose të pjesshëm të tarifave për çerdhet dhe kopshtet publike dhe/ose private të licencuara;
- Prioritizimin e familjeve në nevojë, nënave kryefamiljare dhe familjeve me shumë fëmijë;
- Krijimin e një skeme të qartë aplikimi dhe përzgjedhjeje transparente;
- Bashkëpunim me institucionet arsimore dhe sociale për identifikimin e përfituesve;
- Monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara;
- Fushata informimi për ndërgjegjësimin e prindërve mbi rëndësinë e edukimit parashkollor.

Projekti kontribuon në rritjen e përfshirjes në edukimin parashkollor, uljen e varfërisë dhe fuqizimin ekonomik të familjeve.

Kosto e Përafrt

2 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkaur për Arsimin
- Struktura e ngarkaur për Shërbimet Sociale
- Struktura e ngarkaur për Financat

Partnerët e Mundshëm

- Institucionet publike dhe private të edukimit parashkollor
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Organizata të shoqërisë civile që punojnë me familjet në nevojë
- Donatorë ndërkombëtarë (p.sh. UNICEF, UNDP)
- Njësitë Administrative dhe qendrat komunitare

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Transferta nga buxheti i shtetit për arsimin parashkollor
- Fondet e donatorëve ndërkombëtarë
- Skema të përbashkëta financimi (bashki + donatorë)

Indikatorët

- Numri i fëmijëve përfitues nga subvencionet
- Numri i nënave kryefamiljare të mbështetura
- Përqindja e përfituesve nga familje me të ardhura të ulëta

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT - Programi i strehimit për çiftet e reja (subvencionimi i banesave sociale për çiftet nën 35 vjeç)

Titulli i Projektit

Programi i strehimit për çiftet e reja (subvencionimi i banesave sociale për çiftet nën 35 vjeç)

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon të mbështesë çiftet e reja në sigurimin e një strehimi të përballueshëm, duke reduktuar barrën financiare dhe duke nxitur stabilitetin familjar dhe qëndrimin e të rinjve në territorin e Bashkisë Lushnje.
Ndërhyrja do të përfshijë:

- Subvencionimin e qirasë për çiftet e reja;
- Lehtësira për përfitimin e banesave sociale (me qira ose me kosto të ulët);
- Mbështetje për kreditim të butë (në bashkëpunim me institucione financiare);
- Vendosjen e kritereve të qarta për përzgjedhjen e përfituesve (mosha, të ardhurat, statusi familjar);
- Prioritizimin e çifteve ku të dy partnerët janë të punësuar në territorin e bashkisë;
- Integrimin e programit me politikat e punësimit dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Projekti kontribuon në përmirësimin e aksesit në strehim, frenimin e emigracionit të të rinjve dhe zhvillimin e qëndrueshëm demografik.

Kosto e Përafërt

5 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Strehimin dhe Shërbimet Sociale
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimin Ekonomik
- Struktura e ngarkuar për Financat

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Banka dhe institucione financiare
- Agjencia Kombëtare e Strehimit
- Donatorë ndërkombëtarë (p.sh. BE, UNDP)
- Sektori privat (ndërtues dhe zhvillues imobiliarë)

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Programet kombëtare të strehimit social
- Fondet e Bashkimit Europian (IPA, programe për zhvillim urban)
- Partneritete publiko-private

Indikatorët

- Numri i çifteve të reja përfituese
- Numri i banesave sociale të vëna në dispozicion

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

O.3.P4. Programi për migrantët të kthyer dhe disapora.

FISHA E PROJEKTIT – Zhvillimi i një platforme dixhitale informuese dhe interaktive për emigrantët dhe diasporën

Titulli i Projektit

Zhvillimi i një platforme dixhitale informuese dhe interaktive për emigrantët dhe diasporën

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon krijimin e një platforme dixhitale të integruar që do të shërbejë si një pikë unike informacioni dhe komunikimi për emigrantët që dëshirojnë të kthehen në Lushnje dhe për diasporën që dëshiron të investojë apo të angazhohet në zhvillimin lokal.
Platforma do të ofrojë:

- Informacion mbi mundësitë e punësimit, investimeve dhe sipërmarrjes në Bashkinë Lushnje;
- Udhëzime praktike për kthimin (procedura administrative, dokumentacioni, shërbime publike);
- Informacion mbi programet mbështetëse (grante, subvencione, financime);
- Hapësirë interaktive për komunikim me administratën lokale dhe aktorë të tjerë;
- Regjistër të diasporës dhe profilizim të aftësive profesionale;
- Promovim të historive të suksesit dhe mundësive lokale;
- Integrim me rrjete sociale dhe shërbime ekzistuese elektronike.

Projekti synon të nxisë rikthimin e emigrantëve, rritjen e investimeve nga diaspora dhe forcimin e lidhjeve ekonomike dhe sociale me territorin.

Kosto e Përafërt

2 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Teknologjinë së Informacionit
- Struktura e ngarkuar për Zhvillimin Ekonomik
- Struktura e ngarkuar për Marrëdhënien me Publikun / Diasporën

Partnerët e Mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (për diasporën)
- Organizata të diasporës shqiptare
- Donatorë ndërkombëtarë (p.sh. GIZ, UNDP, BE)
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e donatorëve ndërkombëtarë
- Programet e BE-së për digjitalizimin dhe diasporën
- Partneritete publiko-private

Indikatorët

- Numri i përdoruesve të platformës
- Numri i emigrantëve të interesuar për kthim
- Numri i investimeve/ideve të biznesit të gjeneruara nga diaspora

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT – Program i integruar për mbështetjen e kthimit dhe riintegrimit të emigrantëve

Titulli i Projektit

Program i integruar për mbështetjen e kthimit dhe riintegrimit të emigrantëve

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon të lehtësojë kthimin dhe riintegrimin e emigrantëve dhe familjeve të tyre në Bashkinë Lushnje, duke adresuar sfidat ekonomike, sociale dhe kulturore që shoqërojnë këtë proces.
Ndërhyrja do të përfshijë një paketë të integruar shërbimesh:

- Mbështetje për integrimin në tregun e punës (ndërmjetësim punësimi, trajnime profesionale, orientim karriere);
- Mbështetje për hapjen e bizneseve (këshillim, grante fillestare, lehtësira administrative);
- Programe për integrimin e fëmijëve emigrantë në sistemin arsimor (mbështetje në gjuhën shqipe, aktivitete kulturore dhe sociale);
- Shërbime sociale dhe psikologjike për familjet e rikthyera;
- Informim dhe asistencë për procedurat administrative dhe aksesin në shërbime publike;
- Koordinim me strukturat arsimore dhe komunitare për përshtatjen kulturore dhe sociale.

Projekti synon të nxisë rikthimin e qëndrueshëm, të rrisë kontributin ekonomik të emigrantëve dhe të përmirësojë integrimin social të familjeve të tyre.

Kosto e Përafërt

5 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Zhvillimin Ekonomik
- Struktura e ngarkuar për Shërbimet Sociale
- Struktura e ngarkuar për Arsimin

Partnerët e Mundshëm

- Agjenci kombëtare të punësimit
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Organizata të shoqërisë civile
- Donatorë ndërkombëtarë (p.sh. UNDP, IOM, GIZ, BE)
- Institucione arsimore dhe qendra formimi profesional
- Biznese lokale dhe dhoma tregtie

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e donatorëve ndërkombëtarë
- Programet kombëtare për emigracionin dhe punësimin
- Fondet e Bashkimit Europian (IPA, programe për migracionin dhe zhvillimin)

Indikatorët

- Numri i emigrantëve të rikthyer të përfshirë në program
- Numri i bizneseve të reja të hapura nga emigrantë

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

Objektivi 4: Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

O.4.P1. Programi për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

FISHA E PROJEKTIT – Hartimi dhe rishikimi i Strategjisë Vendore dhe Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Titulli i Projektit

Hartimi dhe rishikimi i Strategjisë Vendore dhe Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon hartimin dhe/ose përditësimin e një strategjie dhe plani të integruar për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Lushnje, duke përfshirë mbetjet urbane, bujqësore dhe të rrezikshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet e Bashkimit Europian.
Ndërhyrja do të përfshijë:

- Analizën e gjendjes ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve;
- Hartimin e objektivave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për reduktimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve;
- Identifikimin dhe hartëzimin e pikave problematike të ndotjes (hotspot-e mjedisore);
- Projektimin e sistemeve për ndarjen në burim të mbetjeve;
- Planifikimin e logjistikës së mbledhjes, transportit dhe trajtimit;
- Propozimin e zgjidhjeve për riciklim dhe ekonominë qarkulluese;
- Përfshirjen e komunitetit dhe aktorëve lokalë për ndërgjegjësim dhe pjesëmarrje aktive;
- Hartimin e një plani veprimi të detajuar me kosto dhe afate.

Projekti synon përmirësimin e cilësisë së mjedisit, rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike dhe afrimin me standardet europiane të menaxhimit të mbetjeve.

Kosto e Përafërt

3 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkaur për Mjedisin dhe Menaxhimin e Mbetjeve
- Struktura e ngarkaur për Planifikimin Urban

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Organizata ndërkombëtare (p.sh. GIZ, UNDP, BE)
- Universitete dhe institute kërkimore
- Kompani të menaxhimit të mbetjeve dhe riciklimit
- Organizata të shoqërisë civile dhe komuniteti lokal

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e donatorëve ndërkombëtarë
- Programet e Bashkimit Europian (IPA, Green Agenda)
- Fondet kombëtare për mjedisin

Indikatorët

- Hartimi dhe miratimi i strategjisë dhe planit

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër

FISHA E PROJEKTIT – Studim fizibiliteti për diferencimin e mbetjeve urbane në zona urbane dhe rurale

Titulli i Projektit

Studim fizibiliteti për diferencimin e mbetjeve urbane në zona urbane dhe rurale

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon realizimin e një studimi fizibiliteti për vendosjen dhe funksionimin e një sistemi të diferencuar të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lushnje, duke marrë në konsideratë specifikat e zonave urbane dhe rurale.
Studimi do të analizojë mundësinë për:

- Vendosjen e koshave/kontejnerëve të ndarë për fraksione të ndryshme (letër/karton, plastikë, metal, qelq, mbetje organike);
- Organizimin e një sistemi të diferencuar të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve;
- Përshtatjen e modeleve sipas densitetit të popullsisë dhe tipologjisë së zonave;
- Identifikimin e rrugëve optimale të transportit dhe logjistikës;
- Vlerësimin e kostove dhe përfitimeve ekonomike dhe mjedisore;
- Analizën e tregut për riciklim dhe përpunim të mbetjeve;
- Vlerësimin e gatishmërisë së komunitetit dhe nevojave për ndërgjegjësim;
- Hartimin e skenarëve të zbatimit (pilotim dhe shtrirje graduale).

Studimi do të shërbejë si bazë për investime konkrete dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me praktikat më të mira europiane.

Kosto e Përafërt

1 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e Ngarkuar për Mjedisin dhe Menaxhimin e Mbetjeve
- Struktura e Ngarkuar për Planifikimit dhe Shërbimeve Publike

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Donatorë ndërkombëtarë (p.sh. GIZ, UNDP, BE)
- Universitete dhe ekspertë të mjedisit
- Kompani të menaxhimit të mbetjeve dhe riciklimit
- Organizata të shoqërisë civile

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e donatorëve ndërkombëtarë
- Programet e Bashkimit Europian (IPA, Green Agenda)
- Fondet kombëtare për mjedisin

Indikatorët

- Realizimi i studimit të fizibilitetit

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

O.4.P2. Programi për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe burimeve ujore.

FISHA E PROJEKTIT – Program për modernizimin e sistemit të ujitjes dhe rritjen e eficiencës së përdorimit të ujit në bujqësi

Titulli i Projektit

Program për modernizimin e sistemit të ujitjes dhe rritjen e eficiencës së përdorimit të ujit në bujqësi

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon të mbështesë modernizimin e sistemeve të ujitjes në sektorin bujqësor të Bashkisë Lushnje, përmes lehtësirave financiare dhe asistencës teknike për fermerët që investojnë në teknologji me eficiencë të lartë të përdorimit të ujit.
Ndërhyrja fokusohet në kalimin nga sistemet tradicionale të ujitjes drejt metodave moderne dhe të menaxhimit inteligjent të ujit, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit bujqësor dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Subvencionim i investimeve për sisteme ujitjeje me eficiencë të lartë (ujitje pikë-pikë, mikroujitje, sisteme të automatizuara dhe inteligjente);
- Mbështetje financiare për instalimin e infrastrukturës së vogël ujitëse në fermë (rezervuarë, pompa, sensorë lagështie);
- Trajnime dhe këshillim teknik për fermerët mbi menaxhimin optimal të ujit;
- Promovim i praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe kursimit të ujit;
- Bashkëpunim me strukturat e menaxhimit të ujërave për përdorim më efikas të burimeve ekzistuese;
- Monitorim i impaktit në kursimin e ujit dhe rritjen e rendimentit bujqësor.

Kosto e Përafërt

20 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësisnë dhe Zhvillimit Rural
- Struktura e ngarkuar për Mjedisit dhe Burimeve Ujore
- Njësitë Administrative

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- AZHBR (Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural)
- Organizata ndërkombëtare (FAO, UNDP, GIZ, BE)
- Shoqata dhe kooperativa fermerësh
- Kompani private të teknologjive të ujitjes
- Universitete dhe institute kërkimore

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë

- Skemat kombëtare të subvencioneve bujqësore (AZHBR)
- Programet e BE-së (IPARD, Green Deal rural)
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publiko-private

Indikatorët

- Numri i fermerëve përfitues
- Sipërfaqja e tokës me sisteme moderne ujitjeje

Afati i Zbatimit

Afatmesëm – Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT – Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman

Titulli i Projektit

Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon rehabilitimin ekologjik dhe forcimin e mbrojtjes natyrore të argjinaturës së Lumit Seman përmes pyllëzimit dhe krijimit të një brezi të gjelbër mbrojtës. Ndërhyrja ka për qëllim reduktimin e erozionit, stabilizimin e brigjeve të lumit, përmirësimin e biodiversitetit dhe uljen e rrezikut nga përmbytjet.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Vlerësimi teknik i gjendjes së argjinaturës dhe zonave të degraduara;
- Hartëzimi i segmenteve prioritare për ndërhyrje;
- Pyllëzimi me specie autoktone të përshtatshme për zonat lumore (p.sh. plep, shelg, akacie etj.);
- Ndërtimi i brezave mbrojtës të gjelbër për stabilizimin e tokës;
- Masa anti-erozione dhe përforcim i segmenteve kritike;
- Përfshirja e komunitetit lokal dhe fermerëve në mirëmbajtje;
- Monitorimi i zhvillimit të bimësisë dhe ndikimit në reduktimin e rrezikut hidrologjik.

Projekti kontribuon në rritjen e sigurisë mjedisore, mbrojtjen e tokave bujqësore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Kosto e Përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Mjedisin dhe Pyjeve
- Struktura e ngarkuar për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Struktura e ngarkuar për Emergjencave Civile

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
- Organizata ndërkombëtare (FAO, UNDP, GIZ, BE)
- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Organizata mjedisore dhe komunitare
- Shoqatat e fermerëve dhe banorët lokalë

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e Ministrisë së Mjedisit dhe Mbrojtjes së Territorit
- Programet e BE-së (Green Deal, IPA III, Climate Action)
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publiko-private në menaxhimin e mjedisit

Indikatorët

- Sipërfaqja e rehabilituar (target: ≥300–800 ha)
- Numri i fidanëve të mbjellë

Afati i Zbatimit

Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT – Hartimi i një studimi dhe plani masash për mbrojtjen e akuifereve të Bashkisë Lushnje

Titulli i Projektit

Hartimi i një studimi dhe plani masash për mbrojtjen e akuifereve të Bashkisë Lushnje

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon realizimin e një studimi të detajuar hidro-gjeologjik dhe hartimin e një plani masash për mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të akuifereve në territorin e Bashkisë Lushnje. Akuiferet përbëjnë burimin kryesor të furnizimit me ujë për konsum dhe bujqësi, ndaj mbrojtja e tyre është thelbësore për sigurinë ujore, shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Hartimi i studimit hidro-gjeologjik të akuifereve kryesore në zonë;
- Identifikimi i zonave të rrezikuara nga ndotja (bujqësore, industriale, urbane);
- Krijimi i hartës së ndjeshmërisë dhe vulnerabilitetit të ujërave nëntokësore;
- Vlerësimi i kapaciteteve të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore;
- Hartimi i planit të masave mbrojtëse dhe rregullatore;
- Propozimi i zonave të mbrojtura sanitare rreth burimeve ujore;
- Ndërgjegjësim i komunitetit dhe fermerëve për reduktimin e ndotjes;
- Vendosja e sistemit të monitorimit të cilësisë së ujit në kohë reale.

Kosto e Përafërt

2 500 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Mjedisit dhe Burimeve Ujore
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin e territorit
- Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve
- Agjencia Rajonale e Mjedisit

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
- Universiteti Politeknik i Tiranës (Inxhinieri Hidrogjeologjike)
- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Organizata ndërkombëtare (UNDP, GEF, FAO, BE)
- Laboratorë të akreditуar për cilësinë e ujit

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Programet kombëtare për menaxhimin e ujërave
- Fondet e BE-së (IPA III, Green Deal, Climate Adaptation Fund)
- Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, GEF, GIZ)

Indikatorët

- Numri i akuifereve të studiuara
- Hartimi i hartës së vulnerabilitetit
- Numri i masave të propozuara dhe të miratuara

Afati i Zbatimit

Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT – Studim për identifikimin dhe rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë Lushnje

Titulli i Projektit

Studim për identifikimin dhe rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë Lushnje

Përshkrimi i Projektit

Projekti synon realizimin e një studimi të detajuar për identifikimin, vlerësimin dhe rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore në territorin e Bashkia Lushnje. Këto vatra përfshijnë zona të ndotura apo të degraduara nga aktivitetet njerëzore, si depozitime të paligjshme mbetjesh, ndotje industriale, ndotje e tokës dhe ujërave, si dhe zona me degradim të rëndë ekologjik.
Qëllimi kryesor është krijimi i një baze të plotë të të dhënave mjedisore dhe hartimi i një plani masash për rehabilitimin gradual të këtyre zonave, duke përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe shëndetin publik.

Kosto e Përafërt

1 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e Ngarkuar për Mjedisin
- Struktura e Ngarkuar për Planifikimin e territorit
- Njësitë Administrative
- Inspektorati Vendor i Mjedisit

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Agjencia e Menaxhimit të Mbetjeve
- Universiteti Politeknik i Tiranës
- Organizata mjedisore vendase dhe ndërkombëtare (UNDP, GIZ, BE)
- Komunitetet lokale dhe bizneset

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet kombëtare për mjedisin dhe pastrimin e territorit
- Programet e BE-së (IPA III, Green Deal, LIFE Programme)
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publiko-private për rehabilitim mjedisor

Indikatorët

- Numri i vatrave të identifikuara dhe të hartëzuara
- Numri i ndërhyrjeve rehabilituese

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

O.4.P4. Programi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, Vlerësim i riskut dhe plane emergjente për përmbytje/thatësirën.

FISHA E PROJEKTIT – Hartimi i Strategjisë Vendore për Tranzicionin Energjetik të Qëndrueshëm (Energjia e Rinovueshme dhe Eficienca Energjetike)

Titulli i Projektit

Hartimi i Strategjisë Vendore për Tranzicionin Energjetik të Qëndrueshëm (Energjia e Rinovueshme dhe Eficienca Energjetike)

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për tranzicionin energjetik të qëndrueshëm në territorin e Bashkisë Lushnje, me fokus në rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme, përmirësimin e eficiencës energjetike dhe uljen e emetimeve të gazeve serrë.
Strategjia do të shërbejë si dokument orientues për politikat vendore në fushën e energjisë, duke mbështetur transformimin drejt një modeli ekonomik më të gjelbër, më efikas dhe më të qëndrueshëm.

Kosto e Përafërt

2 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Shërbimt Publike dhe Infrastrukturën
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin dhe Zhvillim
- Struktura e ngarkuar për Mjedisit

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Agjencia për Eficiencën e Energjisë
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Programet e BE-së (Green Deal, IPA III, Horizon Europe)
- UNDP dhe GIZ
- Kompani private të energjisë dhe teknologjisë së rinovueshme

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet kombëtare për eficiencën energjetike
- Fondet e BE-së (IPA III, LIFE, Horizon Europe)
- Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, GIZ, EBRD)
- Partneritete publiko-private

Indikatorët

- Strategji e miratuar për tranzicionin energjetik

Afati i Zbatimit

Afatmesëm:

FISHA E PROJEKTIT – Fondi për Përdorimin e Energjive të Rinovueshme në Bujqësi (Grante dhe kredi të buta për fermerët)

Titulli i Projektit

Fondi për Përdorimin e Energjive të Rinovueshme në Bujqësi (Grante dhe kredi të buta për fermerët)

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon krijimin e një instrumenti financiar vendor në mbështetje të fermerëve për adoptimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme në sektorin bujqësor në territorin e Bashkia Lushnje.
Fondi do të ofrojë grante dhe kredi të buta për investime në panele diellore, sisteme vaditjeje me energji diellore, pompa eficiente energjetike dhe teknologji të tjera të gjelbra, me qëllim uljen e kostove të prodhimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë klimatike të fermave.

Kosto e Përafërt

30 000 000 (fazë pilot)

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural)
- Struktura e ngarkuar për Financat

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- AZHBR
- BERZH (EBRD) dhe banka tregtare
- UNDP dhe GIZ
- Agjencia për Eficiencën e Energjisë
- Kompani private të energjisë diellore

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e BE-së (IPARD III, Green Deal)
- BERZH / Banka Evropiane e Investimeve
- Donatorë ndërkombëtarë
- Partneritete publiko-private me sektorin energjetik

Indikatorët

- Numri i fermerëve përfitues

Afati i Zbatimit

Afatgjatë

FISHA E PROJEKTIT – Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike

Titulli i Projektit

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon hartimin e një Plani Vendor të Veprimit për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike për territorin e Bashkisë Lushnje, i cili do të shërbejë si dokument strategjik dhe operacional për uljen e riskut klimatik dhe rritjen e reziliencës së komunitetit, infrastrukturës dhe sektorëve ekonomikë.
Plani do të identifikojë rreziqet kryesore klimatike (përmbytje, thatësira, valë të nxehti, erozion, degradim i tokës dhe mungesë uji), si dhe masat konkrete për përshtatje dhe menaxhim të tyre në nivel vendor.

Kosto e Përafërt

1 500,000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Mjedisin
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin e Territorit
- Struktura e ngarkuar për Emergjencat Civile
- Struktura e ngarkuar për Bujqësisë
- Njësitë Administrative

Partnerët e Mundshëm

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- UNDP (programet për klimën dhe reziliencën)
- GIZ dhe BE (Climate Adaptation Funds)
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)
- Universiteti Politeknik i Tiranës
- Organizata mjedisore dhe rajonale

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Programet e BE-së (IPA III, Green Deal, LIFE, Climate Adaptation Fund)
- UNDP dhe GEF
- Donatorë ndërkombëtarë (GIZ, EBRD, World Bank)

Indikatorët

- Plani i miratuar për përshtatje klimatike

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT – Zhvillimi i Sistemit të Alarmimit të Hershëm për Përmbytje dhe Thatësira

Titulli i Projektit

Zhvillimi i Sistemit të Alarmimit të Hershëm për Përmbytje dhe Thatësira

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon krijimin e një sistemi modern të alarmimit të hershëm për përmbytje dhe thatësira në territorin e Bashkisë Lushnje, i cili do të mundësojë paralajmërim në kohë reale për komunitetin dhe autoritetet lokale përmes SMS-ve, aplikacioneve mobile dhe platformave digjitale.
Sistemi do të bazohet në të dhëna meteorologjike dhe hidrologjike në kohë reale, duke rritur kapacitetin e reagimit të shpejtë dhe duke reduktuar dëmet nga ngjarjet ekstreme klimatike.

Kosto e Përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Emergjencat Civile
- Struktura e ngarkuar për Mjedisin
- Struktura e ngarkuar për Teknologjinë dhe Informacionin
- Struktura e ngarkuar për Infrastrukturën
- Njësitë Administrative

Partnerët e Mundshëm

- Instituti i Gjeoshkencave (IGJEUM)
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
- Ministria e Brendshme
- UNDP dhe GIZ
- World Bank (programet për riskun klimatik)
- Kompani teknologjike për sisteme digjitale dhe GIS
- Operatorë telekomunikacioni

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Fondet e BE-së (IPA III, Digital Europe, Climate Adaptation Fund)
- UNDP dhe GEF
- Banka Botërore dhe BERZH
- Partneritete publiko-private

Indikatorët e Performancës

- Sistemi i alarmimit i funksional (1 platformë e integruar)
- Numri i përdoruesve të regjistruar në sistem

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT – Krijimi i Njësive Lokale të Përgjigjes Emergjente për Menaxhimin e Riskut Klimatik

Titulli i Projektit

Krijimi i Njësive Lokale të Përgjigjes Emergjente për Menaxhimin e Riskut Klimatik

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon krijimin dhe funksionalizimin e njësive lokale të përgjigjes emergjente në territorin e Bashkisë Lushnje, me qëllim forcimin e kapaciteteve komunitare për ndërhyrje të shpejtë në rast përmbytjesh, valësh të të nxehtit dhe ngjarjesh të tjera ekstreme klimatike.
Njësitë do të përbëhen nga grupe të trajnuara qytetarësh, vullnetarësh dhe përfaqësuesish lokalë, të cilët do të koordinohen me strukturat bashkiake të emergjencave civile për reagim të shpejtë dhe efektiv në terren.

Kosto e Përafërt

1 000 000 lekë

Njësia Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Emergjencat Civile
- Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike
- Njësitë Administrativ

Partnerët e Mundshëm

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
- Ministria e Brendshme
- Kryqi i Kuq Shqiptar
- UNDP dhe GIZ (programet e reziliencës)
- Organizata lokale të shoqërisë civile
- Forcat e zjarrfikëses dhe shërbimet e urgjencës
- Donatorë ndërkombëtarë

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë Lushnje
- Fondet e BE-së (IPA III, Civil Protection Mechanism)
- UNDP dhe GEF
- Programet e GIZ dhe World Bank
- Donatorë dhe partneritete publiko-private

Indikatorët

- Numri i njësive lokale të krijuara
- Numri i vullnetarëve

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

Objektivi 5: Qeverisje e mirë, planifikim dhe partneritete

O.5.P1. Programi për forcimin e kapaciteteve të administratës vendore dhe sistemeve digjitale për qeverisje efikase

FISHA E PROJEKTIT - Rishikimi dhe optimizimi i strukturës administrative për menaxhim efikas

Titulli i projektit

Rishikimi dhe optimizimi i strukturës administrative për menaxhim efikas

Përshkrimi i Projektit

Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të administratës së Bashkisë Lushnje përmes ristrukturimit organizativ, optimizimit të proceseve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Objektivat specifike

Analiza e plotë e strukturës aktuale organizative dhe proceseve administrative.
Identifikimi i mbivendosjeve, boshllëqeve dhe joeficiencave në funksionim.
Përkufizimi i qartë i roleve, përgjegjësive dhe linjave të raportimit.
Rritja e decentralizimit të vendimmarrjes në nivel drejtorish dhe njësish administrative.
Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët.
Ky projekt synon të ndërmarrë një reformë të brendshme organizative në Bashkinë Lushnje, duke analizuar strukturën ekzistuese dhe duke propozuar një model të ri më efikas dhe të orientuar drejt rezultateve.

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Analizë organizative dhe funksionale e administratës;
- Hartimi i një strukture të re organizative;
- Rishikimi i përshkrimeve të punës (job descriptions);
- Standardizimi dhe/ose digjitalizimi i proceseve administrative;
- Trajnimi i stafit një herë dhe trajnimi i vazhdueshëm;
- Vendosja e mekanizmave të monitorimit të performancës.

Rezultatet e pritshme

- Strukturë administrative më e thjeshtuar dhe funksionale;
- Strukturë që i përputhet funksioneve dhe kompetencave vendore;
- Reduktim i kostove operative;
- Qartësi më e madhe në role dhe përgjegjësi;
- Rritje e transparencës dhe llogaridhënies;
- Shërbime më të shpejta dhe më cilësore për qytetarët dhe bizneset.

Aktivitetet kryesore

1. Analizë diagnostikuese e strukturës dhe proceseve aktuale;
2. Konsultime me stafin dhe aktorët;
3. Hartimi i modelit të ri organizativ;

4. Miratimi institucional i strukturës së re;
5. Zbatimi i ristrukturimit;
6. Trajnime për stafin;
7. Monitorim dhe vlerësim i performancës;

Kosto e Përafërt

5 000 000 lekë

Strukturat përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Burimet Njerëzore

Partnerë të mundshëm

- Ministri për Pushtetin Vendor
- UNDP
- GIZ
- Helvetas

Burimet e financimit

- Buxheti i Bashkisë
- Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, GIZ, Helvetas)
- Fonde të Bashkimit Europian (IPA)

Indikatorët

- % e strukturave të rishikuara dhe miratuara
- Ulja e kohës së ofrimit të shërbimeve (%)
- Numri i proceseve administrative të optimizuara

Afati i zbatimit

Afatmesëm

O.5.P2. Programi për transparencën dhe përfshirje qytetare.

FISHA E PROJEKTIT – Hartimi i Strategjisë Vendore për Ofrimin e Shërbimeve Publike më Pranë Komunitetit dhe Reduktimin e Burokracisë

Titulli i projektit

Hartimi i Strategjisë Vendore për Ofrimin e Shërbimeve Publike më Pranë Komunitetit dhe Reduktimin e Burokracisë

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon hartimin e një strategjie vendore për modernizimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike, duke i afruar ato sa më pranë qytetarëve, përmirësuar aksesin, rritur efikasitetin dhe reduktuar burokracinë administrative në Bashkinë Lushnje.

Kosto e Përafërt

1 000 000 lekë

Njësitë Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike
- Struktura e ngarkuar për Administratën dhe Burimet Njerëzore
- Struktura e ngarkuar për IT dhe Digjitalizimit
- Njësitë Administrative

Partnerë të Mundshëm

- UNDP Albania
- Delegacioni i BE-së në Shqipëri
- OECD SIGMA
- ASPA
- Organizata të shoqërisë civile
- Ekspertë të qeverisjes vendore dhe digjitalizimit

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- IPA III (BE)
- Programe për reformën e administratës publike
- Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, World Bank)

Indikatorët

Strategji e hartuar dhe miratuar

Afati i Zbatimit

Afatemesëm

O.5.P3. Programi për planifikimin e integruar dhe menaxhimin e territorit.

FISHA E PROJEKTIT – Përditësimi i Bazës së të Dhënave Gjeohapësinore të Bashkisë Lushnje

Titulli i projektit

Përditësimi i Bazës së të Dhënave Gjeohapësinore të Bashkisë Lushnje

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon krijimin dhe përditësimin e një baze të dhënash gjeohapësinore gjithëpërfshirëse për territorin e Bashkisë Lushnje, e cila do të shërbejë si instrument bazë për planifikimin territorial, menaxhimin e burimeve natyrore, zhvillimin ekonomik dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

Objektivat Kryesore

- Krijimi i një sistemi të integruar GIS për administrimin e territorit;
- Përditësimi i të dhënave mbi tokat bujqësore, burimet ujore dhe pyjet;
- Hartëzimi i biodiversitetit dhe zonave me vlera mjedisore;
- Regjistrimi dhe analizimi i pasurive kulturore dhe natyrore;
- Inventarizimi i infrastrukturës publike dhe private;
- Evidentimi i sistemit të banesave dhe zhvillimit urban;
- Përmirësimi i vendimmarrjes dhe planifikimit të qëndrueshëm.

Fushat e Përfshira në BAZËN GIS

- Tokat bujqësore (klasifikim, përdorim, cilësi)
- Burimet ujore (lumenj, kanale, akuifere)
- Pyjet dhe zonat e gjelbra
- Biodiversiteti dhe habitatet natyrore
- Pasuritë minerale (nëse të identifikuara)
- Trashëgimia kulturore dhe natyrore
- Rrjeti rrugor dhe infrastruktura publike
- Shërbimet publike (shkolla, qendra shëndetësore, etj.)
- Sistemi i banesave dhe përdorimi i tokës urbane/rurale

Rezultatet e Pritshme

- Krijimi i një sistemi të unifikuar dhe të përditësuar GIS;
- Rritje e saktësisë në planifikimin urban dhe rural;
- Menaxhim më efikas i burimeve natyrore dhe territorit;
- Përmirësim i transparencës dhe aksesit në të dhëna;
- Mbështetje për investime publike dhe private;
- Rritje e kapaciteteve institucionale të bashkisë.

Kosto e Përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Planifikimin e Territorit
- Struktura e ngarkuar për IT dhe Digjitalizim
- Agjencia Shtetërore e Informacionit Gjeohapësinor (ASIG)
- Njësitë administrative

Partnerët e Mundshëm

ASIG
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Mjedisit
UNDP
Banka Botërore
Agjenci dhe institute kërkimore
Universitetet (ekspertizë GIS dhe mjedisore)

Burimi i Financimit

- Buxheti i Bashkisë
- IPA III (BE – zhvillimi territorial dhe mjedisi)
- Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, World Bank)
- Programe kombëtare për digjitalizim dhe mjedis

Indikatorët

- % e territorit të mbuluar me të dhëna GIS të përditësuara

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT – Hartimi i Inventarit të Detajuar të Banesave në Bashkinë Lushnje

Titulli i projektit

Hartimi i Inventarit të Detajuar të Banesave në Bashkinë Lushnje

Përshkrimi i Projektit

Ky projekt synon krijimin e një inventari të plotë dhe të standardizuar të stokut të banesave në territorin e Bashkisë Lushnje, duke përfshirë gjendjen fizike, standardet e ndërtimit, eficiencën energjetike dhe aksesin në shërbimet publike. Ky inventar do të shërbejë si bazë për planifikim urban, politika sociale dhe investime në strehim dhe rehabilitim.

Objektivat Kryesore

- Krijimi i një baze të dhënash të unifikuar për të gjitha banesat;
- Vlerësimi i gjendjes fizike të stokut të banesave;
- Identifikimi i banesave me probleme strukturore ose të degraduara;
- Analiza e eficiencës energjetike të ndërtesave;
- Vlerësimi i aksesit në infrastrukturë dhe shërbime publike;
- Mbështetja e politikave të strehimit social dhe zhvillimit urban;
- Përmirësimi i planifikimit territorial dhe investimeve publike.

Fushat e Inventarit

- Gjendja fizike e ndërtesës (e re, e mirë, mesatare, e degraduar)
- Tipologjia e banesës (individuale, pallat, rurale, informale)
- Statusi ligjor i pronësisë
- Eficienca energjetike (izolim, ngrohje, konsum energjie)
- Aksesi në ujë, kanalizime dhe energji elektrike
- Aksesi në rrugë dhe transport publik
- Vjetërsia e ndërtesës dhe materialet e ndërtimit
- Zona gjeografike dhe niveli urban/rural

Kosto e Përafërt

6 000 000

Njësitë Përgjegjëse

Struktura e ngarkuar për Planifikimin Urban
Struktura e ngarkuar për Shërbimet Publike
Njësitë Administrative

Partnerët e Mundshëm

UN-Habitat
UNDP Albania
Banka Botërore
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agjencia e Eficiencës së Energjisë
Institucione akademike dhe ekspertë urbanistikë

Burimi i Financimit

Buxheti i Bashkisë
IPA III (BE – zhvillim urban dhe social)
Programe për eficiencë energjetike
Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, World Bank, UN-Habitat)

Indikatorët

- % e banesave të inventarizuara

Afati i Zbatimit

Afatmesëm

FISHA E PROJEKTIT – Program Financimi për Përmirësimin e Eficiencës Energjetike të Banesave në Bashkinë Lushnje

Titulli i projektit

Program Financimi për Përmirësimin e Eficiencës Energjetike të Banesave në Bashkinë Lushnje

Përshkrimi i Projektit

Ky program synon të mbështesë financiarisht familjet në Bashkinë Lushnje për përmirësimin e eficiencës energjetike të banesave, duke reduktuar konsumin e energjisë, ulur kostot familjare dhe përmirësuar kushtet e jetesës përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme në ndërtesa.

Kosto e Përafërt

Sipas studimit/projektit

Njësitë Përgjegjëse

- Struktura e ngarkuar për Shërbimet Sociale
- Struktura e ngarkuar për Planifikimin e Territorit
- Njësitë Administrative

Partnerët e Mundshëm

Agjencia e Eficiencës së Energjisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
UNDP Albania
Banka Botërore
BERZH (EBRD)
BE – IPA III dhe Green Agenda for the Ëestern Balkans
OJF mjedisore dhe kompani energjetike

Burimi i Financimit

Buxheti i Bashkisë
Fondet e BE-së (Green Deal / IPA III)
Donatorë ndërkombëtarë (UNDP, World Bank, EBRD)
Skema kombëtare për eficiencë energjetike
Kontributi i përfituesve (bashkëfinancim)

Indikatorët e Performancës

- Numri i banesave të rehabilituara energjetikisht

Afati i Zbatimit

Afatmesëm